

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY
FAKULTETI JURIDIK
STUDIME POSDIPLOMIKE



TEMË MASTERI

**“ASPEKTET JURIDIKO PENALE NDËRKOMBËTARE TË
GJENOCIDIT NË TERRITORIN E ISH – JUGOSLLAVISË”**

MENTOR

BESA ARIFI

STUDENTI

BEKIM JASHARI

Teza:

“Aspektet juridiko-penale ndërkombëtare të gjenocidit në territorin e ish – Jugosllavisë”

Теза:

“Меѓународни правно кривични аспекти на геноцидот во територот на поранешна Југославија”

Thesis:

“International legal and criminal aspects of genocide in the territory of the Former Yugoslavia”

PLAGIARISM STATEMENT

I certify that this assignment is my own work , based on my personal study and research and that I have acknowledged all material and sources used in its preparation, whether they be books, articles, reports, lecture notes, and any other kind of document, electronic or personal communication. I also certify that this assignment has not previously been submitted for assessment in any other unit, except where specific permission has been granted from all unit coordinators involved, or at any other time in this unit, and that I have not copied in part or a whole or otherwise plagiarized the work of other student or persons.

Abstrakt

Studimi ka si qëllim trajtimin e aspekteve juridiko penale të gjenocidit në Ish- Jugosllavinë.

Në mënyrë të vecantë është bërë hulumtimi i thelluar shkencor i natyrës historike lidhur me krimin e gjenocidit në territorin e ish Jugosllavisë. Nëpërmjet këtij punimi janë vënë në dukje aspektet juridiko penale ndërkombëtare bazuar në akte ndërkombëtare sanksionuese si : Statuti I aktualizuar I tribunalit penal ndërkombëtar për ish Jugosllavinë, statuti I Romës për Gjykatën ndërkombëtare penale , Konventa e kombeve të bashkuara “Mbi parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit” Në këtë studim është aplikuar metoda analitike që do të shfrytëzohet lidhur me elementet dhe aspektet juridiko penale të krimit të gjenocidit, po ashtu gjatë këtij studimit përdoret metoda krahasuese në aspektin hulumtues shkencor në lidhje me qëndrimin e mbajtur në arenën ndërkombëtare nëpërmjet sanksionimit në konventën e kombeve të bashkuara të vitit 1948.

Gjatë këtij studimi është trajtuar rruga e gjatë që të drejtës ndërkombëtare I është dashur të bëjë me qëllim garantimin e një drejtësie efektive në ndëshkimin e krimeve me elemente ndërkombëtare. Duke marrë parasysh fenomenin e krimit të gjenocidit në territorin e ish Jugosllavisë, pasojat e sjella dhe gjurmët e lëna në zhvillimin historik, mendoj se studimi më I thelluar I aspekteve juridiko penale të këtij krimi shërbejnë si një bazë ekselente për të redaktuar një hulumtim shkencor dhe do të jetë një bonus I garantuar për të drejtën penale ndërkombëtare.

Абстракт

Овој труд има за цел да ги истражи кривично-правните аспекти на геноцидот во поранешна Југославија.

Направено е особено длабоко научно истражување на историската природа на кривичното дело геноцид на територијата на поранешна Југославија. Овој труд ги истакнува меѓународните и кривично - правните аспекти чија што основа се наоѓа во меѓународните правни акти како што се: Статутот на Меѓународниот кривичен трибунал за поранешна Југославија, Римскиот статут на Меѓународниот кривичен суд, Конвенцијата на Обединетите Нации за превенција и казнување на криминалот геноцид ".

При изработката на овој труд се применува аналитички метод во однос на елементите и кривично правните аспекти на кривичното дело геноцид, како и компаративниот метод при научно-истражувачките аспекти во однос на ставот што се одржува на меѓународната сцена преку објавување на Конвенцијата на Обединетите Нации од 1948 година.

Во овој труд се обработува и долгиот пат кој требаше да го направи меѓународното право со цел да гарантира ефикасна правда во казнувањето на кривичните дела со меѓународен елемент. Имајќи го предвид феноменот на криминалот од геноцид на територијата на поранешна Југославија, последиците и остатоците во историскиот развој, мислам дека деталната студија на кривично правните аспекти на ова кривично дело служи како одлична основа за изработување на еден научно истражувачки труд, а ќе биде и придонес за меѓународното кривично право.

Abstract

The study aim is addressing the legal aspects of genocide in the former Yugoslavia.

In particular a profound scientific research of historical nature has been made regarding the crime in the territory of former Yugoslavia. Through this paper are noted the international criminal law aspects based on international sanctioning acts such as : the current statute of the International Criminal Tribunal based on international acts of former Yugoslavia, the Rome Statute for the International Criminal Court, United Nations Convention on the Prevention and Punishment of Crime Genocide.

In this study the analytical method is used in conjunction with elements and aspects of criminal law of the crime genocid, as well there are used comparative methods regarding the held attitude in the international arena through sanctioning in the convention of united nations of the year 1948.

During this study the long way to international law has been plagued to do it in order to guarantee effective justice in punishing crimes with international elements.

Considering the phenomenon of genocide crime in the territory of Former Yugoslavia the consequences brought and the traces left in the historical development, I think that the deepest study of the criminal legal aspects of this crime serve as an exemplary basis for editing in scientific research and it will be a guaranteed bonus for international criminal law.

MIRËNJOHJE

Për realizimin e këtij punimi dua të falenderoj, në radhë të parë mentorin tim Prof. Besa Arifi, për mbështetjen e jashtëzakonshme, ndihmën, shtysën dhe inkurajimin që më ka dhënë gjatë gjithë procesit intensiv të studimit si edhe idetë dhe konceptet e saja tejet profesionale në fushën e të drejtës penale ndërkombëtare, pa ndihmën e së cilës ky punim do të ishte shumë i vështirë të realizohej.

Një falenderim i veçantë, për dhënien e mundësisë së përgatitjes së kësaj teze, shkon për drejtuesit dhe anëtarët e stafit akademik të Fakultetit Juridik, pranë Universitetit të Evropës Juglindore (Tetovë).

Në fund një falenderim i veçantë shkon për familjarët e mi të cilën me mbështetjen e tyre morale, financiare dhe njerëzore kanë rrënjosur dëshirën për të drejtën, të moralshmen dhe të ndershmen si dhe kuriozitetin për të qenë jo vetëm një kërkues shkencor por edhe një jurist i denjë.

Ju faleminderit që më besuat !

"Shumë shpresojnë se nuk do të ketë më luftëra, por ne nuk guxojmë të mbështetemi vetëm në shpresat për mbrojtje nga praktikat gjenocidale nga pushtuesit e pamëshirshëm"!

(Cit. Raphael Lemkin)

Metodologjia dhe Hipotezat e ngritura

Puna kërkimore për këtë tezë masteri ka filluar që në muajin Korrik dhe filloi të intensifikohet duke u fokusuar në këtë temë pas muajit Nëntor, moment i cili përkon me miratimin e kërkesës sime për të paraqitur si tezë masteri, punimin me titull: “Aspektet juridiko penale ndërkombëtare të gjenocidit në territorin e ish- Jugosllavisë”, pranë Fakultetit Juridik.

Hartimi i këtij punimi ka qenë një sfidë e vërtetë për shkak të hulumtimit të thelluar shkencor kryesisht të natyrës historike në lidhje me krimin e gjenocidit në territorin e ish- Jugosllavisë, duke u bazuar në ato të dhëna dhe reflektime aq sa të drejta, aq edhe konspirative referuar ndikimit të sistemeve të ndryshme politike. Nëpërmjet këtij punimi jam munduar të sjell anën e drejtë dhe të qartë të këtij fenomeni duke vënë në dukje në mënyrë të mirëfilltë aspektet juridiko penale ndërkombëtare bazuar në akte ndërkombëtare sanksionuese si: Statuti i aktualizuar i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (miratuar më 25 Maj 1993, nëpërmjet Rezolutës 827); Statuti i Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale (redaktuar në Romë, më 17 Korrik 1998); Konventa e Kombeve të Bashkuara “Mbi parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit” (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 9 Dhjetor 1948).

Metoda kryesore e përdorur është metoda analitike, që do të shfrytëzohet lidhur me elementët dhe aspektet juridiko – penale të krimit ndërkombëtar të gjenocidit, në territorin e ish Jugosllavisë dhe në analizën e praktikës gjyqësore të trajtuar nga Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë (Hagë).

Metoda krahasuese gjithashtu do të shfrytëzohet në aspektin hulumtues shkencor në lidhje me qëndrimin e mbajtur në arenën ndërkombëtare nëpërmjet sanksionimit në Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1948, Statutin e aktualizuar të Hagës dhe atë të Romës, si dhe qëndrimin e mbajtur nga akademikët maqedonas referuar të drejtës penale ndërkombëtare.

Referuar hipotezave që ky punim synon t’iu ofrojë një përgjigje adekuate nëpërmjet të dhënave dhe informacioneve në vijim, janë:

- Hulumtim shkencor referuar ngjarjeve historike në lidhje me krimin e gjenocidit në territorin e ish-Jugosllavisë.
- Elementët juridiko – penale të krimit të gjenocidit dhe aspektet e parashikuara nga aktet ndërkombëtare sanksionuese.
- Thellimi i njohurive nëpërmjet njohjes së praktikës gjyqësore të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish – Jugosllavinë (Hagë).

Pasqyra e punimit	Faqe
- Mirënjohje	2
- Metodologjia dhe hipotezat e ngritura	3
- Hyrje	5

KAPITULLI I

NGA JURIDIKSIONET E BRENDSHME DREJT ATYRE NDËRKOMBËTARE. KONCEPTI I ‘GJENOCIDIT’

1.1. Zhvillimi historik i së drejtës penale ndërkombëtare	8
1.2. Koncepti i ‘gjenocidit’ në legjislacionin ndërkombëtar	13
1.2.1. Ndihmesa e dhënë nga Kombet e Bashkuara mbi konceptimin e gjenocidit	14
1.2.2. Parashikimi i gjenocidit sipas Rregulloreve të Hagës	16
1.3. Përgjegjësia e shtetit: Problematikat e hasura në rastin e akteve gjenocidiale (Çështja Bosnja dhe Hercegovina kundër Serbisë dhe Malit të Zi)	16

KAPITULLI II

ANALIZË E ELEMENTËVE JURIDIKË TË KRIMIT TË GJENOCIDIT

2.1. Drama e ndodhur në territorin e ish- Jugosllavisë. Disa aspekte historike	24
2.2. Dallimi ndërmjet ‘gjenocidit’ dhe ‘spastrimit etnik’	28
2.3. Analizë e elementëve juridiko-penalë të gjenocidit sipas akteve ndërkombëtare	29
2.3.1. Parashikimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara (1948)	29
2.3.2. Parashikimi i Statutit të Tribunalit të Hagës. Praktika gjyqësore e këtij Tribunali	40
▪ Prokurori kundër Goran Jelisić	
▪ Prokurori kundër Slobodan Milosević	
▪ Prokurori kundër Ratko Mladić	
▪ Prokurori kundër Zdravko Tolimir	
2.3.3. Parashikimi i gjenocidit sipas Statutit të Romës	51

KAPITULLI III

GJENOCIDI SIPAS KËNDVËSHTRIMIT TË SË DREJTËS SË BRENDSHME

- Konkluzione	58
- Bibliografia	61

Hyrje

Territori i ish-Jugosllavisë ka qënë një skenë e krimeve gjenocidiale dhe krimeve të tjera në masë kundër njerëzimit gjatë pushtimit të fuqive të Boshtit gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore, respektivisht viteve 1941-1945. Në vijim gjatë një periudhe gati gjysëm shekullore e ndjekur me copëzimin e shtetit të Jugosllavisë, gjatë viteve 1991-1999, u formua një panoramë ndërlidhëse historike, e ndërvarur nga një sërë elementësh tematikë dhe rastësorë, që e shndërroi popullsinë civile në këtë territor në viktime të ‘incidenteve’ të dhunës në masë. Referuar “Konventës së Kombeve të Bashkuara në lidhje me Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit” të vitit 1948, gjenocidi përfshinte “akte të kryera me qëllimin për të shkatërruar, në tërësi ose pjesërisht, një grup nacional, etnik, racial ose fetar”. Pra siç e vërejmë në parashikimin ligjor të këtij akti, një parashikim i sanksionuar në të njëjtën frymë dhe në Statutin e Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare (neni 6) krimi i gjenocidit, dallon nga krimet e tjera serioze të sanksionuara në të drejtën penale ndërkombëtare për shkak të qëllimit të posaçëm të tij, i cili synon të shkatërrojë një target grup të caktuar. Pra një grup i caktuar i shoqërisë civile bëhet objekt i sulmeve gjenocidiale për faktin e thjeshtë se anëtarët e tij kanë një identitet të përbashkët grupor, pra për përfaqësi race, feje, entiteti apo nacionaliteti. Duke marrë parasysh fenomenin e krimit të gjenocidit në territorin e Ish- Jugosllavisë, pasojat e sjella dhe gjurmët e lëna në zhvillimin historik, mendoj se studimi më i thelluar i aspekteve juridiko – penale të këtij krimi, shërbejnë si një bazë ekselente për të redaktuar një hulumtim shkencor, i cili do t’i vijë në ndihmë shumë juristëve të rinj dhe do të jetë një bonus i garantuar për të drejtën penale ndërkombëtare.

Termi “gjenocid” në çdo gjuhë që të theksohet është një terminologji e cila është aq në kundërshtim me sjelljen civile, si dhe kuptohet elementarizmi i hezitimit për ta përdorur këtë term në momentin e përcaktuar. Pas krimeve dhe mizorive të Luftës së Dytë Botërore, i gjithë njerëzimi tha “kurrë më!”. Me “Konventën për parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit”, të vitit 1948 është përcaktuar në mënyrë të unifikuar krimi i gjenocidit. Që nga momenti i miratimit, Konventa është shndërruar në një nga instrumentet e pranuara ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut dhe që nga viti 1948 është ndërmarrë një rrugë e gjatë drejt krijimit të një sistemi ndërkombëtar të drejtësisë penale për të ndëshkuar ata individë që janë personalisht përgjegjës për planifikimin, urdhërimin ose ekzekutimin e një akti gjenocidal, si në kohë lufte dhe në kohë paqeje.

Në *kapitullin e parë* të këtij punimi është trajtuar rruga e gjatë dhe e vështirë që të drejtës ndërkombëtare i është dashur të bëjë me qëllim garantimin e një drejtësie efektive në ndëshkimin e krimeve me elementë ndërkombëtarë të parashikuara nga normat penale kombëtare dhe ndërkombëtare. Po sipas të drejtës ndërkombëtare, shteti ka kompetenca ekskluzive në ushtrimin e sovranitetit brenda hapësirave të tij territoriale. Pjesë e sovranitetit shtetëror, e lidhur ngushtë me kontekstin hapësinor dhe funksional të tij, është edhe pushteti represiv i shtetit në fushën penale,

i cili reflekton të drejtën e vetë shtetit për të konsideruar veprime ose mosveprime të caktuara si vepra penale dhe të parashikojë sanksione për to. Për hir të nevojës për një drejtësi efektive parimi i juridiksionit universal ka prevaluar në raport me parimin e territorialitetit, pasi vetëm nëpërmjet zgjerimit të juridiksionit të gjykatave kombëtare në lidhje me krimet, pavarësisht nga vendi i kryerjes së krimit apo shtetësia e autorit, mund të arrihej plotësimi i atij objekti. Natyrisht aplikimi i këtij parimi duhet bërë në mënyrë të kujdesshme dhe brenda disa kushteve të caktuara. Krimet ndërkombëtare si gjenocidi e kanë të domosdoshme vëmendjen ndërkombëtare dhe operacionalitetin në parandalimin dhe ndëshkimin e tyre, pasi në këto raste kemi të bëjmë me vepra penale me rrezikshmëri të madhe shoqërore, të një shkallë serioze. Në këtë kapitull një vend i veçantë i është kushtuar konceptit të gjenocidit. Pavarësisht se ne sot disponojmë një kuadër të mirë implementuar ligjor, termi i gjenocidit nuk është një term i ri i implementuar vetëm nga aktet ndërkombëtare. Ky term është përdorur për herë të parë nga avokati polak hebre Rafael Lemkin, në veprën e tij *“Rregulli i Boshtit në Evropën e Okupuar: Ligjet e Pushtimit - Analiza e Qeverisë - Propozimet për Korrigjim”*, i cili e përkufizoi gjenocidin si: *“shkatërrimi i një kombi apo i një grupi etnik”*. Mendoj se marrja parasysh e analizës së thelluar terminologjike do të ndihmonte në hartimin e mekanizmave të parandalimit në aspektin legal dhe sociologjik. Stigma morale dhe shoqërore e huazuar nga kjo fjalë është një nga arsyt kryesore për të cilat shtetet dhe aktorët e tjerë politik e përdorin atë në diskursin ndërkombëtar ose më shpesh përpiqen me dëshpërim të mos e përdorin atë. Një ndihmesë që vlen të theksohet në inkuadrimin e një konceptimi të qartë të krimit të gjenocidit kanë dhënë Kombet e Bashkuara dhe Rregulloret e Hagës. Përgjegjësia e shtetit është problematika e cila është synuar të trajtohet nëpërmjet analizimit të çështjes Bosnja dhe Hercegovina kundër Serbisë dhe Malit të Zi, të gjykuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. GJND duket se pati gjasa të vendoste mbi bazueshmërinë e rastit të gjenocidit të paraqitur para Gjykatës 22 vjet më parë nga Bosnja dhe Hercegovina kundër Serbisë dhe Malit të Zi, mbi përgjegjësinë e këtij të fundit për gjenocidin e kryer gjatë konfliktit boshnjak pas ndarjes së ish Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (RSFJ). Mendoj se analizimi i rrethanave faktike të kësaj çështjeje do të reflektojë domosdoshmërisht për lexuesin edhe vlerën e rëndësishme që ka ky gjykim në arenën ndërkombëtare. Por kjo çështje vihet përballë një qëndrimi kontrovers të mbajtur nga Tribunali i Hagës, në çështjen Prokurori kundër Krstić.

Kapitulli i dytë i këtij punimi, i kushton një vëmendje të veçantë aspekteve historike të dramës së ndodhur në territorin e ish-Jugosllavisë, pasi mendoj se trajtimi i rrethanave faktike dhe historike të një kauze ndihmon çdo lexues të këtij studimi, qoftë ai dhe jo jurist, për të kuptuar më qartë çfarë ka ndodhur dhe për t’i vendosur ai një emër ngjarjeve dhe sulmeve të ndërmarra. ‘Spastrimi etnik’ dhe ‘gjenocidi’ janë dy koncepte të cilat, shpesh herë në disa literatura ndërkombëtare konfondonen ose përdoren si sinonime të njëra tjetrës, por kjo është një praktikë gabuar pasi ndryshimet kryesore janë të paraqitura pikërisht në këtë punim. Elementët juridiko-penalë të krimit të gjenocidit, janë analizuar në këtë punim sipas akteve ndërkombëtare përkatëse si: Konventa e parandalimit dhe ndëshkimit të krimit të gjenocidit (1948); Statuti i Tribunalit të Hagës dhe Statuti i Romës. Për inkuadrimin më të qartë të këtyre elementëve bazë

dhe konstitutive të krimit të gjenocidit ka shërbyer dhe trajtimi i jurisprudencës së Tribunalit të Hagës, kompetent për ndëshkimin e krimeve ndërkombëtare të ndodhura në territorin e ish-Jugosllavisë, që nga viti 1991.

KAPITULLI I

NGA JURIDIKSIONET E BRENDSHME DREJT ATYRE

NDËRKOMBËTARE. KONCEPTI I ‘GJENOCIDIT’

1.1. Zhvillimi historik i së drejtës penale ndërkombëtare

Me drejtësi penale ndërkombëtare do të kuptojmë bashkësinë e normave dhe institucioneve të themeluara nga e drejta ndërkombëtare, me qëllim zbulimin, ndjekjen penale dhe ndëshkimin e krimeve të parashikuara në të drejtën penale ndërkombëtare,¹ që do të thotë faktet, ligjshmëria e të cilave është parashikuar në norma ose parime të së drejtës ndërkombëtare dhe graviteti i të cilave është i tillë, për tmerrin që ato shkaktojnë ose për madhësinë e rrezikshmërisë shoqërore që ato sjellin si pasojë në botë, ndikojnë në të gjithë bashkësinë e shteteve.² Doktrina në një këndvështrim përgjithësues pranon se fushat thelbësore të cilave drejtësia ndërkombëtare u referohet kryesisht kanë lidhje me krimet kundër njerëzimit, krimet kundër paqes dhe krimet e luftës. Shtetet anëtare kanë pretenduar gjithmonë që të mos humbasin të drejtën për të ndëshkuar këto krime, të kryera në territorin e tyre, me anë të gjyqtarëve të sistemit të brendshëm gjyqësor dhe në bazë të legjislacionit të tyre penal. Por ky objektiv shpesh herë shfaqej i pamundur. Në arenën ndërkombëtare fryma nuk ishte kaq pozitive, duke marrë parasysh pamundësinë ose mungesën e gadishmërisë të shumë shteteve për të ndjekur këto lloj krimesh brenda vendit të tyre, pandëshkueshmëria e autorëve të veprave penale ishte evidente në rastet kur autorë të tyre ishin figura të larta politike dhe ushtarake, kundër të cilëve qeveria nuk kishte interes të vepronte për të shmangur përfshirjen ose thjesht për të shmangur kompromentimin e stabilitetit të marrëdhënieve ndërkombëtare. Për këto arsye, mund të themi se ligji ndërkombëtar mori situatën nën kontroll duke i përvetësuar këto krime në sferën e tij të kompetencës, duke përcaktuar veprat penale sipas kriterëve universale të vlefshme, duke eliminuar vlerën e justifikimit për rrethanat të cilat janë të vlefshme për juridiksionin e brendshëm penal material apo procedural penal, duke krijuar organizma për zbulimin e këtyre krimeve nëpërmjet metodave dhe teknikave speciale të hetimit, si dhe duke krijuar organe për persekutimin, represionin dhe zbatimin e dënimeve në sferën ndërkombëtare nëpërmjet prokurorëve dhe gjykatave ndërkombëtare ose duke i vendosur si detyrim shteteve anëtare të Konventave dhe akteve ndërkombëtare ndjekjen penale, inkriminimin, ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjelltë e bashkëpunimin ndërgjyqësor.

Zhvillimi i të drejtës penale ndërkombëtare lidhet ngushtë me tendencën e njerëzimit për të zhvilluar luftë. Mënyra se si komuniteti ndërkombëtar ka reaguar ndaj shkeljeve të rënda që kanë cënuar vlerat e bashkësisë ndërkombëtare ka qenë e ndryshme në përshtatje me evolucionin historik të vetë bashkësisë njerëzore si dhe faktorëve që e kanë përcaktuar këtë evolucion.

¹ Bassiouni, M.C., *International Criminal Law: A Draft International Criminal Code*, Botim: Brill Archive, New York, 1980, f. 135.

² Vassalli, G., *Verso una giustizia internazionale penale ?*, cit. nw Sicurella R., *Per una teoria della colpevolezza nel sistema dello statuto della Corte Penale Internazionale*, Vol. 277, Botim: Universiteti Catani, Fakulteti i Drejtësisë, Giuffrè Editore, 2008, f. 185.

Reagimet ndaj krimeve të luftës historikisht janë mjaft të hershme ndonëse shfaqen në raste sporadike. Në doktrinën e të drejtës ndërkombëtare penale është e vështirë të gesh një datë apo ngjarje që të përcaktojë fillesat e lindjes së të drejtës penale ndërkombëtare. Disa autorë mendojnë se ajo lidhet me shkollën e postglasatoreve në shek. XVI-të, të tjerë se shfaqja për herë të parë e interesit të përbashkët të shteteve për të dënuar krimet ndërkombëtare ka lindur në shekullin e XVII-të bashkë me piraterinë.³ Vetëm në fund të shek. XIX-të dhe fillimin e shek. XX-të gjejmë një zhvillim konstant të instrumentave ndërkombëtare që kanë për qëllim dënimin e sjelljeve të caktuara të konsideruara kriminale, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet shteteve në luftë kundër akteve kriminale. Në mungesë të një juridiksioni ndërkombëtar, krimet gjenocidiale u gjykuan nga gjykatat kombëtare në bazë të parimit të territorialitetit apo personalitetit aktiv. Veçanërisht masakrat e kryera gjatë Luftës së Parë Botërore e ndërgjegjësuat komunitetin ndërkombëtar për domosdoshmërinë e penalizimit të veprimeve dhe dënimin e autorëve të tyre.⁴ Menjëherë pas Luftës së Parë Botërore fillon të zhvillohet një koncept i ri, i përgjegjësisë direkte të individëve për shkeljen e normave ndërkombëtare.⁵ Deri në këtë periudhë projektet për themelimin e tribunaleve (gjykatave apo institucioneve me kompetenca gjyqësore) ndërkombëtare, kishin rezultuar thjesht tentativa të pasuksesshme, pasi ose ishin jetësuar në gjykata *ad hoc*, komisione hetimore ose në gjykata kombëtare me mandat ndërkombëtar. Një Gjykatë Ndërkombëtare kundër krimeve të luftës (shkelje të Konventës së Vienës të vitit 1948) ishte një projekt i propozuar nga zvicerani Gustav Moyniere pas konfliktit frëzëskan të vitit 1870.⁶ Në Konferencën e Paqes në Versajë u formua një komision i posaçëm i cili është i pari komision me karakter ndërkombëtar në historinë e të drejtës penale ndërkombëtare që kishte për detyrë të konstatonte përgjegjësinë e shteteve dhe udhëheqësve të tyre për shkaktimin e luftës.⁷ Në raportin e hartuar nga Komisioni më 29 Mars 1919, u përcaktua parimi se pozita shtetërore, madje edhe ajo e kryetarit të shtetit nuk mund të përbënte shkak për përjashtimin nga përgjegjësia penale.⁸ Ky dokument rekomandonte krijimin e një institucioni të një niveli të lartë “gjykata e lartë ndërkombëtare” për të ndëshkuar autorët kryesorë, duke përfshirë Kaiser Guglielmo II që fajësohej për shkeljen e neutralitetit të Belgjikës, akt i përcaktuar si “zemërim i madh në etikën ndërkombëtare dhe shenjtërinë e traktateve”.⁹ Por propozimet e këtij Komisioni nuk u morën parasysh nga Konferenca e Paqes për shkak të mungesës së vullnetit politik, të aleatëve¹⁰, sepse Kaiser mbeti nën mbrojtjen e Vendeve të Ulëta që refuzoi t’i hapte rrugë

³ Caracciolo, I., *Dal Diritto Penale Internazionale all Diritto Internazionale Penale*, Shtëpi botuese: Editoriale Scientifica, Milano, 2000, f. 118.

⁴ Xhafo, J., *E drejta penale ndërkombëtare*, Shtëpia botuese: GEER, Tiranë, 2009, f. 17.

⁵ Ibid.

⁶ Vassalli, G., *Verso una giustizia internazionale penale ?*, cit. nw Sicurella R., *Per una teoria della colpevolezza nel sistema dello statuto della Corte Penale Internazionale*, Vol. 277, Botim: Universiteti Catani, Fakulteti i Drejtësisë, Giuffrè Editore, 2008, f. 188.

⁷ Barboza, J., *International Criminal Law*, Vol.278, Collected Courses of the Hague Academy of International Law, 1999, f. 34.

⁸ Ibid., f. 35.

⁹ Taylor, T., *Anatomia dei processi di Norimberga*, Botim i dytë, Shtëpi Botuese: Rizzoli, Milano, 2005, f. 25.

¹⁰ Barboza, J., *International Criminal Law*, Vol.278, Collected Courses of the Hague Academy of International Law, 1999, f. 36-37.

ekstradimit. Rastet që duhej të ishin gjykuar nga organizmat *ad hoc*, u transferuan për t'u gjykuar nga gjykatat gjermane (proceset Leipzig)¹¹. Pas Luftës së Dytë Botërore si pasojë e krimeve të kryera dhe dëmeve të shkaktuara, koncepti i përgjegjësisë dhe ndëshkimit të autorëve u shndërrua në domosdoshmëri. Duke pasur parasysh edhe përpjekjet e mëparshme të komisionit të posaçëm, të cilat shërbyen si një përvojë mjaft e mirë ligjore, e drejta penale ndërkombëtare hodhi hapat e parë drejt konsolidimit duke sjellë fillimisht themelimin e juridiksioneve penale ndërkombëtare të Nurembergut dhe Tokios (Gjykata *ad hoc*). Me miratimin e një sërë konventash e drejta penale ndërkombëtare gjen zhvillim të mëtejshëm në një dimension të ri me lindjen e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për gjykimin e personave për krime të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë. Kjo gjykatë është quajtur “Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Individëve Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991” (më tej: Tribunali i Hagës), themeluar nga Këshilli i Sigurimit bazuar në Kap. VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara.¹² Ky tribunal është një iniciativë e marrë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Statuti i Tribunalit të Hagës u aprovua me Rezolutën nr. 827 të datës 25 Maj 1993 të Këshillit të Sigurimit. Tribunali është i vendosur në Hagë të Hollandës dhe ushtron juridiksion *ratione locis* në lidhje me shkeljet e rënda të së drejtës humanitare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë. Faktikisht krijimi i këtij tribunal nuk ishte forma e vetme e reagimit ndaj shkeljeve masive të së drejtës ndërkombëtare në territorin e ish-Jugosllavisë, por hapi final pas masave politike dhe ushtarake për zgjidhjen e situatës. Bazuar në Statutin e Tribunalit (përkatësisht nenet 1-5) është theksuar kompetenca e Tribunalit, pra krimet të cilat përfshihen nën kompetencën për t'u gjykuar nga kjo gjykatë, të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që nga Janari i vitit 1991. Ata janë: *shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (neni 2); shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës (neni 3); gjenocidi (neni 4); dhe krime kundër njerëzimit (neni 5)*.¹³ Ashtu si në të gjitha juridiksionet me karakter ndërkombëtar, edhe ajo nuk u përjashtua nga debatet në lidhje me ligjshmërinë e funksionimit të saj, debate të cilat janë ekzistente edhe në ditët e sotme duke vënë shpesh në dukje se Tribunali i Hagës e ka pushuar fuqinë e kompetencave të tij. Por pavarësisht nga këto debate, krijimi i kësaj gjykate ka marrë në një masë të gjerë mbështetjen nga komuniteti ndërkombëtar e veçanërisht shtetet anëtare të OKB-së. Përsa i përket bazës së saj ligjore në mënyrë të veçantë duhet t'i referohemi Kreut VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara¹⁴ i cili i jep pushtet vendimarrës Këshillit të

¹¹ Ishin ndër proceset gjyqësore më ekstreme që arena ndërkombëtare ka parë, pasi nga pothuajse 900 të dyshuar të identifikuar nga komisioni i hetimit, vetëm 45 u gjykuan dhe 12 u dënuan në mënyrë të menjëhershme, pa një proces të rregullt gjyqësor, për shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare por me dënime modeste. Pas rezultatit tepër ekstrem të gjyqeve të Leipzig-it, aleatët inicuan ndërmarrjen e disa procedurave përpara gjykatave përkatëse kombëtare, në bazë të nenit 229 të Traktatit të Versajës, por me rezultate të pakënaqshme.

Roht Arrazia, N., *Impunity and Human Rights in International Law and Practice*, Oxford, 1995, f. 74.

¹² Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë, i përditësuar më Shtator 2009. Shih: <http://www.icty.org/en/documents/statute-tribunal> (aksesuar online: 01/12/2017).

¹³ Ibid.

¹⁴ Nenet 39-45 të Kreut VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara kanë reflektuar në një mënyrë të përgjithshme dhe specifike kompetencën që ky akt i njeh Këshillit të Sigurimit për të përcaktuar ekzistencën e çdo kërcënimi për paqen, shkeljen e paqes ose aktin e agresionit dhe do të bëjë rekomandime ose do të vendosë se çfarë masash do të

Sigurimit në rastet e situatave që kërcënojnë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Shkelja e të drejtave të njeriut në Kosovë për shkak të masivitetit të tyre dhe pasojave, mendoj se mund të konsiderohet një shembull i kërcënimit të paqes dhe sigurisë në botë në përputhje me Kreun VII të Kartës së OKB-së. Legjitimiteti i Tribunalit të Hagës u analizua nga vetë Dhoma e Apelit të kësaj gjykate në çështjen Tadić.¹⁵ Gjykata argumentoi se legjitimiteti i gjykatës bazohet në parashikimet e nenit 41 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.¹⁶ Praktikën e krijimit të gjykatave *ad hoc* si dhe rezultatet pozitive të veprimtarisë së tyre, i hapën rrugë krijimit të një gjykate të përhershme ndërkombëtare në fushën penale.

Termi i drejtësisë ndërkombëtare penale është më i zgjeruar sesa termi i të drejtës ndërkombëtare penale¹⁷ që pasqyron kompleksitetin e normave të së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi, të cilat sanksionojnë përgjegjësinë penale të individëve për ato ngjarje që shqetësojnë rendin publik ndërkombëtar dhe përbëjnë krime kundër të drejtës së popujve.¹⁸ Interesi i madh i është dhënë gjithmonë përpjekjeve për të afirmuar dhe realizuar, në nivel ndërkombëtar, parimin e përgjegjësisë penale individuale, duke kapërcyer skemën klasike të përgjegjësisë ndërshtetërore dhe duke anashkaluar raportin e ndërsjelltë të vendosur ndërmjet marrëdhënieve shtetërore – individuale – organeve.¹⁹ Teza e mbrojtjes e bazuar në bindjen ndaj urdhrave më të larta u refuzua nga ana e arenës ndërkombëtare, tashmë përgjegjësia në këtë aspekt kishte të bënte me koshiençën dhe vullnetin individual për të kuptuar nëse një veprim që pritej të kryhej ishte i drejtë apo i gabuar.

Kritikat në lidhje me natyrën e përkohshme si dhe juridiksionin e kufizuar të tribunaleve *ad hoc* çuan në domosdoshmërinë e krijimit të instrumentave më të qëndrueshëm dhe të paanshëm në vendosjen e drejtësisë në fushën penale. Faktikisht janë pikërisht përpjekjet për krijimin e mekanizmave të përhershëm për vendosjen e drejtësisë penale që çuan drejt krijimit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Hapi i parë u hodh pikërisht në vitin 1948 me hartimin e “Konventës për parandalimin dhe ndjekjen e krimit të gjenocidit” e cila në nenin 6 të saj i njëjti kompetencën, përveç gjykatave të vendit ku kishte ndodhur akti gjenocidal, edhe një Gjykatë Penale

ndërmerren në përputhje me nenet 41 dhe 42, për ruajtjen ose rivendosjen e paqes ndërkombëtare dhe sigurisë. Shih: <http://www.un.org> (aksesuar online: 01/12/2017).

¹⁵ ICTY, Prosecutor v. Dusko Tadić, IT-94-I-AR72, Dhoma e Apelit, Vendim datë 2 Tetor 1995. Shih: <http://www.icty.org> (aksesuar online: 01/12/2017).

¹⁶ Neni 41 i Kartës së Kombeve të Bashkuara parashikon: “Këshilli i Sigurimit mund të vendosë për marrjen e masave të cilat nuk përfshijnë përdorimin e forcës së armatosur dhe mund t’u kërkojë anëtarëve të tij mbështetje në marrjen e këtyre masave. Këto masa mund të përfshijnë ndërprerjen e plotë apo të pjesshme të marrëdhënieve ekonomike, si dhe çdo mjeti hekurudhor, detar, ujor, postar, telegrafik apo çdo mënyrë tjetër komunikimi si dhe ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike”.

¹⁷ Mantovani, F., *Diritto penale*, Ribotim 3, Shtëpi Botuese: CEDAM, Padova, 1992, f. 112.

¹⁸ Vassalli, G., *Verso una giustizia internazionale penale*?, cit. nw Sicurella R., *Per una teoria della colpevolezza nel sistema dello statuto della Corte Penale Internazionale*, Vol. 277, Botim: Universiteti Catani, Fakulteti i Drejtësisë, Giuffrè Editore, 2008, f. 189.

¹⁹ Një argumentim i tillë është i mbështetur edhe në nenin 4 të “Konventës për Ndalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit” adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 9 Dhjetor 1948, ku është theksuar se: “Personat që kanë kryer gjenocidin ose një çfardo nga aktet e tjera të përmendura në nenin III do të dënohen, qofshin këta qeveritarë, funksionarë ose privatë”. Shih: <http://www.pp.gov.al> (aksesuar online: 01/12/2017).

Ndërkombëtare, nëse shtetet e pranonin kompetencën e saj.²⁰ Kjo Konventë jo vetëm evidentoi domosdoshmërinë e një juridiksioni ndërkombëtar, por pati rëndësinë e saj edhe në drejtim të kodifikimit të krimeve ndërkombëtare. Për pasojë, e gjithë periudha pas hartimit të Konventës ishte një periudhë përpjekjesh për krijimin e një Gjykate Penale Ndërkombëtare. Këto përpjekje u finalizuan me Projekt Statutin për një Gjykatë Penale Ndërkombëtare, i hartuar si një shtojcë e raportit të Komisionit Ndërkombëtar të Ligjeve të Kombeve të Bashkuara në 31 Gusht 1953.²¹ Ky projekt në fakt nuk u bë realitet me arsyetimin se mungonte një përkufizim i krimit të agresionit. Përpjekje të tjera pasuan, por deri në vitet '90-të për shkak edhe të faktorëve historikë, shtetet dhe organizmat ndërkombëtare nuk mundën të finalizonin qëllimin për krijimin e një juridiksioni ndërkombëtar në fushën penale. Projekt Statuti për Gjykatën Penale Ndërkombëtare u përfundua nga Komisioni Ndërkombëtar i Ligjeve në vitin 1993. Ai iu nënshtrua disa rishikimeve nga komitetet përgatitore të ngritura nga Asambleja e Përgjithshme.²² Duke marrë në konsideratë punën paraprake të komiteteve përgatitore si dhe komentet e bëra nga shtetet anëtare, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së vendosi zhvillimin e një konference ndërkombëtare në Romë në 15-17 Korrik 1998.²³ Konferenca u zhvillua me pjesëmarrjen e e përfaqësuesve të 160 qeverive, 33 organizatave ndërqeveritare dhe një koalicion prej më shumë se 236 organizatave jo-qeveritare.²⁴ Siç u tha nga z. Tony Lloyd në emër të BE-së në fjalimin e tij të hapjes së Konferencës, qëllimi i kësaj të fundit ishte pikërisht gjetja e një marrëveshjeje për të krijuar një gjykatë të përhershme të vërtetë, të aftë për ta bërë botën më të sigurtë, të drejtë dhe paqësore: *“më të drejtë pasi ata që janë përgjegjës për veprime të egra kriminale nuk do të mbeten të pandëshkuar; më të sigurt, sepse Gjykata do të veprojë si një pengesë për ata që do të vepronin ndryshe; më paqësore sepse vetëdija që drejtësia do të bëhet mund të ndihmojë viktimat të lënë pas të kaluarën dhe të inkurajojnë të gjitha palët e përfshira për të marrë pjesë në procesin e pajtimit”*.²⁵ Në fakt, gjithmonë është menduar që të procedohen autorët e shkeljeve të drejtave të njeriut, duke paralajmëruar në këtë formë të gjithë se nuk do të ketë më asnjë tolerim dhe për këtë arsye çdo individ përgjegjës do të përgjigjet për veprimet e tij. Por shpesh qeveritë nuk kanë qenë në gjendje që të hetojnë shkelje të tilla ose të ndjekin penalisht autorët e dyshuar, prandaj Gjykatës Penale Ndërkombëtare i njëjhej e drejta legjitime, në mënyrë që të respektojë pajtueshmërinë ndërmjet ligjit ndërkombëtar me atë kombëtar dhe që të vendosë

²⁰ Në nenin 6 të Konventës ishte theksuar se: *“Personat e akuzuar për gjenocid ose cilindo nga aktet e tjera të përmendura në nenin III do të nxirren përpara gjykatave kompetente të Shtetit në tokën e të cilit është kryer akti ose përpara Gjykatës Ndërkombëtare kriminale e cila do të jetë kompetente kundrejt atyre nga Palët kontraktuese që do të kenë njohur juridiksionin e saj”*. Shih: <http://www.pp.gov.al> (aksesuar online: 01/12/2017).

²¹ Kyriakakis, J., Corporations before International Criminal Courts: Implications for the International Criminal Justice Project, *Leiden Journal of International Law*, Vol.30, Issue 1, Mars 2017, f. 234.

²² Ibid.

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së krijoi dy komitete përgatitore, fillimisht një komitet *ad hoc* të krijuar me Rezolutën 49/73 të 9 Dhjetorit 1994 dhe një komitet të mëvonshëm me Rezolutën 50/46 të 11 Dhjetorit 1995.

²³ Xhafo, J., *E drejta penale ndërkombëtare*, Shtëpia botuese: GEER, Tiranë, 2009, f. 197-198.

²⁴ Kyriakakis, J., Corporations before International Criminal Courts: Implications for the International Criminal Justice Project, *Leiden Journal of International Law*, Vol.30, Issue 1, Mars 2017, f. 232.

²⁵ Opinioni i shprehur nga Tony Lloyd për llogari të Bashkimit Evropian, Sekretar i Shtetit për Ministrinë e Jashtme Britanike, *Terra Viva*, Nr.2, 16 Qershor 1998, f. 1-2.

përpara drejtësisë të gjithë ata që e kanë shkelur. Gjykata do të shërbente për të ndëshkuar fajtorët, për të ndaluar ciklin e abuzimit dhe mos ndëshkimit, dhe kështu viktimat, familjet e tyre dhe shoqëria në tërësi mund ta njihnin të vërtetën dhe të pajtoheshin me të në një mënyrë të qëndrueshme.

1.2. Koncepti i ‘gjenocidit’ në legjislacionin ndërkombëtar

Terminologjia “gjenocid” e përpiluar nga avokati polak hebre Rafael Lemkin, menjëherë na sjell në kujtime tmerret e përjetuara të Holokaustit dhe Luftës së Dytë Botërore dhe shfarosjen metodike dhe të organizuar të miliona qenieve njerëzore. Lemkin në veprën e tij “*Rregulli i Boshtit në Evropën e Okupuar: Ligjet e Pushtimit - Analiza e Qeverisë - Propozimet për Korrigjim*” e përkufizoi gjenocidin si: “shkatërrimi i një kombi apo i një grupi etnik”²⁶. Ai sqaronte prejardhjen e fjalës nga greqishtja e lashtë *genos*, që nënkuptonte racë ose fis dhe nga latinishtja e lashtë *-cide*, duke nënkuptuar vrasje. Megjithëse Lemkin nëpërmjet kësaj terminologjie synonte të nënkuptonte më tepër sesa thjesht vrasjen e njerëzve. Gjenocidi, në kuptimin e tij origjinal nga krijuesi i tij, kishte për qëllim “të nënkuptonte një plan të koordinuar të veprimeve të ndryshme që synonin shkatërrimin e themeleve esenciale të jetës së grupeve kombëtare me qëllim asgjësimin e vetë grupeve”²⁷. Me interes dhe rëndësi është njohja se, megjithëse Lemkin e shpiku termin “gjenocid” në vitin 1944, si një reagim ndaj praktikave naziste të Luftës së Dytë Botërore, ai iu drejtua rreziqeve ndërkombëtare të shkatërrimit sistematik (në masë). Në vitin 1933, në Konferencën e V-të për Unifikimin e Ligjit Penal në Madrid, Lemkin paraqiti një raport të titulluar “Veprat që përbëjnë rrezik të përgjithshëm (transnacional) konsiderohen si vepra penale kundër ligjit të kombeve”. Në këtë konferencë, Lemkin propozoi që ‘aktet e barbarizmave’ dhe ‘aktet e vandalizmave’ të përfshihen në një listë të veprave penale kundër ligjit të kombeve. Në veprën e tij të vitit 1944 “*Rregulli i bushtit...*”, ai specifikoi se këto dy lloje aktesh (të pretenduara nga ai në Konferencë, në vitin 1933) ishin ‘koncepti aktual i gjenocidit’.²⁸ Lemkin i përkufizonte “aktet e barbaritetit” si: “para së gjithash, aktet e shfarosjes të drejtuara kundër kolektiviteteve etnike, fetare ose shoqërore, pavarësisht nga motivi (politik, fetar, etj.); për shembull masakra, veprime të ndërmarra për të prishur ekzistencën ekonomike të anëtarëve të kolektivitetit, etj. Gjithashtu, që i përkasin kësaj kategorie janë të gjitha llojet e brutalitetit që sulmojnë dinjitetin e individit në rastet kur këto veprime të poshtërimit kanë burimin e tyre në një fushatë shfarosëse të drejtuar kundër kolektivitetit në të cilin viktimat është anëtare”²⁹. Lemkin argumentonte se secili nga aktet individuale dënohet si krim individual sipas kodeve ligjore vendore, ndërsa akti i barbarisë është shuma kolektive e këtyre veprave individuale në një fushatë që kërcënon ligjin e kombeve. Përveç këtyre akteve të barbarisë kundër kolektivitetit, Lemkin shton “akte të vandalizmit”, të cilat “*marrin formën e*

²⁶ Lemkin, R., *Axis Rule in Occupied Europe: Laws of Occupation – Analysis of Government – Proposals for Redress*, Carnegie Endowment for International Peace, Washington DC, 1944, f. 79.

²⁷ Ibid.

²⁸ Ibid., f. 91.

²⁹ Lemkin, R., “Veprat që përbëjnë rrezik të përgjithshëm (transnacional) konsiderohen si vepra penale kundër ligjit të kombeve”, paraqitur në Konferencën e V-të Vjetore për Unifikimin e Ligjit Penal në Madrid, Tetor 1933, f. 5. Shih: www.preventgenocide.org/lemkin/madrid1933-english.htm (aksesuar online: 02/12/2017).

*shkatërrimit sistematik dhe të organizuar të artit dhe trashëgimisë kulturore në të cilën gjenia unike dhe arritja e një kolektiviteti janë zbuluar në fushat e shkencës, artit dhe letërsisë*³⁰. Të marra së bashku, këto dy akte (barbarizmi dhe vandalizmi) synojnë të shkatërrojnë jo vetëm individët fizikë të kolektivitetit, por edhe të gjithë bazën sociale, kulturore, politike dhe ekonomike të kolektivitetit të një grupi të veçantë. Lemkin propozoi që këto dy akte të përfshiheshin në listën e Konferencës së I-rë të Varshavës mbi Unifikimin e Ligjit Penal, referuar parimit universal të represionit, që do të thotë se kryerësi i një krimi në listë mund të ndiqet penalisht në vendin ku është kapur, pa marrë parasysh vendin në të cilin është kryer krimi ose shtetësinë e kryerësit.³¹ Një vëzhgues i mprehtë do të vërë re se propozimi i Lemkin bazohet në qëllimin e kryerësit, në vend të aktit. Ai me lehtësi pranon në punimin e tij se veprimet individuale dënohen sipas ligjeve kombëtare dhe vetëm kur “këto akte kanë burimin e tyre në një fushatë shfarosëse të drejtuar kundër kolektivitetit në të cilin viktimat është anëtare”. Për më tepër, në trajtimin e aktit të gjenocidit, Lemkin e përkufizon krimin si “shkatërrim sistematik dhe të organizuar”, që do të sugjeronte përjashtimin ligjor të veprimeve spontane ose trazirat kundër një grupi të caktuar. Sidoqoftë propozimet e Lemkin në këtë konferencë nuk u miratuan, por nëse do të miratoheshin kjo do të sillte një sërë avantazhesh në njohjen e një terminologjie dhe prejardhjeje të qartë të skemave dhe akteve gjenocidiale që u ndërmorën më vonë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Mendoj se marrja parasysh e analizës së thelluar terminologjike do të ndihmonte në hartimin e mekanizmave të parandalimit në aspektin legal dhe sociologjik. Stigma morale dhe shoqërore e huazuar nga kjo fjalë është një nga arsyt kryesore për të cilat shtetet dhe aktorët e tjerë politik e përdorin atë në diskursin ndërkombëtar ose më shpesh përpiqen me dëshpërim të mos e përdorin atë.

1.2.1. Ndihmesa e dhënë nga Kombet e Bashkuara mbi konceptimin e gjenocidit

Kombet e Bashkuara gjithashtu kanë një meritë të jashtëzakonshme në përpilimin e mekanizmave për parandalimin dhe luftimin e akteve gjenocidiale, si dhe në kontributin e dhënë në përkufizimin unilateral të gjenocidit. Në vitin 1946, Rezoluta 96-të e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara pohoi se: *“gjenocidi është një krim sipas ligjit*

³⁰ Ibid., f. 6.

³¹ Krimet në listën origjinale të represionit universal në Konferencën e Varshavës 1927 ishin pirateria; falsifikimi i monedhave, kartëmonedhave dhe letrave me vlerë; tregtia në skllëvër; tregtia e grave apo fëmijëve; përdorimi i qëllimshëm i çdo instrumenti të aftë për të prodhuar rrezik publik; tregtia e narkotikëve; dhe trafikimi në publikimet e turpshme. Në mënyrë interesante, në vitin 1930, Konferenca e 3-të shtoi “[terrorizmin]” (duke përfshirë edhe) veprën penale të përdorimit të qëllimshëm të çdo instrumenti të aftë për të prodhuar rrezik publik. Në vitin 1933, Lemkin pastaj e zgjeroi këtë terminologji nga “rreziku publik” në “rrezikun transnacional (e përgjithshëm)”, duke argumentuar se ligji i kombeve kërcënohet kur “rreziku i përgjithshëm (transnacional)” kërcënon interesat e disa shteteve dhe banorëve të tyre. Lemkin e vendos fjalën ‘transnacional’ në kllapa në vetë shkrimin e tij. Ai pastaj e merr këtë nocion në kontekstin e një rreziku të përgjithshëm për të paraqitur propozimin e tij për të shtuar aktet e barbarisë dhe të vandalizmit në listën e krimeve të denjë për represionin universal të hartuar nga punimet e kësaj konference, duke propozuar gjithashtu shtimin e krimeve të provokimit të katastrofave në komunikimet ndërkombëtare; ndërprerja me dashje e komunikimeve ndërkombëtare; dhe përhapjen e sëmundjeve ngjitëse nëpërmjet njerëzve, kafshëve ose ushqimeve.

ndërkombëtar që e dënon bota e civilizuar³² Sipas kësaj Rezolute “*gjenocidi është mohimi i së drejtës së ekzistencës së të gjithë grupeve njerëzore ...*”.³³ Kjo rezolutë pastaj bëri thirrje që Këshilli Ekonomik dhe Social të ndërmerre studimet e nevojshme, me synimin për të hartuar një projekt-konventë për krimin e gjenocidit. Kjo projekt-konventë e autorizuar në vitin 1946 u manifestua si Konventa e vitit 1948 për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit (Rezoluta 260 (III) A e 9 dhjetorit 1948). Konventa u ratifikua deri në fund të vitit 1950, me hyrjen në fuqi më 12 janar 1951. Konventa e vitit 1948 zgjeroi deklaratën e vitit 1946, e cila e inkriminoi gjenocidin. Së pari, përcakton në Nenin I se gjenocidi është një krim sipas ligjit ndërkombëtar, qoftë i kryer në kohë paqeje ose në kohën e luftës. Së dyti, ajo në masë të madhe e zgjeron përkufizimin e gjenocidit si më poshtë në nenin II:

“ Në këtë Konventë gjenocidi nënkupton çdo veprim të mëposhtëm të kryer me qëllim që të shkatërrojë, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar, si të tillë:

- *Vrasja e anëtarëve të grupit;*
- *Shkaktimi i dëmtimit të rëndë trupor apo mendor të anëtarëve të grupeve;*
- *Duke ndikuar qëllimisht në kushtet e jetës së grupit, duke llogaritur për të shkaktuar shkatërrimin e tij fizik në tërësi ose pjesërisht;*
- *Vendosja e masave për parandalimin e lindjeve brenda grupit;*
- *Transferimi me forcë i fëmijëve të grupit në një grup tjetër*”.³⁴

Në shikim të parë, ky “përkufizim” i gjenocidit duket se adreson shkatërrimin e menjëhershëm fizik të grupit. Megjithatë, një studim më i afërt i konceptit të gjenocidit të paraqitur në këtë Konventë zbulon se është shumë më i gjerë sesa aspekti fizik i menjëhershëm. Konventa specifikon gjenocidin si “ndonjë prej akteve...”, jo “të gjitha”, “shumicën” ose madje “disa”. E specifikon gjenocidin “me qëllimin për të shkatërruar, në tërësi ose pjesërisht” një grup. Kjo do të thotë se gjenocidi nuk duhet të përfshijë domosdoshmërisht tërësinë e grupit, por vlen edhe vetëm për një pjesë të anëtarëve të grupit, pasi këta anëtarë po shënjestrohen për shkak të anëtarësisë së tyre në kolektivitet, jo për shkak të identitetit të tyre individual. Specifikimi i pasojës, “dëm serioz mendor” për anëtarët e grupit është një tjetër element i rëndësishëm i frymës së konventës. Kështu që një akt nuk duhet të jetë një kërcënim fizik për grupin që të jetë gjenocid. Veprimet e ndërmarra për të dëmtuar ekzistencën ekonomike, sociale ose politike të grupit mund të argumentohen që mund të sjellin si pasojë “dëm serioz mendor”. As Konventa nuk kërkon që veprimet jo vdekjeprurëse të jenë në çfarëdo mënyre afatgjata ose të përhershme për t’u konsideruar gjenocidale. Kështu mund të shohim se Konventa e OKB-së është në përputhje me konceptin origjinal të Lemkin-it në vitin 1944, në të cilin gjenocidi është shumë më

³² Rezoluta 96 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara “Krimi i gjenocidit”, 11 Dhjetor 1946. Shih: <https://documents-dds-ny.un.org> (aksesuar online: 02/12/2017).

³³ Ibid.

³⁴ Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit, adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 9 Dhjetor 1948. Shih: <http://www.pp.gov.al> (aksesuar online: 02/12/2017).

tepër se vrasjet masive, megjithëse ky është sigurisht një aspekt i manifestimit të saj në Evropën e shekullit XX. Sidoqoftë, megjithëse “gjenocidi” nuk ishte i jashtëligjshëm ndërkombëtarisht deri pas Luftës së Dytë Botërore (1946), Lemkin saktësisht theksonte se disa ligje ndërkombëtare sipas Rregulloreve të Hagës kanë nxjerrë jashtë fushës së veprimit të tyre shumë prej akteve individuale të gjenocidit të kryera gjatë kohës së luftës.³⁵

1.2.2. Parashikimi i gjenocidit sipas Rregulloreve të Hagës

Rregulloret e Hagës të cilat rregullonin zhvillimin e luftës në tokë, të miratuara në 1907, ishin organi qeverisës i ligjeve të luftës para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore.³⁶ Këto rregulla nuk adresojnë në asnjë mënyrë sjelljen e brendshme të shteteve. Sidoqoftë, gjenocidi nuk ka të bëjë me luftën midis ushtrive dhe shteteve, por është lufta kundër një populli. Si i tillë, aktet e ndaluara nga rregulloret e Hagës të ndërmarra *de facto* ndaj civilëve të paarmatosur, mbulojnë ato akte individuale që përbëjnë një fushatë gjenocidi. Kreu III i Rregullave të Hagës (viti 1907) “*Autoriteti Ushtarak mbi Territorin e Shtetit Armiqësor, Nenet 42-56*” adreson autoritetin, përgjegjësitë dhe kufizimet e një force ushtarake pushtuese. Neni 43 thekson që okupatori duhet të rivendosë dhe të sigurojë rendin dhe sigurinë publike “*duke respektuar, nëse nuk është absolutisht i penguar, ligjet në fuqi në vend*”. Neni 46 ka parashikuar se: “*nderi dhe të drejtat e familjes, jeta e personave dhe prona private, si dhe bindjet dhe praktikat fetare, duhet të respektohen. Prona private nuk mund të konfiskohet*”. Neni 48 ka parashikuar se: “*nëse okupatori mbledh taksa...ai do ta bëjë këtë, sa më shumë të jetë e mundur, në përputhje me rregullat e vlerësimit në fuqi dhe si rrjedhim do të jetë i detyruar të mbulojë shpenzimet e administrimit të territorit të pushtuar në të njëjtën masë si qeveria legjitime*”. Ndër të tjera neni 52 ka theksuar se okupatori mund të marrë në posedim vetëm paratë në gjendje, fondet dhe letrat me vlerë të realizueshme të cilat janë në mënyrë rigoroze pronë e shtetit. Sipas këtyre rregulloreve institucionet e dedikuara për fenë, bamirësinë dhe arsimin, artet dhe shkencat, madje edhe kur janë pronë shtetërore, do të trajtohen si pronë private. Sekuestrimi, shkatërrimi ose dëmtimi i bërë institucioneve të këtij karakteri, monumenteve historike, veprave të artit dhe shkencës, është i ndaluar dhe duhet të bëhet objekt i procedurave ligjore.

1.3. Përgjegjësia e shtetit: Problematikat e hasura në rastin e akteve gjenocidiale (Çështja Bosnja dhe Hercegovina kundër Serbisë dhe Malit të Zi)

Gjykimi i datës 26 Shkurt 2007, e përballi Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë me rastin e Bosnjë Hercegovinës kundër Serbisë dhe Malit të Zi, një çështje e cila shënoi një moment historik në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare penale, pasi një shtet Sovran për herë të parë në histori po gjykohej për gjenocid para një autoriteti ndërkombëtar. Pavarësisht vështirësive të shumta procedurale dhe praktike, GJND duket se pati gjasa të vendoste mbi bazueshmërinë e

³⁵ Lemkin, R., *Axis Rule in Occupied Europe: Laws of Occupation – Analysis of Government – Proposals for Redress*, Carnegie Endowment for International Peace, Washington DC, 1944, f. 80-81.

³⁶ Konventa (IV) Mbi respektimin e ligjeve dhe zakoneve të luftës mbi tokë dhe aneksi i saj: Rregulloret lidhur me ligjet dhe pasojat e luftës mbi tokë, Hagë 18 Tetor 1907. Shih: <https://ihl-databases.icrc.org> (aksesuar online: 02/12/2017).

rastit të gjenocidit të paraqitur para Gjykatës 22 vjet më parë nga Bosnja dhe Hercegovina kundër Serbisë dhe Malit të Zi,³⁷ mbi përgjegjësinë e këtij të fundit për gjenocidin e kryer gjatë konfliktit boshnjak pas ndarjes së ish Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (RSFJ). Mendoj se analizimi i rrethanave faktike të kësaj çështjeje do të reflektojë domosdoshmërisht për lexuesin edhe vlerën e rëndësishme që ka ky gjykim në arenën ndërkombëtare. Lufta në Bosnjë dhe Hercegovinë nga viti 1992 deri në vitin 1995 pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë ishte konflikti më i dhunshëm evropian në 60 vitet e fundit dhe ngriti spektrin e urrejtjes etnike, të menduar për kohë të gjatë, varrosur nga shumica e evropianëve. Konflikti në Bosnje, vetë një mikro-kozmos multietnik brenda ish-Jugosllavisë, ishte më i përgjakshmi nga të gjitha luftërat jugosllave. Vlerësimet shkojnë nga njëqind mijë deri në dyqind e pesëdhjetë mijë të vdekur, kryesisht civilë, por nuk ka një shifër të besueshme dhe përfundimtare. Lufta përfundoi me Marrëveshjen e Paqes të Dejtonit të ndërmjetësuar nga amerikanët dhe evropianët, e cila jo vetëm që i dha fund luftimeve, por gjithashtu krijoi kuadrin e ri kushtetues të Bosnjës. Një nga tiparet kryesore të luftës ishte metoda kryesore e kryerjes së saj - pastrimit etnik. Krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe ndoshta edhe gjenocidi u kryen në shkallë të tillë, sa që arritën të fitonin vëmendjen dhe domosdoshmërinë e ndërhyrjes së bashkësisë ndërkombëtare dhe të iniciojnë një fazë të re në drejtësinë penale ndërkombëtare me krijimin e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (Tribunali i Hagës). Nga shumë krime të kryera gjatë kësaj periudhe, situata më e përgjakshme ishte masakra e korrikut 1995, ku më shumë se 7,000 burra dhe djem muslimanë boshnjakë u vranë nga Ushtria e Republikës Srpska, në qytetin e vogël boshnjak të Srebrenicës.³⁸ Ky akt i vrasjeve masive u njoh si gjenocid nga Tribunali i Hagës. Por masakra e Srebrenicës mbetet ende subjekt i dy pikëpamjeve të ndryshme: nga këndvështrimi i muslimanëve boshnjakë (dhe shumica e opinionit global), ajo shihet si krimi më i rëndë i kryer gjatë luftës në Bosnje dhe një simbol i agresionit serb, ndërsa për shumë serbë, si në Bosnje dhe në Serbi, vetë krimi është ose tërësisht i fabrikuar ose së paku, i fryrë jashtë proporcionit. Në vitin 1993, Bosnja dhe Hercegovina ngriti procedurë para GJND-së kundër RFJ-së, në përputhje me Konventën e Gjenocidit të vitit 1948, duke argumentuar se agresioni serb në Bosnje ishte gjenocid.³⁹ Në vitin 1996, Gjykata dha një aktgjykim mbi kundërshtimet paraprake të paraqitura nga RFJ-ja, duke gjetur se kishte juridiksion të dëgjonte rastin (ekskluzivisht) sipas nenit IX të

³⁷ Kjo çështje duke përfshirë vetëm objeksionet paraprake “Mbi Aplikimin e Konventës mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit” u gjykua nga ana e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, më 11 Korrik 1996. Me anë të këtij gjykimi Gjykata vendosi me 13 vota pro të trupës gjyqësore se: *“duke iu kthyer kërkesës së Jugosllavisë, Gjykata nuk gjen se rrethanat, siç paraqiten tani në Gjykatë, janë të tilla që kërkojnë një tregues më specifik të masave të adresuara ndaj Bosnje dhe Hercegovinës, në mënyrë që t’i kujtojnë asaj të dyja detyrimet sipas Konventës së Gjenocidit dhe nevojën për t’u përmbajtur nga veprimi i llojit të parashikuar nga paragrafi 52 B i Urdhrit të Gjykatës së 8 prillit 1993”*. Më në fund Gjykata i referojë kësaj dispozite, e cila i njihte fuqinë Gjykatës, në kohën kur është bërë kërkesa, për të ndërmarrë masa të përkohshme, duke vlerësuar masat e ndërmarra deri në atë moment si dhe të përcaktojë nëse këto rrethana kërkojnë që treguesit e masave të tjera të përkohshme të merren nga Palët për mbrojtjen e të drejtave sipas Konventës së Gjenocidit. Shih: <http://www.ictj-cij.org> (aksesuar online: 02/12/2017).

³⁸ Gjykimi i Dhomës së Apelit të Tribunalit të Hagës, në çështjen Prokurori kundër Radislav Krstić, IT-98-33-T, datë 19 Prill 2004. Shih: <http://www.icty.org> (aksesuar online: 02/12/2017).

³⁹ Procedura e aplikimit në institucion, e shënuar në Regjistrin e Gjykatës nr. 91, më 20 Mars 1993. Shih: <http://www.ictj-cij.org/en/case/91/institution-proceedings> (aksesuar online: 02/12/2017).

Konventës së Gjenocidit.⁴⁰ Pas rënies së Millosheviçit, autoritetet e reja të zgjedhura në mënyrë demokratike të RFJ-së (tani Serbia dhe Mali i Zi) tërhoqën kundër-pretendimet e bëra nga qeveria e mëparshme,⁴¹ si dhe aplikoi për rishikimin e vendimit të vitit 1996⁴², duke pretenduar se në vitin 1996 RFJ-ja nuk ishte anëtare e Kombeve të Bashkuara dhe e Statutit të Gjykatës e as palë në Konventën e Gjenocidit dhe se për këtë arsye GJND-ja kishte mungesë të juridiksionit. Në vitin 2003, Gjykata hodhi poshtë kërkesën për rishikimin e aktgjykimit të saj të mëparshëm.⁴³ Megjithatë, pas vendimit të saj të vitit 2004 në rastet e NATO-s, qeveria e Serbisë dhe Malit të Zi ka ngritur sërish çështjen e juridiksionit, e cila u përpunua në seancat dëgjimore, që zgjatën nga shkurti deri në maj 2006.⁴⁴ Çështja e anëtarësimit të RFJ-së në OKB ishte e mbushur me komplikime të tilla të panevojshme dhe vështirësi ligjore që mund të quhej vetëm rast *sui generis*. Manovrimi procedural i gjerë i Serbisë, ekuivalentimi dhe proceset gjyqësore strategjike e kanë çuar Gjykatën në një mundësi shumë reale për të gjetur se jurisprudenca e saj është në konflikt me vetveten, një situatë që sigurisht nuk vlerësohet si e tillë nga gjyqtarët e GJND-së. Siç vërehet nga këto rrethana faktike të detajuara nga shqyrtimi gjyqësor çështja e juridiksionit është shumë e komplikuar dhe në disa mënyra është rezultat i jurisprudencës tepër konfliktuale të Gjykatës. Unë, për fat të mire, nuk do të përfshihem në ndonjë diskutim të mëtejshëm të çështjes, përveçse të vërej se duke qenë se çështja ligjore është gjithnjë e më e paqartë, kështu do të mbizotërojnë elementet e politikës dhe maturisë gjyqësore. Standardi të provuarit i përdorur nga ana e Tribunalit të Hagës ishte i njëjti element që “ndihmoi” edhe GJND-në për t’i dhënë një zgjidhje objektive situatës. Pyetja që rrjedhimisht ngrihet është “*a duhet GJND-ja të zbatojë standardin e të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, në qasjen e saj për të provuar gjenocidin në këtë rast ?*” Në fund të fundit, siç argumenton Bosnja, prova përtej dyshimit të arsyeshëm është e rëndësishme vetëm për çështjen e përgjegjësisë penale individuale dhe jo për përgjegjësinë e shtetit përpara GJND-së, në atë që në thelb është një procedurë 'civile'. Megjithatë, unë besoj se përgjigjja duhet të jetë akoma pozitive dhe se ajo është përsëri një produkt i një dallimi të fortë mes rregullave primare dhe sekondare. Është e njohur nga doktrina dhe praktika gjyqësore se ekziston një problem i përgjithshëm në trajtimin e provave përpara gjykatave ndërkombëtare në përgjithësi dhe në GJND në veçanti, gjë që mund të shihet si rezultat i përplasjes midis dy kulturave ligjore. Por pavarësisht këtyre përplasjeve juridiko-ligjore, ekzistojnë disa fakte të pakontestueshme të cilat e kanë bazën e tyre në parimet e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare, të cilat kanë prevelancë mbi pretendimet e ndryshme të juridiksionit. ***Së pari***, edhe pse gjenocidi është një veprim ndërkombëtarisht i gabuar, ende mbetet një krim sipas ligjit ndërkombëtar. Siç u përmend edhe më sipër, rregullat parësore në

⁴⁰ Shih: <http://www.icj-cij.org/en/case/91/judgments> (aksesuar online: 02/12/2017).

⁴¹ Urdhër i datës 10 Shtator 2001. Shih: <http://www.icj-cij.org/en/case/91/orders> (aksesuar online: 02/12/2017).

⁴² Në procesverbalin e shkruar të dorëzuar nga Ambasada e Republikës Federale të Jugosllavisë (datë 20 Prill 2001), theksohej se: “*Tërheqja e kundërpadisë mbështetet edhe më tej nga fakti se Qeveria e re e Republikës Federale të Jugosllavisë fuqimisht beson se periudha e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve duhet të mbetet prapa dhe se të dy vendet duhet të lëvizin drejt një epoke bashkëpunimi dhe zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjeve në pritje*”. Shih: <http://www.icj-cij.org/en/case/91/written-proceedings> (aksesuar online: 02/12/2017).

⁴³ Shih: <http://www.icj-cij.org/en/case/91/judgments> (aksesuar online: 02/12/2017).

⁴⁴ Shih: <http://www.icj-cij.org/en/case/91/oral-proceedings> (aksesuar online: 02/12/2017).

lidhje me gjenocidin konsistojnë jo vetëm në Konventën e Gjenocidit (e cila sigurisht nuk thotë absolutisht asgjë në lidhje me standardet e provës), por edhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare penale të cilat GjND-ja duhet t'i shfrytëzojë gjatë interpretimit të Konventës. Dhe një nga këto parime është padyshim kërkesa e provës përtej dyshimit të arsyeshëm, e përcaktuar jo vetëm në Rregullat e Procedurës dhe Dëshmive⁴⁵, por dhe në jurisprudencën e Tribunalit të Hagës, nëpërmjet sanksionimit në Statutin e Romës mbi bazën e së cilit ushtron kompetencën e saj Gjykata Ndërkombëtare Penale.⁴⁶ Fakti se procedimet para GjND-së janë 'civile' dhe jo penale, nuk ka rëndësi, pasi që GjND-ja duhet të përcaktojë nëse një krim i caktuar është kryer në të vërtetë nga një person ose një grup personash, sipas rregullave parësore të së drejtës penale ndërkombëtare, kështu që nuk duhet të ndërmarrë një gjykim penal. Mendoj se gjenocidi nuk e humb statusin e tij si një krim thjesht sepse ekzistenca e tij vlerësohet në një proces gjyqësor mbi përgjegjësinë shtetërore. *Së dyti*, pikërisht për shkak se përgjegjësia individuale dhe shtetërore ezaurohen njëkohësisht është e domosdoshme të mbahen të njëjtat standarde provuese në gjykimet penale dhe në procedurat para GjND-së. Shmangia e interpretimeve të ndryshme të përkufizimit të gjenocidit dhe zbatimi i tij i ndryshëm në të njëjtat fakte është i mandatuar nga parimi themelor i sigurisë juridike dhe nevoja për parandalimin, nëse është e mundur, fragmentimin e së drejtës ndërkombëtare. Cuditërisht nga kjo praktikë gjyqësore ka rezultuar se ka qenë GjND-ja në pozitë që të fragmentojë kornizën e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare: pasi që GjND-ja duhet t'i rezistonte përpjekjes së Dhomës së Apelit të Tribunalit të Hagës në rastin Tadiç për të modifikuar rregullat e përgjegjësisë shtetërore pa ndonjë bazë në praktikën shtetërore, kështu që duhej që GjND-ja të tregonte njëfarë nderimi ndaj Tribunalit të Hagës në atë që ishte puna kryesore e Tribunalit, për të interpretuar të drejtën penale ndërkombëtare dhe për ta zbatuar atë në situata dhe raste që dalin nga hiri i ish-Jugosllavisë. Edhe pse konkluzionet ligjore të Tribunalit, në përgjithësi nuk kanë rezultuar në raste *res judicata* për GjND-në, provat e mbledhura nga Tribunali dhe të nënshtruar ndaj një procesi të drejtë dhe bazuar në parimin e kontradiktoritetit duhet të respektohen nga ana e GjND-së dhe duhet të plotësohen, nëse shikohet e nevojshme, me prova relevante dhe të besueshme. Nëse GjND-ja do të miratonte në mënyrë eksplicite apo implicite, të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm si standardi i duhur i provave, është e vështirë të arrijë Bosnja të provojë ndonjë rast të gjenocidit përveç masakrës së egër të Srebrenicës. Duhet theksuar edhe përpjekja e Tribunalit të Hagës për të arritur në përfundimin se Srebrenica ishte një rast i jashtëzakonshëm në masën e spastrimit etnik të kryer në Bosnjë, kryesisht nga serbët boshnjakë. Por Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë nëpërmjet testit të përgjegjësisë i dha përfundimisht një zgjidhje pikëpyetjeve që doktrina juridike synonte të ngrinte dhe të cilat keqpërdorëshin për zvarritjen e

⁴⁵ Rregulli 87 (A) i RRPD "Diskutimet" ka sanksionuar se: "*Kur të dyja palët kanë përfunduar paraqitjen e tyre, Kryetari i trupit gjykues e shpall seancën e mbyllur dhe Dhoma Gjyqësore do të shqyrtojë në mënyrë private. Gjetja e fajit mund të arrihet vetëm kur shumica e Dhomës Gjyqësore është e bindur se fajësia është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm*". Shih: <http://www.icty.org/en/documents/rules-procedure-evidence> (aksesuar online: 02/12/2017).

⁴⁶ Neni 66 (3) "Prezumimi i pafajësisë" i Statutit të Romës ka sanksionuar se: "*Për të dënuar të akuzuarin, Gjykata duhet të bindet për fajësinë e të akuzuarit përtej dyshimit të arsyeshëm*". Shih: <https://www.icc-cpi.int> (aksesuar online: 02/12/2017).

procesit gjyqëor. Në paragrafët 379 – 384 të vendimit dhënë për çështjen Bosnja dhe Hercegovina kundër Serbisë dhe Malit të Zi (datë 26 Shkurt 2007) është analizuar ky test, duke evidentuar tre çështjet themelore: **së pari**, duhet të përcaktohet nëse aktet e gjenocidit mund t'i atribuohen të paditurit sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare zakonore të përgjegjësisë së shtetit (kjo do të thotë të përcaktohet nëse veprimet janë kryer nga persona apo organe sjellja e të cilëve i atribuohet, posaçërisht në rastin e ngjarjeve në Srebrenicë, të paditurit); **së dyti**, Gjykata do të duhet të konstatojë nëse akte të llojit të përmendur në nenin III të Konventës, përveç vetë gjenocidit, janë kryer nga persona apo organe sjellja e të cilave i atribuohet të paditurit nën të njëjtat rregulla të përgjegjësisë shtetërore, domethënë veprat e përmendura në nenin III, paragrafët (b) deri (e), {njëra nga këto është pjesëmarrja në gjenocid}. Dhe **së fundmi**, do të jetë kompetencë e Gjykatës të vendosë lidhur me çështjen nëse i padituri është në përputhje me detyrimin e tij të dyfishtë që rrjedh nga neni I i Konventës për të parandaluar dhe dënuar gjenocidin.⁴⁷ Këto janë tre çështje alternative të cilat duhen shqyrtuar në çdo rast për të evidentuar saktësisht përgjegjësinë e shtetit në rastet e ndërmarrjes së akteve gjenocidiale. Nëse ndodh që Gjykata i përgjigjet negativisht dy çështjeve të para, atëherë domosdoshmërisht duhet shqyrtuar nëse i padituri ka përmbushur detyrimin e tij për parandalim, në lidhje me tërë akumulimin e fakteve që përbëjnë gjenocid. Nëse një shtet është përgjegjës për një akt gjenocidi (për shkak se është kryer nga një person ose organ, sjellja e të cilit i atribuohet Shtetit) ose për një nga aktet e tjera të përmendura në nenin III të Konventës (për të njëjtën arsye), atëherë nuk ka asnjë pikë dyshimi në pyetjen nëse ai ka përmbushur detyrimin e tij të parandalimit në lidhje me të njëjtat akte, sepse logjika dikton që një shtet nuk mund të ketë përmbushur një detyrim për të parandaluar gjenocidin në të cilin ai ka marrë pjesë në mënyrë aktive. Nga ana tjetër, është e qartë, që nëse një shtet nuk është përgjegjës për ndonjë nga aktet e përmendura në nenin III, paragrafët (a) deri (e) të Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e krimit të gjenocidit, kjo nuk do të thotë se përgjegjësia e tij nuk mund të kërkohej për shkelje të detyrimit për të parandaluar gjenocidin dhe aktet e tjera të përmendura në nenin III. Rregulli i sjelljes së organeve të shtetit, si një zakon ndërkombëtar i gjithëpranuar, duhet të analizohet duke u bazuar në nenin 4 të Artikujve mbi Përgjegjësinë e shteteve për veprime të gabuara ndërkombëtarisht, të adoptuar nga Komisioni i Ligjit Ndërkombëtar në sesionin e tij të 53-të (2001), ku është sanksionuar se: *“Sjellja e ndonjë organi shtetëror konsiderohet një akt i atij shteti sipas të drejtës ndërkombëtare, pavarësisht nëse organi ushtron funksione legislative, ekzekutive, gjyqësore ose ndonjë funksion tjetër, cilido qoftë pozicioni që ai mban në organizimin e shtetit dhe cilido qoftë karakteri i tij si organ i qeverisë qendrore ose i njësisë territoriale të shtetit. Një organ përfshin çdo person ose subjekt që e ka atë status në përputhje me ligjin e brendshëm të Shtetit”*.⁴⁸ Kur zbatohet për rastin aktual, ky rregull kërkon së pari përcaktimin nëse aktet e gjenocidit të kryera në Srebrenicë janë kryer nga “persona ose subjekte” që kanë statusin e organeve të Republikës Federale të Jugosllavisë (pasi i padituri ishte i njohur në atë kohë) sipas

⁴⁷ Paragrafët 379 – 384 të vendimit dhënë për çështjen Bosnja dhe Hercegovina kundër Serbisë dhe Malit të Zi (datë 26 Shkurt 2007), Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, f. 161. Shih: <http://www.icj-cij.org/en/case/91/judgments> (aksesuar online: 02/12/2017).

⁴⁸ Shih: <http://legal.un.org> (aksesuar online: 02/12/2017).

ligjit të brendshëm në fuqi. Por nga provat nuk ka rezultuar se ushtria e RFJ-së mori pjesë në masakrat, as që udhëheqësit politikë të RFJ-së kishin dorë në përgatitjen, planifikimin ose në ndonjë mënyrë të kryerjes së masakrave. Prandaj, Gjykata konstaton se aktet e gjenocidit në Srebrenicë nuk mund t'i atribuohen palës përgjegjëse si të kryera nga organet e saj ose nga persona ose subjekte tërësisht të varura prej saj, dhe kështu nuk konstituojnë mbi këtë bazë përgjegjësinë ndërkombëtare të përgjegjësit.⁴⁹ Në përfundim të këtij procesi gjyqësor rezultoi me trembëdhjetë vota se Serbia nuk ka kryer, nuk ka komplotuar për të kryer dhe nuk ka qenë e përfshirë në gjenocid, duke shkelur Konventën për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit. Por u konkludua se Serbia ka shkelur detyrimin për të parandaluar gjenocidin (detyrim i cili rrjedh nga Konventa); ka shkelur detyrimet duke dështuar për të transferuar Ratko Mlladiç, i paditur për gjenocid dhe pjesëmarrje në gjenocid, për t'u gjykuar nga ana e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, dhe kështu duke dështuar plotësisht për të bashkëpunuar me atë gjykatë; si dhe ka shkelur detyrimin për të përmbushur masat e përkohshme të urdhëruara nga Gjykata më 8 prill dhe 13 shtator 1993.

Siç është treguar, çështja e përgjegjësisë shtetërore të Serbisë për kryerjen e gjenocidit në rastin e masakrës së Srebrenicës ka qenë faktikisht shumë komplekse dhe ka ofruar vështirësi të shumta provuese ndaj palës boshnjake. Çështja e Bosnjës kundër Serbisë tregoi se vështirësitë kryesore me të cilat u ballafaqua GJND-ja kur kanë të bëjnë me përgjegjësinë e shtetit për gjenocid nuk janë rreptësisht ligjore, por kanë lidhje më së tepërmi me fakte dhe prova evidente.

Historikisht, e drejta ndërkombëtare ka të bëjë vetëm me veprimet e shteteve, ndërsa individët përmes të cilëve shtetet kanë vepruar mbesin pothuajse tërësisht jashtë fushëveprimit të saj. Megjithatë, që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë, sistemi ligjor ndërkombëtar ka parë një ringjallje të ideve lëvizëse prapa gjykimit të Nurembergut dhe Tokios - atë të vendosjes së përgjegjësisë penale individuale për mizoritë e rënda dhe shkeljet masive të të drejtave të njeriut dhe ligjet e konfliktit të armatosur, sipas ligjit ndërkombëtar dhe para gjykatave ndërkombëtare, nëse sistemet gjyqësore të brendshme nuk ishin të gatshme ose nuk ishin në gjendje të ndiqnin penalisht shkelësit. Themelimi i gjykatave penale ndërkombëtare *ad hoc* për ish Jugosllavinë dhe Ruandën, nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së dhe zhvillimi i gjykatave penale hibride dhe të internacionalizuara si ajo për Sierra Leone përfundimisht kulmuan me krijimin e një Gjykate Penale Ndërkombëtare të Përhershme. Rëndësia e çështjes së Bosnjës kundër Serbisë vlen pasi është çështja e parë e cila siguroi mundësinë për gjykimin ndërkombëtar të përgjegjësisë shtetërore për krimin e gjenocidit. Gjyqtarët e GJND-së do të duhet të merren me shumë çështje komplekse të së drejtës ndërkombëtare dhe gjykimi i tyre do të ketë pasoja të gjëra.

Pavarësia ndërmjet vendimarrjes së GJND-së dhe Tribunalit të Hagës në rastin e Srebrenicës është totalisht e evident. Tribunali i Hagës (Dhoma e Apelit) në vendimin e marrë më 19 Prill 2004 në rastin **Prokurori kundër Radislav Krstić** mbajti një tjetër qëndrim në analizimin dhe

⁴⁹ Paragrafi 395 i vendimit dhënë për çështjen Bosnja dhe Hercegovina kundër Serbisë dhe Malit të Zi (datë 26 Shkurt 2007), Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, f. 167. Shih: <http://www.icj-cij.org/en/case/91/judgments> (aksesuar online: 02/12/2017).

dhënien përgjigje ndaj pyetjes nëse në Srebrenicë kishte ndodhur një akt gjenocidal apo jo. Gjykata mbështetej në arsyetimin e nenit 4 të Statutit të Tribunalit, i cili në të njëjtën linjë si Konventa e Gjenocidit, mbulon veprime të caktuara të bëra me “qëllimin për të shkatërruar tërësisht ose pjesërisht, *një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar*, si të tillë”. Dhoma e Gjykimit në shqyrtimin që i kishte bërë çështjes kishte konkluduar se muslimanët boshnjakë ishin një grup kombëtar i veçantë dhe i dallueshëm⁵⁰, dhe për këtë arsye u mbulua nga neni 4 i Statutit të Tribunalit.⁵¹ Përgjegjësia sipas tribunalit ishte e qartë pasi, Dhoma Gjyqësore gjeti se Radislav Krstić u bë komandant *de facto* i Trupave të Drinës në mbrëmjen e 13 korrikut 1995, me konfirmimin formal të komandës së tij pas një dekreti të 15 korrikut 1995 të lëshuar nga Presidenti Karadžić.⁵² Dhoma Gjyqësore në dhënien e këtij vendimi bazohej në dëshmitë e marra nëpërmjet procedurës së seancave dëgjimore, ku provoheshin plotësisht bisedimet ndërmjet ushtarëve të VRS-së (Ushtria Boshnjake Serbe), duke përfshirë të akuzuarit, të cilët kishin bashkëpunuar me forcat serbe boshnjake për të shkaktuar masakrën e Srebrenicës. Ndërsa për sa i përket elementit specifik të gjenocidit “*qëllimit për të shkatërruar*”, Tribunali (Dhoma e Apelit) argumentoi se: “*Konventa e Gjenocidit dhe e drejta zakonore ndërkombëtare në përgjithësi, ndalojnë vetëm shkatërrimin fizik ose biologjik të një grupi njerëzor. Dhoma Gjyqësore shprehimisht e pranoi këtë kufizim dhe shmangu çdo përkufizim më të gjerë*”.⁵³ Në këtë rast, rrethanat faktike, të zbuluara nga Dhoma Gjyqësore, lejojnë arritjen në konkluzionin se vrasja e burrave muslimanë boshnjakë është bërë me qëllim gjenocidal. Shkalla e vrasjes, e kombinuar me vetëdijen e shtabit kryesor të VRS-së për pasojat e dëmshme që do të kishte për bashkësinë muslimane boshnjake të Srebrenicës dhe me veprimet e tjera që shtabi kryesor mori për të siguruar rrënimin fizik të komunitetit, është një bazë faktike e mjaftueshme për gjetjen e qëllimit specifik gjenocidal. Graviteti i gjenocidit reflektohet në kërkesat e rrepta të cilat duhet të plotësohen përpara se kjo bindje të vendoset. Këto kërkesa - prova kërkuese e qëllimit specifik dhe tregimi se grupi ishte në shënjestër për shkatërrimin në tërësinë e tij ose në pjesën më të madhe. Ishte tërësisht logjik konkluzioni i arritur nga Dhoma Gjyqësore, e cila konkludonte se të paktën që nga 15 korriku 1995, Radislav Krstić kishte njohuri për synimin gjenocidal të disa prej anëtarëve të shtabit kryesor të VRS-së. Radislav Krstić ishte i vetëdijshëm se shtabi kryesor kishte resurse të pamjaftueshme për të kryer ekzekutimet dhe se pa përdorimin e burimeve të korpusit të Drinës, shtabi kryesor nuk do të kishte qenë në gjendje të zbatonte planin e tij gjenocidal. Z. Krstić e dinte se duke lejuar që burimet e korpusit të Drinës të përdorreshin ai po jepte një kontribut të konsiderueshëm në ekzekutimin e të burgosurve muslimanë boshnjakë. Përgjegjësia e Krstić karakterizohet me saktësi si ndihmë dhe inkurajim ndaj gjenocidit sipas

⁵⁰ Dhoma e Gjykimit ndër të tjera konkludoi se: “*Është vërtetuar se kur një bindje për gjenocid mbështetet në qëllimin për të shkatërruar një grup të mbrojtur "pjesërisht", kjo duhet të jetë një pjesë e konsiderueshme e atij grupi. Qëllimi i Konventës së Gjenocidit është të parandalojë shkatërrimin e qëllimshëm të të gjithë grupeve njerëzore dhe pjesa e synuar duhet të jetë mjaft e rëndësishme për të patur një ndikim në grupin në tërësi*”.

⁵¹ Vendimi i Dhomës së Gjykimit, Prokurori kundër Radislav Krstić, Nr.çështje: IT-98-33-T, Hagë, 2 Gusht 2001. Shih: <http://www.icty.org/case/krstic/4#tdec> (aksesuar online: 02/12/2017).

⁵² Ibid, parag. 328-331.

⁵³ Vendimi i Dhomës së Apelit, Prokurori kundër Radislav Krstić, Nr.çështje: IT-98-33-A, Hagë, 19 Prill 2004, Parag. 25, f. 8. Shih: <http://www.icty.org/case/krstic/4#tdec> (aksesuar online: 02/12/2017).

Nenit 7 (1) të Statutit dhe jo si pjesëmarrje në gjenocid sipas Nenit 4 (3) (e). Në mënyrë unanime Dhoma e Apelit e Tribunalit të Hagës e dënoi Radislav Krstić me 35 vite burgim, por ky vendim është ankimuar nga të dyja palët.

Përpos faktit se nuk ekziston një hierarki që nevojitet të zbatohet në rastin e vendimeve të marra nga Tribunali i Hagës apo nga GJND-ja, mendoj se një prevalencë dhe preçedencë i duhen dhënë vendimeve të ndërmarra nga Tribunali i Hagës. Ky Tribunal sikurse dhe Gjykata Ndërkombëtare Penale kanë një kompetencë specifike dhe juridiksion të posaçëm për të gjykuar veprat penale të parashikuara nga statutet respektive, ndër të tjera dhe gjenocidin. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND-ja) duhet të bazohet në vendimet e saj vetëm në rrethanat faktike dhe provuese të të dhënave dhe dëshmive të ofruara në shqyrtimin gjyqësor, duke hequr dorë nga ndikimet politike. Përfundim bëhet vetëm në rastet kur rrethanat faktike nuk e provojnë dot pjesëmarrjen e një subjekti të posaçëm (autoritet zyrtar) apo organi shtetëror në aktet gjenocidiale. Gjenocidi është krimi mbi krimet. Dhoma e Apelit në rastin e çështjes Krstić me të drejtë ka konkluduar se: *“Gjenocidi është një nga krimet më të këqija të njohura për njerëzimin dhe graviteti i tij reflektohet në kërkimin e rreptë të qëllimit specifik”*⁵⁴.

⁵⁴ Ibid, parag. 134.

KAPITULLI II

ANALIZË E ELEMENTËVE JURIDIKË TË KRIMIT TË GJENOCIDIT

2.1. Drama e ndodhur në territorin e ish- Jugosllavisë. Disa aspekte historike

Vitet '90-të paralajmëruan se në Jugosllavi ishte gati që të shpërthente një luftë civile midis njerëzve që i përkisnin kombeve të ndryshme, që besonin në fe dhe religjione të ndryshme e që zhvilloheshin përmes traditave kulturore po aq heterogjene. Masakrat horror që u përjetuan në këtë luftë në Kroaci dhe në Bosnjë Hercegovinë (territor i ish-Jugosllavisë) na detyrojnë që të besojmë forcërisht se nocioni i koshiençës etnike, të shfaqur nëpërmjet ideologjive nacionaliste logjikisht është në gjendje që të drejtojë popujt drejt një konflikti, lufte, krimi dhe madje drejt akteve gjenocidiale.⁵⁵ Nga viti 1918 deri në vitin 1991, Jugosllavia ishte një vend që shtrihej në Evropën Juglindore. Përbëhej nga 6 republika: Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Kroacia, Sllovenia, Maqedonia dhe Mali i Zi. Këto 6 republika përbërëse të Jugosllavisë ndryshonin shumë nga njëra-tjetra. Me përjashtim të Maqedonisë, e cila qëndroi në paqe gjatë Luftërave Jugosllave, secila nga republikat u shndërrua në vend të pavarur, por duke paguar një kosto të lartë njerëzore.⁵⁶ Megjithatë, është e vështirë të nënkuptohet lufta në ish-Jugosllavi si një konflikt ndëretnik, një konflikt fetar ose një konflikt racial, pasi ishte më tepër një luftë midis kombeve, qëllimi përfundimtar i të cilës ishte përcaktimi dhe demarkacioni i kufijve, si dhe zhvendosja e popullsisë.⁵⁷ Që nga lindja e idesë jugosllave, ajo që ishte më e rrënjësuar në popullatën sllave nuk ishte aq shumë parimi i një komuniteti politik që u njoh në një ligj të përbashkët, por më tepër në idenë e një komuniteti shoqëror të bazuar në unitetin gjuhësor dhe kulturor, duke u bërë kështu levë mbi emocionin dhe jo mbi arsyen. Për këtë arsye, megjithë përpjekjet e mëdha të Titos në marrjen e hapave mbresëlënës përpara në nivelin social, politik, kulturor dhe ekonomik, zhvillimi i entiteteve të ndryshme etnike të Ballkanit ishte i pashmangshëm.⁵⁸ Lindja e nacionalizmit të shekullit të XIX-të është pra në origjinë të konflikteve të ndryshme ballkanike që deri tani ka pasur sukses. Mbi të gjitha në Serbi, nacionalizmi i këtij shekulli zhvilloi idenë e një “Serbie të Madhe” të aftë për të bashkuar dhe mbajtur të gjithë popullsinë serbe të shpërndarë deri tani në rajonin e Ballkanit. Nën presionin e vazhdueshëm u vendos t’i jepej pavarësia Serbisë dhe Malit të Zi, me rastin e Kongresit të Berlinit të vitit 1878.⁵⁹ Por serbët nuk ishin të kënaqur vetëm me pavarësinë, por kërkuar gjithashtu një zgjerim të kufijve kombëtarë: pavarësisht arritjes së një zgjerimi të parë territorial për shkak të rënies së Perandorisë Osmane, pas luftërave ballkanike të 1912 dhe 1913, nacionalizmi serb aspiroi për një zgjerim të mëtejshëm të aftë për t’i bërë territoret e saj të konsideruara serbe dhe të përfshira në Perandorinë

⁵⁵ Mestrovic, S., *Genocide after Emotion: The Post-Emotional Balkan War*, Shtëpi botuese: Routledge, 2013, f. 91.

⁵⁶ Ching, J., *Genocide and the Bosnian War: Genocide in Modern Times*, Botim: The Rosen Publishing Group, 2009, f. 9.

⁵⁷ Bianchini, S., *La questione jugoslava: Collana XX secolo*, Shtëpi botuese: Giunti Editore, Firenze, 1999, f. 12.

⁵⁸ Mestrovic, S., *Genocide after Emotion: The Post-Emotional Balkan War*, Shtëpi botuese: Routledge, 2013, f. 102.

⁵⁹ Bianchini, S., *La questione jugoslava: Collana XX secolo*, Shtëpi botuese: Giunti Editore, Firenze, 1999, f. 20.

Austro-Hungareze të bien nën sundimin e saj.⁶⁰ Pikërisht për këtë arsye në vitin 1914 u vra Franc Ferdinandi. Rënia politike e Car Nikollës II, aleati më i madh i Serbisë, e udhëhoqi klasën sunduese serbe për të hyrë në kontakt me përfaqësuesit demokratikë të popujve sllavë, që deri atëherë i nënshtroheshin Perandorisë Austro-Hungareze që po shpërndahej, duke arritur më vonë gjatë nënshkrimit të Deklaratës së Korfuzit e cila deklaroi lindjen e menjëhershme të një shteti të ri demokratik dhe parlamentar midis serbëve, kroatëve dhe sllovenëve nën dinastinë e familjes Karadordević.⁶¹ Mbretëria e re serbo-kroato-sllovene u shpall kështu më 1 dhjetor 1918 nga princi Aleksandar.⁶² Tensionet shoqërore dhe vështirësitë ekonomike që rezultojnë nga fundi i konfliktit, treguan në centralizmin e Aleksandarit një faktor sigurie që çoi edhe në miratimin e një Kushtetute që ishte asgjë tjetër veçse demokratike, e cila afirmoi dominimin serb mbi dy popujt e tjerë. Heshtjet që pasuan ngacmonin princin deri në pikën e promovimit, në janar të vitit 1929, të një grushti shteti të aftë për të dhënë një shtysë të re për integrimin etnik-rajonat. Kështu lindi Jugosllavia e re e cila, për të kapërcyer nacionalizmin e ndryshëm, u riorganizua tërësisht nga këndvështrimi administrativ. Megjithatë, politika autoritare e Aleksandarit nuk i pëlqeu kundërshtarëve të tij, të cilët e vranë atë në vitin 1934, për të rimarrë fuqinë e humbur: natyrisht, zgjedhjet e vitit 1935 u zhvilluan nga një klimë kërcënimi dhe arrestimesh dhe fitorja e raportuar nga ekstremistët serbë ishte e mbuluar me një hije dyshimi.⁶³ Gjatë Luftës së Dytë Botërore, pushtimi italian i Shqipërisë dhe Greqisë rriti në shtetin jugosllav një ndjenjë rrethimi dhe një ndjenjë intolerance që rezultoi në rrëzimin e vetë shtetit sllav nën goditjet e italiano-gjermanëve në vitin 1941. Ndërsa vendi u shkatërrua, forcat komuniste të Titos u angazhuan thellë në rezistencë dhe gjatë gjithë vitit 1944 gradualisht e rimorën të gjithë vendin.⁶⁴ I frymëzuar nga pluralizmi etnik i Bashkimit Sovjetik, në vitin 1946 Tito organizoi Jugosllavinë e re në një federatë të gjashtë republikave dhe dy rajoneve autonome të bashkuara në Serbi. Megjithatë, ky federalizëm do të inkurajonte nacionalizmin vetëm për shkak të ndarjeve ekonomike, sociale dhe kulturore që do të zhvilloheshin në mesin e autonomive të ndryshme: për shembull, nëse Sllovenia ishte rajoni më i zhvilluar ekonomikisht, Bosnja dhe Hercegovina ishte shumica etnikisht e pabarabartë dhe provinca e Kosovës ishte më e prapambetura.⁶⁵ E gjithë kjo çoi në përforcimin, në secilën prej autonomive të ndryshme, të ndjenjës së vetë-identifikimit me një grup të caktuar etnik ose kombëtar, dhe kështu në vitin 1974 Tito vendosi të reformonte Kushtetutën me qëllim të rritjes së kufijve të autonomisë të gjashtë republikave dhe për të ngritur dy provincat në rangun e republikave të vërteta kombëtare. Reforma e la qeverinë federale me

⁶⁰ Militello, V., *Conflitti inter-etnici e tutela delle vittime: fra Corte penale internazionale e giurisdizione internazionale*, Vol. 13, Publikime të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Palermos, Botim: Giuffrè Editore, 2008, f. 90-92.

⁶¹ Bianchini, S., *La questione jugoslava: Collana XX secolo*, Shtëpi botuese: Giunti Editore, Firenze, 1999, f. 29.

⁶² Guida, F., *Dayton dieci anni dopo: guerra e pace nella ex Jugoslavia : atti del Convegno, Roma, 21-23 novembre 2005*, Vol. 113, Studime Historike Carocci, Botime: Carocci, 2007, f. 124.

⁶³ Bianchini, S., *La questione jugoslava: Collana XX secolo*, Shtëpi botuese: Giunti Editore, Firenze, 1999, f. 31.

⁶⁴ Ibid., f. 33.

⁶⁵ Militello, V., *Conflitti inter-etnici e tutela delle vittime: fra Corte penale internazionale e giurisdizione internazionale*, Vol. 13, Publikime të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Palermos, Botim: Giuffrè Editore, 2008, f. 91.

disa kompetenca, të tilla si menaxhimi i politikës së jashtme dhe ushtarake, dhe kjo e forcoi edhe më shumë pavarësinë, prandaj nuk është rastësi që federata jugosllave shpërtheu shpejt, në vitin 1980, nën autoritetin karizmatik të Titos.⁶⁶ Kriza filloi në Kosovë në mars të vitit 1981, kur shumica shqiptare ngriti një protestë kundër shkallës së lartë të papunësisë, analfabetizmit, prapambetjes dhe tërheqjes së republikës së tyre dhe kërkoi një bashkim të shpejtë të rajonit me Shqipërinë. Menjëherë shpërthyen antagonizmat që kishin qëndruar gjithmonë në heshtje brenda secilit grup etnik duke prodhuar një paralizë të tillë të aparatit shtetëror për të tërhequr gjithë federatën në humnerë. Ishte viti 1986 koha kur Slobodan Millosheviç, duke hipur mbi valën e nacionalizmit serb, mori detyrën e krijimit të një Jugosllavie të re, më të centralizuar, duke iu nënshtruar hegjemonisë serbe, me qëllim që të korrigjonte shpërbërjen që po ndodhte brenda kombit.⁶⁷ Ky synim ishte qartazi i papranueshëm për Kroacinë, Slloveninë dhe republikat e tjera, të cilat gjithashtu tentonin të merrnin kontrollin e procesit të tranzicionit postkomunist. Si rezultat, udhëheqësit politikë të autonomive të ndryshme kaluan nga akti duke vënë në praktikë politikën e veprës së kryer, për të cilën, që nga fillimi i vitit 1991, klima e “murit ndaj murit” kishte anuluar çdo kufizim të mundshëm të kompromisit.⁶⁸ Bisedimet e vetme që u mbajtën ishin ato midis Millosheviçit dhe udhëheqësve të Sllovenisë dhe Kroacisë, të cilët përballeshin vetëm me problemin e një ndarje të mundshme paqësore të këtyre dy republikave nga pjesa tjetër e federates, por këto takime u treguan të kota dhe madje keqësuan edhe më shumë marrëdhëniet midis palëve, aq shumë sa që të provokonin ndarjen e federatës aq shumë të dëshiruar, pasi që më 25 qershor 1991, parlamentet e Sllovenisë dhe Kroacisë votuan në fakt pavarësinë e republikave të tyre nga pjesa tjetër e Jugosllavisë.⁶⁹ Meqenëse rreth 500,000 serbë që banonin brenda kufijve të shteteve të reja kombëtare nuk ofruan asnjë garanci të veçantë për sigurinë, fuqia qendrore e federatës shpalli gjendjen e luftës duke lëshuar të gjitha forcat e armatosura në dispozicion të saj kundër këtyre shteteve të reja. Fillimisht, forcat jugosllave, kryesisht serbë, sulmuan Slloveninë, por nuk arritën të hynin në territorin slloven për shkak të rezistencës së fortë nga ushtria kombëtare e sapoformuar. Pas humbjes në fushën sllovene, Millosheviçi mbledhi të gjitha forcat e tij në Kroaci, duke shkaktuar një luftë më të gjatë dhe më të përgjakshme sesa lufta e mëparshme. Përhapja e bandave të armatosura dhe kriminaliteti në Kroaci, për shkak të mizorisë më të madhe të kësaj lufte, ishte për shkak të faktit se serbët e krahinës kroate dhe të Sllovenisë kundër pavarësisë së vendit vendosën të vetë-shpallin autonominë e tyre, mbështetur nga mbështetja e Millosheviqit i cili u siguroi atyre artileri, pajisje ushtarake, uniforma, automjete dhe të gjitha ato që i nevojiteshin luftës.⁷⁰ Duke marrë parasysh ashpërsinë e konfliktit dhe humbjet e mëdha në jetën njerëzore dhe shkatërrimin material, Këshilli i Sigurimit i OKB-së u ndje shpejt i detyruar të miratojë një sërë rezolutash për të ftuar luftëtarët që të pushojnë

⁶⁶ Arbitrio, R., *Il conflitto etnico: dinamiche sociali e strategie di intervento : il caso della ex Jugoslavia*, Shtëpi botuese: F. Angeli, 1998, f. 54.

⁶⁷ Bianchini, S., *La questione jugoslava: Collana XX secolo*, Shtëpi botuese: Giunti Editore, Firenze, 1999, f. 29.

⁶⁸ Ibid, f. 157.

⁶⁹ Ibid.

⁷⁰ Bassiouni, M.C., Manikas, P., *The law of the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia*, Shtëpi botuese: Transnational Publishers, 1996, f. 28.

armiqësitë dhe të pranojnë ndihma humanitare. Me Rezolutën 743 të 21 shkurtit 1992, u themelua UNPROFOR, një forcë mbrojtëse e ngarkuar me monitorimin e funksionimit të duhur të policisë vendore, për të shmangur çdo shkelje të të drejtave të njeriut dhe për të ruajtur paqen.⁷¹ Dy betejat që më së miri simbolizojnë hidhërimin e luftës serbo-kroate ishin ato të Vukovarit dhe Dubrovnikut: qyteti i Vukovarit rezistoi për tre muaj rrethimin serb, ndërsa bombardimet e Dubrovnikut, që u zhvilluan në dhjetor 1991, u konsideruan sulmet më të dhunshme të serbëve, të qëllimta, mbi civilët dhe monumentet kulturore.⁷² Me nënshkrimin e armëpushimit me Kroacinë në janar të vitit 1992, forcat e armatosura serbe filluan një luftë tjetër në territorin boshnjak kur Bosnjë-Hercegovina gjithashtu u deklarua si republikë e pavarur në mars të të njëjtit vit.⁷³ Më 6 prill, ndërsa komuniteti ndërkombëtar njohu shtetin e ri kombëtar boshnjak, serbët e Bosnjës e udhëhequr nga Karaxhiç shpallën pavarësinë e Republikës Serbe të tyre (Republika Srpska) dhe menjëherë konflikti shpërtheu, tashmë Sarajeva u mbajt në një rrethim të ashpër për një kohë të gjatë, dhe siç është raportuar edhe nga Komisioni i ekspertëve të emëruar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në vitin 1992, forcat ndërluftuese ndërtuan disa kampe përqendrimi, vazhduan ndërmarrjen e masakrave sistematike duke dëbuar civilët nga vendet e tyre të banimit, përdorën përdhunime masive dhe terrorizuan të gjithë popullsinë duke inicuar procesin e spastrimit etnik me anë të vrasjeve, torturave, arrestimeve dhe ndalimeve arbitrare, ekzekutimeve jashtëgjyqësore, përdhunimeve dhe sulmeve seksuale, izolimit të popullatës civile në geto, zhvendosje të detyruar, zhvendosje dhe deportimet e popullatës civile, ndërmarrjen e sulmeve ushtarake ose kërcënime për sulme kundër civilëve apo zonave civile dhe shkatërrim arbitrar të pronës private.⁷⁴ Komisioni i Ekspertëve ka numëruar rreth 200,000 viktima, 500,000 raste të torturës dhe 20,000 raste të përdhunimit dhe dhunës seksuale.⁷⁵ Mizoritë u intensifikuan edhe më shumë pas shpalljes së Bashkësisë Autonome të Bosnjë-Hercegovinës më 3 korrik 1992, kur lufta boshnjake u bë një luftë e vërtetë e të gjithëve kundër të gjithëve dhe që nga ky moment të gjitha palët ndërluftuese u transformuan, në të njëjtën kohë, në agresorë dhe viktima: serbët sulmuan muslimanët dhe kroatët, muslimanët sulmuan serbët dhe kroatët dhe kroatët sulmuan serbët dhe muslimanët. Lufta në këtë mënyrë u bë një luftë e vërtetë vëllavrasëse, siç citonte autori i njohur ndërkombëtar Lombezzi: *“Burrrat që kanë jetuar së bashku për breza, qytete të përbashkëta, lagje, apartamente, miqësi, lidhje, pasion, festë dhe tragjedi, zgjohen një ditë armiq të vdekshëm, të gatshëm për të kryer çdolloj*

⁷¹ Rezoluta 743 lëshuar nga Këshilli i Sigurimit, 1992, vendosi: *“Të krijojë nën autoritetin e tij, Forcën Mbrojtëse të Kombeve të Bashkuara (UNPROFOR) në përputhje me raportin e Sekretarit të Përgjithshëm (S/23592), të datës 15 Shkurt 1992”*. Shih: <https://www.nato.int/for/un/u920221a.htm> (aksesuar online: 03/12/2017).

⁷² Bassiouni, M.C., Manikas, P., *The law of the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia*, Shtëpi botuese: Transnational Publishers, 1996, f. 29.

⁷³ Lufta në Bosnjë-Hercegovinë filloi më 6 Prill 1992.

Mestrovic, S., *Genocide after Emotion: The Post-Emotional Balkan War*, Shtëpi botuese: Routledge, 2013, f. 91-92.

⁷⁴ Raporti final i Komisionit të Ekspertëve të emëruar nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, S/1994/674, datë 27 Maj 1994.

Shih: http://www.icty.org/x/file/About/OTP/un_commission_of_experts_report1994_en.pdf (aksesuar online: 03/12/2017).

⁷⁵ Ibid.

krimi".⁷⁶ Me fjalë të tjera, gjenocidi boshnjak mendoj se ka lindur për shkak të mungesës së shtetit, i cili hoqi dorë nga monopoli i dhunës dhe lejoi që një grup etnik të gllabërojë një tjetër pa qenë të aftë të mbajnë nën kontroll komandën ushtarake aktuale. Dhe duke u përballur me tmerrin e këtyre mizorive, në nëntor të vitit 1995, Shtetet e Bashkuara vendosën të thërrasin udhëheqësit e Serbisë, Kroacisë dhe Bosnje-Hercegovinës në Dejton, me qëllim nxitjen dhe përshpejtimin e procesit të paqes: traktati i hartuar zyrtarisht ratifikuar në Paris më 14 dhjetor të të njëjtit, i cili vendosi që Bosnje-Hercegovina do të mbetet një shtet unitar i përbërë nga dy entitete, Federata Kroato-Muslimane dhe Republika Autonome e Serbisë.⁷⁷ Me arritjen e paqes, puna e Tribunalit të Hagës merr një dimension të ri, sepse hetimet dhe kapja e të akuzuarit mund të lehtësohen në masë të madhe nga vendosja e kontingjentit të IFOR në terren. Nëse pjesa e luajtur nga Gjykata ishte e marginalizuar, edhe për shkak të vështirësive ekonomike, në vitin 1995 ajo ishte plotësisht operacionale dhe e gatshme për të luajtur një rol udhëheqës. Por fryma e paqes e "nënshkruar" në Dejton asnjëherë nuk ka qenë e gatshme që të pranohet dhe të respektohet me vullnet të lirë të palëve, pasi Republika Federale e Jugosllavisë, garantuese e politikës serbe të Bosnjës, në fakt plotësisht ndante linjën e saj të pandjeshme ndaj Tribunalit. Nevojat për politikën e jashtme, megjithatë kërkojnë diplomaci më të fortë dhe Millosheviqi dëshmonte në çdo moment edhe një herë zotësinë e dozimit të fjalëve dhe fakteve sipas një strategjie të saktë, me qëllim për të legjitimuar pa ekspozuar direkt veten për akuzat e mundshme të mosbashkëpunimit.

Ndihma e amerikanëve në territorin e ish-Jugosllavisë vlen që të ngrihet në pedestal mirënjohjeje në ditët e sotme, pasi qëndrimi i Shteteve të Bashkuara, më aktiv në krizë që nga ardhja e Bill Clinton, ndryshoi tashmë që nga korriku 1993 me "braktisjen përfundimtare të idealizmit origjinal Wilsonian" dhe shfaqjen e dëshirës për të "kërkuar një zgjidhje realiste dhe pragmatikën e krizës".⁷⁸ Megjithatë, politika amerikane gjithmonë do të mbetet e lidhur ngushtë me konsideratat abstrakte morale, me "tendencën për të sunduar mbi parimet dhe për të hedhur poshtë politikën dhe planet e të tjerëve" dhe pasojat që "qasjet politike amerikane shkuan nga mosveprimi virtual në veprim në masë të vogël".⁷⁹

2.2. Dallimi ndërmjet 'gjenocidit' dhe 'spastrimit etnik'

Shpesh ka pasur një konfuzion në ndarjen e terminologjisë dhe përdorimit të saktë të konceptit të 'gjenocidit' në krahasim me 'spastrimin etnik'. Ndër ata që studiojnë fenomenin e gjenocidit, ka shumë debate se cilat duhet të jenë karakteristikat e veçanta që e dallojnë atë nga rastet e tjera të vrasjeve masive, si një lloj i veçantë i mizorisë. Lufta në Kosovë ka ngatërruar gjërat edhe më shumë. Si mediat dhe anëtarët e qeverive perëndimore kanë keqpërdorur kategorinë e gjenocidit, duke përdorur metaforë mashtruese në këtë drejtim, duke krahasuar

⁷⁶ Lombezzi, M., *Bosnia: La torre dei teschi. Lessico di un genocidio*, Shtëpi botuese: Dalai, Milano, 1997, f. 33.

⁷⁷ Guida, F., *Dayton dieci anni dopo: guerra e pace nella ex Jugoslavia : atti del Convegno, Roma, 21-23 novembre 2005*, Vol. 113, Studime Historike Carocci, Botime: Carocci, 2007, f. 130.

⁷⁸ Pirjevec, J., *Le guerre jugoslave*, Shtëpi botuese: Eiuadi, Torino, 2001, f. 298.

⁷⁹ Gow, J., *Triumph of the Lack of Will. International Diplomacy and the Yugoslav War*, Botim: Hurst & Company, Londër, 1997, f. 208.

eksodin masiv të shqiptarëve ndaj deportimit të hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Prandaj është e rëndësishme të gjurmojmë kufirin që ndan gjenocidin nga spastrimi etnik. Autorët Dunne dhe Krosalak, dy kërkues të Universitetit të Galles, kanë parë nevojën për njohjen e spastrimit etnik si një krim specifik brenda ligjit ndërkombëtar humanitar, për të parandaluar zgjerimin e kategorisë së gjenocidit që të çojë në përkufizimin e atyre që janë operacione spastrimi etnik.⁸⁰ Kjo temë nuk synon të zvogëlojë rëndësinë e asaj që ka ndodhur në Jugosllavi apo gjetkë, por të identifikojë saktë dy dukuri të lidhura, por të ndryshme. Sipas interpretimit të tyre: *“Dallimi kryesor është se spastrimi etnik nënkupton largimin me forcë të një grupi viktimash nga një territor; kjo është një çështje e shpronësimit, e jo e shkatërrimit”*.⁸¹ Norman Naimark, në veprën e tij të fundit *“Politika e urrejtjes. Spastrimi etnik në Evropën bashkëkohore”* ka identifikuar qartë marrëdhëniet ndërmjet spastrimit etnik dhe gjenocidit, duke argumentuar se: *“Elementi kyç qëndron në intencionalitetin e aktit. Gjenocidi përfaqëson vrasjen me dashje të një pjese apo të një komuniteti të tërë, fetare ose kombëtare; qëllimi i tij është eliminimi i një ose më shumë popullatave. Nga ana tjetër, qëllimi i spastrimit etnik është të zhvendosë një popull nga një territor i përcaktuar dhe shpesh të fshijë të gjitha gjurmët e pranisë së tij... Në një ekstrem, spastrimi etnik është diçka si deportimi me forcë ... Në ekstremin tjetër, megjithatë, spastrimi etnik dhe gjenocidi ndryshojnë vetëm në qëllimin e tyre teorik: në praktikë, rezultatet e gjenocidit vihen re në fakt të parat, ndërsa në rastin e spastrimit etnik për të liruar territorin nga një popullsi përdoret vrasja masive”*.⁸² Prandaj, qëllimi i spastrimit etnik është të fitojë një territor dhe burimet e tij, ekskluzivisht për një grup ose komunitet të caktuar dhe për të dëbuar ata që nuk i përkasin asaj, me çfarëdo mënyre. Në përcaktimin e këtij koncepti është e rëndësishme të theksohet lidhja e tij me territorin, gjë që është një tjetër aspekt që e dallon atë nga gjenocidi. Në Jugosllavi, përkufizimi *etnicko ciscenje* ishte përdorur për herë të parë nga serbët, për të treguar atë që ata besonin se kishin ndodhur në Kosovë për llogarinë e tyre gjatë viteve '80-të. Ky term kohët e fundit përshkruan në mënyrë efektive një fenomen që ka ekzistuar gjithmonë në histori, zhvendosjen e detyruar të popullsisë, por thellësisht të lidhur në format e saj moderne me përvojën e shekullit të XX-të. Një shembull i këtij mekanizmi është politika e zbatuar në Kosovë nga Millosheviqi, kur, duke përfituar nga fillimi i bombardimeve dhe evakuimit nga rajoni i vëzhguesve ndërkombëtarë, ai vazhdoi, përmes rritjes së nivelit të dhunës, në dëbimin me forcë të një pjesë e madhe e popullsisë shqiptare.

2.3. Analizë e elementëve juridiko-penalë të gjenocidit sipas akteve ndërkombëtare

2.3.1. Parashikimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara (1948)

Siç është trajtuar në mënyrë të hollësishme në kapitullin e parë të këtij punimi, para se t'i jepej jetë terminologjisë së konceptit të 'gjenocidit' në kuadër të zhvillimit të Konferencës V Ndërkombëtare për Unifikimin e të Drejtës Penale, mbajtur në Madrid në 1933, Lemkin kishte

⁸⁰ Dunne, T., Krosalak, D., *Genocide: Knowing What it is That We Want to Remember, or Forget, Or Forgive*, Vol.4, Pjesa 1, *The International Journal of Human Rights*, 2000, f. 39.

⁸¹ Ibid, f. 36.

⁸² Naimark, N., *La politica dell'odio. La pulizia etnica nell'Europa contemporanea*, Botime: Laterza, 2002, f. 6.

propozuar që shkatërrimi i kolektivave racore, fetare dhe shoqërore duhet të njihet si një krim që duhet të nënshtrohet ndaj ligjit të kombeve. Në fakt, përkundër afirmimit të vonuar të termit në fjalë, ne mund të flasim për gjenocid edhe për të përcaktuar ngjarje të caktuara përpara vitit 1944, pasi tërë historia e njeriut kalon nga gjenocidet e panumërta dhe të egra, pasi që çdo formë e intolerancës dhe fanatizmit ideologjik, fetar apo anti-fetar mund të çojë në gjenocid, pa përjashtuar nacionalizmin dhe patriotizmin.⁸³ Mbetet të vihet në pikëpyetje se çfarë e bëri Lemkinin për të krijuar këtë term të ri, gjenocid, vetëm në vitin 1944: pasi nevoja për t'i dhënë jetë një fjale të tillë në të vërtetë u ndie nga juristi ynë vetëm gjatë Luftës së Dytë Botërore, për atë koncept ligjor në lidhje me shkatërrimin e grupeve njerëzore, pasi ata ishin bërë të vetëdijshëm për tmerret e kryera nga regjimi nazifashist në të gjithë Evropën midis 1933 dhe 1945.⁸⁴ Sipas Lemkin, “gjenocidi” nuk duhet thjesht të thotë shkatërrim i menjëhershëm i një kombi, por edhe asgjësimi politik që tenton të shkatërrojë individët e targetuar si anëtarë të një grupi të caktuar.⁸⁵ Krimi i gjenocidit për këtë arsye përfshin veprime të ndryshme: jo vetëm privimin e jetës, por edhe parandalimin e jetës (përmes praktikës së abortit, sterilizimit dhe gjymtimit seksual), si dhe veprime të konsideruara të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e qenieve njerëzore (të tilla si infeksionet artificiale, ndarja e detyruar e familjeve etj). Lemkin në veprën e tij merrte në konsideratë disa forma të gjenocidit, si: gjenocidi fizik (i destinuar si likuidimi i drejtpërdrejtë i grupit njerëzor, domethënë një vrasje në shkallë të gjerë); gjenocidi biologjik (që nënkupton përdorimin e mjeteve të dizajnuara për të parandaluar riprodhimin e jetës biologjike në mënyrë që të shkatërrojë një grup njerëzor, duke parandaluar rritjen e saj); gjenocidi kulturor (që sulmon vitalitetin e grupit deri në pikën e kërcënimit të ekzistencës së jetës shpirtërore) si dhe së fundmi juristi i njohur ka përmendur gjenocidin politik, ekonomik, social, fetar dhe moral.⁸⁶ Në përputhje me këto premisa dhe duke u bërë të vetëdijshëm për risitë aktuale, ndikuar nga tragjeditë e sistemit të krijuar nga nazistët në të gjithë Evropën e okupuar gjatë Luftës së Dytë Botërore, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara u detyrua të mblidhej në seancën e parë më 11 Dhjetor 1946, për të miratuar Rezolutën 96 (I) me të cilën u konkludua se:

“- Kjo Rezolutë pohon se gjenocidi është një krim i së drejtës ndërkombëtare që bota e civilizuar dënon dhe për përmbushjen e të cilit autorët kryesorë dhe bashkëpunëtorët e tyre,

⁸³ Lemkin, R., *Axis Rule in Occupied Europe: Laws of Occupation – Analysis of Government – Proposals for Redress*, Carnegie Endowment for International Peace, Washington DC, 1944, f. 79.

⁸⁴ Lemkin, R., Genocide as a crime under International Law, *American Journal of International Law*, Vol.41, 1947, f. 147. Shih: <http://www.preventgenocide.org> (aksesuar online: 03/12/2017).

⁸⁵ Sipas Lemkin, në veprën e tij “*Axis Rule in Occupied Europe*” argumentoi se: “...në përgjithësi, gjenocidi nuk do të thotë domosdoshmërisht shkatërrimi i menjëhershëm i një kombi, përveç kur realizohet me shfarosjen e të gjithë anëtarëve të një kombi. Përkundrazi, ajo synon të cakttojë një plan të koordinuar të veprimeve të ndryshme që synojnë shkatërrimin e themeleve thelbësore të jetës së grupeve kombëtare, për të asgjësuar vetë këto grupe. Objektivat e një plani të tillë do të ishin shpërbërja e institucioneve politike, sociale, kulturës, gjuhës, ndjenjave kombëtare, fesë dhe jetës ekonomike të grupeve kombëtare, si dhe shkatërrimit të sigurisë personale, lirisë, shëndetit, dinjitetit dhe madje edhe jetën e individëve që u përkasin grupeve të tilla. Gjenocidi drejtohet kundër grupit kombëtar si një entitet dhe veprimet që ai shkakton kryhen kundër individëve, jo për shkak të cilësive të tyre individuale, por si anëtarë të grupit kombëtar”.

⁸⁶ Lemkin, R., *Axis Rule in Occupied Europe: Laws of Occupation – Analysis of Government – Proposals for Redress*, Carnegie Endowment for International Peace, Washington DC, 1944, f. 79.

qofshin ata persona privatë, zyrtarë apo burra shteti, duhet të dënohen, pavarësisht nëse krimi është kryer për arsye raciale, fetare, politike ose të tjera;

- *i bën thirrje Shteteve Anëtare të miratojnë legjislacionin e nevojshëm për parandalimin dhe ndëshkimin e krimit;*
- *Rekomandon që shtetet duhet të organizohen për bashkëpunim ndërkombëtar, të aftë për të përshpejtuar procesin e parandalimit dhe ndëshkimit të krimit të gjenocidit;*
- *kërkon që Këshilli Ekonomik dhe Social të ndërmarrë studimet e nevojshme me qëllim hartimin e një projekt-konvente mbi krimin e gjenocidit që do të prezantohet në seancën e ardhshme të rregullt të vetë Asamblesë së Përgjithshme”.⁸⁷*

Për t’iu përgjigjur detyrimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Ekonomik dhe Social i ngarkoi Sekretarit të Përgjithshëm detyrën për të hartuar një draft konventë, diçka që ai bëri në bashkëpunim me profesorët Lemkin, Pella dhe Donnedieu de Vabres. Pasi që studimi nuk ishte kryer nga komisionet dhe qeveritë nuk kishin mundur të kontribuonin, Këshilli e transmetoi projektin në Asamblenë e Përgjithshme dhe kjo, në seancën e dytë, miratoi Rezolutën 180 (II) të 21 nëntorit 1947 me anë të së cilës përcaktoi se: *“gjenocidi është një krim ndërkombëtar që përfshin përgjegjësi kombëtare dhe ndërkombëtare për individët dhe shtetet”*.⁸⁸ Nëpërmjet kësaj Rezolute e udhëzoi Këshillin për të vazhduar punën e tij për të vendosur tekstin përfundimtar të Konventës. Si pasojë, Këshilli Ekonomik dhe Social vendosi të ngrejë një Komitet Special prej shtatë anëtarësh për përgatitjen e draft-konventës së kërkuar. Të bashkuar nga 5 prilli deri më 10 maj 1948, komiteti i posaçëm përgatiti një raport që përmbante projekt-konventën e tij, një ftesë për Komisionin Ndërkombëtar të Drejtësisë për të hetuar mundësinë dhe dëshirën për të ngritur një organ ndërkombëtar gjyqësor për të proceduar personat e akuzuar për gjenocid, si dhe një rekomandim drejtuar palëve të Konventës për të marrë masat e nevojshme për të zbatuar sa më shpejt dispozitat e Konventës. Projekti u dërgua për t’u shqyrtuar në Asamblenë e Përgjithshme, e cila në mbledhjen e saj në Paris, miratoi me unanimitet tekstin, e titulluar “Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit”, me anë të Rezolutës 260 (III) të 9 Dhjetorit 1948.⁸⁹ Preambula e Konventës përshtatet mirë në perspektivën historike të ngjarjeve të epokës, duke lidhur jo vetëm me Rezolutën 96 (I) të përmendur në mënyrë eksplicite, por edhe me dënimet e dhëna nga Tribunali Ndërkombëtar Ushtarak i Nurembergut. Që nga fillimi, palët kontraktuese prezantojnë ato parime dhe ide themelore të cilat pastaj do të përfshihen dhe zgjerohen gjerësisht në dispozitat vijuese. Megjithëse një përsëritje e tillë mund të duket e tepërt, në të vërtetë çdo ligjvënës i mirë gjithmonë fillon punën e tij duke specifikuar frymën e tij në preambulë, pikërisht sepse kjo përbën mjetet me të cilat arsyet dhe motivet e paktit të përfunduar janë të ekspozuar ndaj opinionit publik ndërkombëtar. Rrjedhimisht, është në preambulë që palët

⁸⁷ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 96 (I) më 11 Dhjetor 1946, *United Nations Yearbook*, 1946-’47, f. 255-256. Shih: <https://documents-dds-ny.un.org> (aksesuar online: 03/12/2017).

⁸⁸ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 190 (II) më 21 Nëntor 1947, “Draft-Konventa e Gjenocidit”, *United Nations Yearbook*, 1946-’47, f. 129-130. Shih: <https://documents-dds-ny.un.org> (aksesuar online: 03/12/2017).

⁸⁹ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 260 (III) më 9 Dhjetor 1948, “Adoptimi i Konventës mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit, dhe teksti i Konventës”, *United Nations Yearbook*, 1948, f. 174-178. Shih: <https://documents-dds-ny.un.org> (aksesuar online: 03/12/2017).

kontraktuese shprehin besimin se vetëm bashkëpunimi ndërkombëtar mund të shërbejë si një mjet i vlefshëm dhe i domosdoshëm për të parandaluar përsëritjen e gjenocidit.

Në **nenin 1** të Konventës është theksuar se: *“Palët Kontraktuese konfirmojnë se gjenocidi, qoftë i kryer në kohë paqeje ose në kohën e luftës, është një krim sipas ligjit ndërkombëtar të cilin ata ndërmarrin për ta parandaluar dhe për ta ndëshkuar”*⁹⁰.

Artikulli i parë i Konventës riafirmon qëndrimin e Asamblesë së Përgjithshme në Rezolutën e përmendur tashmë 96 (I): pikërisht sepse është një krim që mund të ndiqet penalisht pavarësisht nëse është kryer në kohë lufte ose në kohë paqeje, gjenocidi merr karakteristikat e veta që shërbejnë për ta dalluar atë nga çdo lloj tjetër krimi. Pas një sqarimi të tillë të rëndësishëm, palët kontraktuese do ta njohin gjenocidin si një krim të së drejtës ndërkombëtare, në mënyrë që të promovonin angazhimin e të gjithëve në parandalimin dhe ndëshkimin e tij. Si një krim i së drejtës ndërkombëtare, parimi është që, përballë kryerjes së veprimeve çnjerëzore nga një shtet, ose në çdo rast me mospërfillje të autoriteteve shtetërore, në dëm të qytetarëve të tij, të gjitha shtetet e tjera mund të ndërhyjnë me autoritet të plotë për t'i ndaluar ato. Pra anashkalohet pengesa e krijuar nëpërmjet parimit të ‘domenit të rezervuar’ të shtetit, mbi bazën e së cilit çdo shtet konsiderohet i lirë nga detyrimet ndërkombëtare në të gjithë ata sektorë që nuk rregullohen nga normat e përgjithshme në fuqi, as nga detyrimet e pranuar ndërkombëtarisht nga vetë shteti, ose organizata ndërkombëtare në të cilat shteti është anëtar.

Neni 2 i Konventës ka parashikuar se: *“Për qëllime të kësaj Konvente, gjenocidi nënkupton çdo akt të mëposhtëm të kryer me qëllim të shkatërrimit të një grupi kombëtar, etnik, racial ose fetar si të tillë në tërësi ose pjesërisht:*

- *vrasjen e anëtarëve fizikë të grupit;*
- *sulm ndaj integritetit fizik apo mendor të anëtarëve të grupit;*
- *vendosja e qëllimshme e grupit ndaj kushteve të ekzistencës që kanë për qëllim shkaktimin e shkatërrimit total ose të pjesshëm fizik;*
- *masat për të parandaluar lindjet brenda grupit;*
- *transferimin e detyruar të fëmijëve nga një grup në një grup tjetër”.*

Artikulli i dytë nënvizon se si Konventa përbën një lloj kompromisi midis kuptimit të termit gjenocid siç e kishte quajtur Lemkin dhe nevojave të ndryshme të shteteve nënshkruese të angazhuara për miratimin e saj. Artikulli përcakton format gjenocidale të pranuar dhe të njohura në përgjithësi nga vetë Konventa, përkatësisht gjenocidi fizik dhe biologjik, si dhe kundërshton gjenocidin kulturor dhe politik të kundërshtuar fort nga Bashkimi Sovjetik. Para se të rendisin të gjitha veprat e gjenocidit që nënshkruesit e Konventës janë të angazhuar për të parandaluar dhe shtypur, ligjvënësi ndërkombëtar ngre çështjen e definimit të krimit në mënyrë më specifike duke e identifikuar atë nëpërmjet tre llojeve të elementeve konstitutive: të ashtuquajturit “material”, atë “moral” dhe atë “fizik”.⁹¹

⁹⁰ Ibid.

⁹¹ Gaeta, P., *The UN Genocide Convention: A Commentary*, Botim: Oxford University Press, 2009, f. 102.

Elementi material i veprës penale të gjenocidit (*actus reus*), përbëhet nga figura të veprës penale që dispozita në fjalë i kategorizon në pesë kategori në mënyrë që të bëjë të qartë natyrën e mbyllur dhe kufizuese të listës së propozuar (pra dispozitë shteruese). Prandaj, vetëm veprat e mëposhtme mund të merren parasysh për të përcaktuar nëse ka pasur gjenocid: *së pari, vrasja e anëtarëve të grupit*, është figura më e qartë e gjenocidit fizik, pasi që për “vrasjen” është e domosdoshme të kuptohen masat dhe masakrat masive dhe kolektive apo ekzekutimet individuale, pasi që edhe vrasja e një anëtari të vetëm të grupit duhet të konsiderohet gjenocid nëse shoqërohet me qëllimin për të kryer veprime që synojnë shkatërrimin e grupit. Kjo gjithashtu u riafirmua kohët e fundit nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në Opinionin e vitit 1996 mbi Ligjshmërinë e Kërcënimit ose Përdorimit të Armëve Bërthamore, kur vërtetoi se edhe pse përdorimi i armëve bërthamore mund të shkaktojë vdekjen e shumë njerëzve, madje edhe i përkasin të njëjtit grup, kjo nuk mund të kuptohet *a priori* si një akt gjenocidi; në fakt, është e nevojshme që së pari të verifikohet prania e specialitetit *dolus*, i cili karakterizon krimin e vetë gjenocidit.⁹² *Së dyti, sulmi ndaj integritetit fizik ose mendor të grupit*, në këtë mënyrë është e nevojshme t’i referohemi akteve të tilla si tortura dhe trajtimi çnjerëzor dhe degradues, përdhunimi, skllavëria dhe uria, ndalimi në kampet e përqendrimit ose geto, dëbimi dhe persekutimi i anëtarëve të grupit. Me fjalë të tjera, kjo kategori e veprave penale duket të përfshijë në vetvete të gjitha ato shkelje serioze të të drejtave themelore të personit që jo domosdoshmërisht shkaktajnë vdekjen e viktimës, si prostitucioni i detyruar, gjymtimet dhe eksperimentet biologjike të kryera mbi njerëzit. Duke iu referuar në veçanti të ashtuquajturave “sulme ndaj integritetit mendor”, duhet të theksohet se kjo mund të arrihet edhe përmes përdorimit të produkteve kimike. *Së treti, masat që synojnë parandalimin e lindjeve brenda grupit*, konsistojnë kryesisht në atë që përbën gjenocidin biologjik. Tashmë Lemkin kishte theksuar mundësinë e gjenocidit jo vetëm që e pengonte grupin të mbijetonte, por gjithashtu e pengonte atë të ripërtërihej në mënyrë gjenerale. Mendoj se përfshihen në këtë kategori të gjitha ato akte që synojnë vrasjen e grupit në afat të gjatë: praktikat e sterilizimit dhe abortit të detyrueshëm dhe çdo masë që synon kufizimin e lindjeve; ndarja e gjinive dhe pengesat për martesë të vendosura, për shembull, nëpërmjet detyrimit për burrat dhe gratë, për të punuar dhe jetuar në mjedise të ndryshme dhe larg njëri-tjetrit. *Në kategorinë e katërt* përfshihen *transferimi i detyruar i fëmijëve nga një grup në një grup tjetër*, kjo është tipologjia e vetme e figurës së veprës penale të gjenocidit e cila shikohet si e përfshirë në gjenocidin kulturor. Kjo tipologji, megjithatë, u mor nga teksti përfundimtar i Konventës si një formë e gjenocidit biologjik vetëm për shkak se e kërkonte në mënyrë eksplicite Greqia, e cila pretendonte mundësinë e shkatërrimit të një grupi edhe duke zhvendosur me forcë fëmijët e tij në një grup tjetër, për t’i asimiluar ato në grupin e ri dhe për t’i bërë ata të humbasin identifikimin e tyre me grupin origjinal të cilit i përkasin.⁹³ Në fakt, mendoj se ajo që arrihet me largimin me forcë të fëmijëve nga një grup në

⁹² Opinion Këshillues, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, “Mbi ligjshmërinë e krijimit ose përdorimit të armëve nukleare”, 8 Korrik 1996, Parag.26, f. 240. Shih: <http://www.icj-cij.org/files/case-related/95/095-19960708-ADV-01-00-EN.pdf> (aksesuar online: 03/12/2017).

⁹³ Gaeta, P., *The UN Genocide Convention: A Commentary*, Botim: Oxford University Press, 2009, f. 144.

tjetrin është ndarja e tyre nga prindërit e tyre për të imponuar një kulturë dhe një mënyrë të menduarit të ndryshëm nga ato që janë origjina e tyre.

Elementi moral i krimit të gjenocidit (*mens rea*) konsiston në intencionalitetin e shkatërrimit të grupit, domethënë, mund të flitet për gjenocid vetëm në rastet kur vepra penale, që është elementi material i krimit, është kryer “me qëllim të shkatërrimit, tërësisht ose pjesërisht, të një grupi [...] si i tillë”. Prandaj qëllimi është elementi që e karakterizon gjenocidin më shumë se çdo element tjetër. Rrjedhimisht, duhet të flitet për gjenocid sa herë që kryhet një vepër penale me qëllim që individi të zhduket thjesht sepse i përket një grupi të caktuar. Por ne nuk duhet ta ngatërrojmë këtë intencionalitet me motivet që nxisin veprimet dhe megjithëse kjo mund të na bëjë të besojmë se për shkak të vështirësive në provimin e fakteve, shumë të pandehur mbeten të pandëshkuar, por kjo nuk është gjithmonë e vërtetë; pasi ai që akuzohet për një krim të tillë, edhe nëse ai nuk mund të dënohet për gjenocid, megjithatë mund të dënohet për kryerjen e krimeve kundër njerëzimit. Sidoqoftë, ky intencionalizëm nuk përcaktohet në mënyrë objektive nga Konventa dhe për ta vërtetuar gjyqtarëve u jepet një fuqi e madhe diskrecionale për të cilën ata duhet ta vlerësojnë atë rast pas rasti, si dhe për ta vendosur atë, gjyqtari duhet të marrë parasysh një sërë elementësh që e lejojnë atë të vlerësojë se deri në ç’masë veprimet e kryera nga i akuzuari ka të ngjarë të gjenerojnë dëmin e dëshiruar, përkatësisht shkatërrimin e grupit. Konventa në vetvete specifikon që për të akuzuar një individ për gjenocid nuk është e nevojshme që autori i veprës penale të kishte qëllimin ta shkatërronte tërësisht grupin, pasi është në fakt e mjaftueshme që ky intencionalitet të ketë përfshirë gjithashtu një pjesë minimale të grupit; Konventa nuk përcakton kufizime sasiore: mund të jetë një vrasje e vetme ose një sulm i vetëm mbi integritetin e një anëtari të një grupi mund të jetë i mjaftueshëm për t’u akuzuar për gjenocid, me kusht që përmbushja e tyre të shoqërohet nga kjo dashamirësi specifike gjenocidale. Shkatërrimi total i një grupi në fakt mund të arrihet edhe nëpërmjet eliminimit të pjesshëm të anëtarëve të tij, veçanërisht atyre që sigurojnë vazhdimin e themeleve esenciale.

Grupi njerëzor është **elementi fizik** i krimit të gjenocidit, pra është destinacioni i tij specifik. Konventa e kualifikon grupin njerëzor nëpërmjet mbiemrave “kombëtare, etnike, racore apo fetare”, kështu që vetëm këto grupe janë të mbrojtura. Me fjalë të tjera, një grup kombëtar mund të ketë një vlerë aq të madhe saqë konsiderohet si një grup individësh të dalluar nga pjesa tjetër e popullsisë nga ngjashmëritë e tyre gjuhësore, etnike, raciale, fetare dhe kulturore dhe jo nga nacionaliteti ose shtetësia e tyre në kuptim të rreptë. Edhe pse mbiemrat që e kualifikojnë grupin e mbrojtur nuk mund të përcaktohen qartë, saktësisht dhe në mënyrë të përpiktë, përveç ndoshta grupit fetar, i cili i referohet pikërisht idesë së bashkësisë së individëve të bashkuar nga një ideal i njëjtë shpirtëror, megjithatë, është e padiskutueshme që redaktorët e Konventës dëshirojnë të përjashtojnë nga përfitimi i mbrojtjes të ashtuquajturat grupe politike, ideologjike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Më konkretisht, sa i përket grupeve politike, duhet të thuhet se përjashtimi i tyre nga kjo listë është diktuar nga opozita e shprehur në këtë drejtim nga

përfaqësuesi i Bashkimit Sovjetik dhe, rrjedhimisht, nga nevoja për ta bërë vetë Konventën sa më të pranueshme që të jetë e mundur. dhe të ratifikueshme nga vendet e orbitës sovjetike.⁹⁴

Neni 3 i Konventës ka parashikuar se: *“Do të dënohen aktet e mëposhtme: a) Gjenocid; b) Marrëveshja për kryerjen e gjenocidit; c) Nxitja publike dhe e drejtpërdrejtë për gjenocid; d) Përpjekja për gjenocid; e) Pjesëmarrje në gjenocid”*.

Me këtë dispozitë, projektuesit e Konventës synonin të zgjeronin aktakuzën ndaj nxitjeve, projekteve dhe bashkëpunimit në akte gjenocidiale. Edhe pse mund të konsiderohet e panevojshme të bëhet dallimi ndërmjet gjenocidit të konsumuar dhe gjenocidit të tentuar (paragrafët a dhe d) duke pasur parasysh se formulimi i nenit 2 “shkatërrimi i tërësishëm apo i pjesshëm” përfshin të dy aktet, është diferencimi i duhur i bërë në paragrafët e tjerë, me këtë në fakt ligjvënësi ka shprehur vullnetin e tij për të ndëshkuar çdo shpërndarje të ideve bazuar në urrejtjen racore ose superioritetin, çdo nxitje për diskriminim racial, fetar ose social, çdo ftesë për të përmbysur në disa grupe përgjegjësinë e vështirësive të hasura nga kombet në mënyrë që të krijojë atmosferën e përshtatshme për ekzekutimin e krimit. Neni 3 i Konventës mund të përkufizohet si dispozita e parandalimit, duke pasur parasysh se qëllimi parësor i represionit të akteve të renditura atje është pikërisht ajo e parandalimit. Marrëveshja për të kryer gjenocid vjen nga koncepti anglo-sakson i konspiracionit, i cili nënkupton një marrëveshje midis dy ose më shumë njerëzve me qëllim të kryerjes së një veprimi të paligjshëm. Në këtë kontekst, me “marrëveshje” është e nevojshme të kuptohet një akt vullnetesh kolektive për të kryer një krim, si rrjedhojë çdo “konspirator” është kaq fajtor dhe përgjegjës për veprat kriminale të të tjerëve, edhe nëse nuk ka pasur dijeni apo nuk është dëshiruar nga ai.⁹⁵ Nga ana e Konventës, nxitja për gjenocid konsiderohet e dënueshme vetëm dhe ekskluzivisht nëse është e “drejtpërdrejtë” dhe “publike”, pra natyra e drejtpërdrejtë e nxitjes kërkon që ajo të marrë një formë të veçantë dhe të drejtpërdrejtë, e cila pastaj në mënyrë eksplicite provokon të tjerët që të ndërmarrin veprime penale, ndërkohë karakteri publik ka të bëjë me vendin ku nxitet dhe numrin e cilësinë e njerëzve ndaj të cilëve drejtohet.⁹⁶ Së fundmi, Konventa ndëshkon pjesëmarrjen në gjenocid që është ndihma që i jepet autorit të krimit. Pjesëmarrja apo komplikimi në një akt gjenocidial është një akt pozitiv i bashkëpunimit që pason marrëveshja vullnetare e lidhur, pasi që veprimet e bashkëpunëtorit janë të nevojshme për suksesin e krimit, edhe pse roli i tyre duhet të jetë i natyrës dytësore, përndryshe duhet të flasim për bashkë-ekzekutor. Duhet theksuar se pjesëmarrja ka të bëjë vetëm me aktin material krimit dhe jo me shkallët e ndryshme (fazat) e ekzekutimit të aktit, sepse Konventa nuk e ka pranuar propozimin për të ndëshkuar edhe pjesëmarrjen në marrëveshje, nën nxitjen dhe në përpjekje për kryerjen e gjenocidit.

Neni 4 ka theksuar se: *“Personat që kanë kryer gjenocid ose ndonjë prej veprimeve të renditura në nenin 3 do të dënohen, qofshin sundimtarë, nëpunës civilë ose qytetarë privatë”*.

⁹⁴ Gaeta, P., *The UN Genocide Convention: A Commentary*, Botim: Oxford University Press, 2009, f. 144.

⁹⁵ Ibid.

⁹⁶ Ibid.

Neni 4 është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe është në qendër të një diskutimi të gjallë në doktrinë. Prandaj, duket se Konventa ka të bëjë vetëm me njohjen dhe ndëshkimin e përgjegjësisë penale individuale, ku secili individ mund të dënohet pavarësisht nga pozita e tij në hierarkinë shtetërore ose duke vepruar në emër të shtetit. Gjithashtu duket se Konventa refuzon zbatimin e doktrinës së aktit shtetëror, në mënyrë që përgjegjësia e akteve të kryera nga organet shtetërore të jetë e dënueshme vetëm për shtetin si e tillë. Vetëm individi është përgjegjës, nëse ai është një udhëheqës ose një ministër (me përjashtim, të atyre që gëzojnë një privilegj mbretëror që i përjashton ata nga të gjitha përgjegjësitë dhe ata që, me kushtetutë, nuk janë përgjegjës për veprimet e tyre para gjykatave të tyre)⁹⁷. Në çështjen Bosnje-Hercegovina kundër Jugosllavisë, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka theksuar ndër të tjera se: *“Konventa do të përcaktojë dy lloje të përgjegjësisë: individuale dhe shtetërore. Çdo person i cili kryen një nga veprimet e renditura në nenin 3 të Konventës duhet të marrë të gjitha përgjegjësitë penale individuale në nivel ndërkombëtar dhe mund të ndiqet penalisht pavarësisht nga pozita e tij hierarkike, megjithatë, njohja e përgjegjësisë penale individuale të menaxherëve shtetërorë nuk përjashton përgjegjësinë ndërkombëtare të vetë Shtetit dhe kjo përsëritet edhe në nenin 9 të Konventës”*⁹⁸.

Neni 5 ka theksuar se: *“Palët Kontraktuese zotohen të marrin, në përputhje me Kushtetutat e tyre përkatëse, masat legislative të nevojshme për të siguruar zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente, dhe në veçanti për të parashikuar sanksione efektive penale për të goditur personat fajtorë për gjenocid ose ndonjë prej veprimeve të listuara në nenin 3”*.

Neni 5 kërkon që palët kontraktuese të sigurojnë pikëpamje legislative në mënyrë që të gjitha veprimet që mund të ndiqen në emër të Konventës të dënohen me efektivitet. Me fjalë të tjera, në qoftë se ishte në përputhje me Konventën për të përcaktuar saktësisht se cilat ishin krimet që shtetet ishin zotuar për të parandaluar dhe ndëshkuar, në shtetet individuale, në përputhje me kushtetutat e tyre, duhet të zbatojnë Konventën dhe të përcaktojnë se cilat dënime aplikohen. Sigurisht përcaktimi i sanksioneve është jashtëzakonisht i rëndësishëm, pasi nga njëra anë është një efikasitet i ndëshkimit dhe nga ana tjetër është një mjet për pengimin dhe parandalimin e konsiderueshëm me qëllim krijimin e një sistemi efektiv represiv për të siguruar mbrojtjen e interesave që përbëjnë vlera të përbashkëta nga bashkësia ndërkombëtare në tërësi. Megjithatë, Konventa nuk ndërhyr në detajet e ndërtimit të një sistemi efikas dënimesh, pasi qëllimi i saj nuk është të vendosë një legjislacion uniform në të gjitha shtetet, por të sigurojë zbatimin e ligjit të miratuar që lejon aplikimin dhe përcaktimin e dënimeve të vlefshme.

Në **nenin 6** të Konventës është parashikuar se: *“Personat e akuzuar për gjenocid ose ndonjë prej veprimeve të renditura në nenin 3, do të paraqiten në gjykatat kompetente të*

⁹⁷ Ibid., f. 146.

⁹⁸ Çështja Bosnje-Hercegovina kundër Jugosllavisë, vendim i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, datë 11/07/1996, parag.32, f. 616. Shih: <http://www.icj-cij.org/en/case/91/judgments> (aksesuar online: 03/12/2017).

Shtetit në territorin e të cilit është kryer vepra, ose para gjykatës penale ndërkombëtare kompetente në lidhje me palët kontraktuese që kanë njohur juridiksionin e saj”.

Sipas kësaj dispozite dënimi i palëve fajtoare duhet t’u referohet gjykatave kombëtare të Shteteve Kontraktuese ose një Gjykate Ndërkombëtare Penale, në të cilën vetë shtetet do të jenë të detyruara që t’i referojnë të akuzuarit vetëm pasi të kenë njohur juridiksionin e kësaj instance. Duke vendosur mbi një juridiksion kompetent për të gjykuar kriminelët e dyshuar, ligjvënësi e gjeti veten duke diskutuar mbi këshillueshmërinë e miratimit të ‘parimit të represionit universal’ në mënyrë që të ndëshkonte palët fajtoare kudo që ata kryen krimin e tyre, kjo megjithatë ka ndeshur me të ashtuquajturin ‘parim territorialiteti’, ku sovraniteti kombëtar i shteteve i detyron ata të dënojnë të akuzuarin vetëm nëse krimi është kryer në territoret e tyre përkatëse. Në pavendosmëri, Konventa ka zgjedhur të zbatojë parimin e territorialitetit, duke lejuar alternativisht mundësinë e përdorimit të parimit të represionit universal në rast se do të plotësohet kushti i pranimit të kompetencës së Gjykatës Ndërkombëtare Penale. E drejta e një shteti për të gjykuar ata të akuzuar për kryerjen e çfarëdo akti të gjenocidit në territorin e tij ka marrë kështu një detyrim edhe më të fortë për ta bërë atë të varur nga anëtarësimi në Konventë. Sidoqoftë, është e qartë se parimi i territorialitetit të ligjit është më i paefektshëm në çështjen e gjenocidit: kush do të gjykojë ata fajtorë që kanë marrë strehim jashtë shtetit (procedura azili) ose që janë kthyer në atdhe pas kryerjes së një krimi të gjenocidit në një territor tjetër shtetëror? Pavarësisht se Konventa nuk jep një përgjigje konkrete për këtë pyetje, efektiviteti i parimit të njohur nga Konventa i nënshtrohet kushtit që shteti në të cilin i pandehuri është marrë përsipër është i detyruar t’i hapë rrugë ekstradimit. Ishte pikërisht nevoja për të siguruar ndëshkimin efektiv, e aftë për të mbushur çdo hendek të mundshëm, për të nxitur ligjvënësin e çdo shteti që ta mbështesë këtë parim me përgjegjësi universale, në mënyrë që të lejojë drejtësinë edhe në rastet kur shtetet në fjalë nuk sigurojnë një gjykim për fajtorët. Sot është më se e qartë të kthehemi në retrospektivë e të kuptojmë se në vitin 1948 shteteve nuk u pëlqente shumë për të dëgjuar kufizime për sovranitetin e tyre kombëtar, prandaj hipoteza e zgjidhjes universale represive u vendos në alternativë ndaj tjetrës dhe për një kohë të gjatë mbizotëronte ‘parimi i territorialitetit’. Në çështjen Bosnje-Hercegovina kundër Jugosllavisë, në vitin 1996, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë sqaroi dhe përsëriti atë që ishte shprehur tashmë në një vendim të vitit 1951, “që të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara nga Konventa e vitit 1948 janë të drejta dhe detyrime që çdo shtet ka detyrimin për të parandaluar dhe shtypur pa marrë parasysh ndonjë kufizim territorial, pasi të gjitha shtetet kanë të drejtë të kërkojnë pajtueshmërinë me këtë legjislacion”⁹⁹.

Neni 7 i Konventës ka parashikuar se: “Gjenocidi dhe krimet e tjera të renditura në nenin 3 nuk do të konsiderohen si krime politike në lidhje me ekstradimin. Palët Kontraktuese marrin përsipër që në një rast të tillë të japin ekstradimin në përputhje me legjislacionin e tyre dhe traktatet në fuqi”.

⁹⁹ Ibid., parag. 31.

Të ndërgjegjshëm për problematikat e mëdha që vinin si rrjedhojë e mungesës së bashkëpunimit ndërmjet shteteve, dhe mbi të gjitha nisur nga fakti se krijimi i një juridiksioni ndërkombëtar do të kërkonte një periudhë të gjatë diskutimi dhe rregullimesh, palët kontraktuese me qëllim që të parandalonin shtypjen territoriale edhe nga problemet që lidhen kryesisht me disiplinën e ekstradimit, synonin të ruanin në këtë dispozitë nevojën për të mos konsideruar aktet e gjenocidit si krime politike, të paktën sa i përket ekstradimit. Rrjedhimisht, shteti i strehimit i të akuzuarit është i detyruar t'i hapë rrugën ekstradimit, përveç nëse parashikohe ndryshe në legjislacionin e tij të brendshëm ose në traktatet në fuqi me shtetin kërkues (marrëveshjet dypalëshe). Sidoqoftë, duhet të theksohet se edhe kur i akuzuari procedohet për gjenocid, nuk mund të thuhet se është vënë drejtësia në vend, në fakt është e vështirë që gjenocidi të kryhet pa bashkëpunimin ose mospërfilljen e autoriteteve të larta shtetërore dhe në situata të tilla është e vështirë të vazhdohet me drejtësi deri në momentin e caktimit të dënimit dhe shtypjen e krimit. Nëse qeveria që ka urdhëruar gjenocidin është në pushtet në kohën e gjykimit, është e ligjshme të dyshohet në vullnetin e saj efektiv për të iniciuar veprime gjyqësore, madje edhe të pabarabarta, kundër vetvetes. Prandaj është e qartë se e vetmja mënyrë për të garantuar represionin efikas dhe efektiv dhe rrjedhimisht parandalimin e krimit të gjenocidit, rezulton të jetë institucioni i një Gjykate Ndërkombëtare Penale, megjithëse Shtetet mund t'i shpëtojnë asaj duke mos njohur juridiksionin e saj.

Në **nenin 8** të Konventës është parashikuar se: *Secila Palë kontraktuese mund të udhëzojë organet kompetente të Organizatës së Kombeve të Bashkuara që të ndërmarrin masa të tilla, në konformitet me Kartën e Kombeve të Bashkuara, që ato i konsiderojnë të përshtatshme për parandalimin dhe ndjekjen penale të akteve të gjenocidit ose të ndonjë prej akteve të tjera të listuara në nenin 3*".

Të gjitha shtetet e favorizuara nga një politikë aq represive nuk mund të kënaqeshin me atë që është e rregulluar vetëm në nenet 6 dhe 7, kështu që kërkuan garanci më të mëdha për zbatimin e Konventës. Prandaj u implementua kjo dispozitë që legjitimon çdo palë kontraktuese që t'i udhëzojë organet kompetente të Kombeve të Bashkuara që, në përputhje me vetë Kartën e Kombeve të Bashkuara, të marrin masat më të përshtatshme për parandalimin dhe shtypjen e akteve të gjenocidit. Kombet e Bashkuara njihen si njësi e vetme ndërkombëtare kompetente për zbatimin e Konventës në mungesë të një organi të posaçëm. Nga analiza e dispozitave të Kartës së Kombeve të Bashkuara, OKB-ja konsideron kompetente në këtë çështje jo vetëm Asamblenë e Përgjithshme dhe Këshillin e Sigurimit, por edhe Këshillin Ekonomik dhe Social, i cili sipas nenit 62 të Kartës: *"mund të bëjë rekomandime për të nxitur respektimin dhe garantimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë"*¹⁰⁰. Sa i përket "masave" që mund të marrin këto organe, duhet të thuhet se, përveç rekomandimeve të thjeshta, Këshilli i Sigurimit gjithashtu mund të marrë vendime, veçanërisht nëse vlerësohen reale hipotezat e parashikuara nga neni 39 i Kartës, ose për të ruajtur ose rivendosur paqen dhe sigurinë

¹⁰⁰ Karta e Kombeve të Bashkuara, përditësuar në 2017. Shih: <http://www.un.org> (aksesuar online: 04/12/2017).

ndërkombëtare. Gjenocidi në fakt mund të konsiderohet një krim i aftë për të shqetësuar paqen dhe sigurinë ndërkombëtare edhe nëse nuk degjeneron në konflikte të armatosura.

Neni 9 i Konventës ka theksuar se: *“Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese në lidhje me interpretimin, aplikimin ose zbatimin e kësaj Konvente, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e një Shteti lidhur me gjenocidin ose ndonjë nga aktet e tjera të renditura në nenin 3, do të paraqitet me kërkesë të një prej Palëve në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë”*.

Edhe kjo dispozitë, si neni i mëparshëm reflekton një garanci ndërkombëtare të Konventës, pasi ngre çështjen e thirrjes në çështjet penale të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, një gjykatë kompetente për të përcaktuar përgjegjësinë civile të shteteve që nuk janë korrekt ndaj zotimeve të saj ndërkombëtare dhe për të vendosur natyrën dhe shtrirjen e dëmshpërblimeve, duke gjykuar vetëm për mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin, aplikimin dhe zbatimin e Konventës dhe mund të zgjidhë mosmarrëveshjet mbi përgjegjësinë e një shteti lidhur me gjenocidin. Kjo rikonfirmon besimin e ligjvënësit se eliminimi i një grupi kërkon në secilën fazë të zbatimit, mbështetjen e klasës sunduese politike dhe pjesëmarrjen e organeve shtetërore, edhe pse në mënyrë të heshtur. Mekanizmat e gjenocidit, specifikat e krimit në lidhje me përgatitjen dhe planifikimin e shkatërrimit të grupit të synuar, theksojnë përdorimin e strukturave shtetërore në kryerjen e një politike të tillë kriminale. Megjithatë, kur është fjala për përgjegjësinë e shtetit, është e padobishme të pyesim nëse është natyrë civile ose penale, pasi ajo është gjithmonë një përgjegjësi ndërkombëtare. Neni 9 nuk përjashton tërësisht një përgjegjësi penale të shtetit dhe kjo është për shkak të faktit që gjatë punës përgatitore të Konventës parimi i përgjegjësisë së shtetit për gjenocid ishte në qendër të një diskutimi të gjatë në të cilin Britania e Madhe dhe Belgjika e mbështeti nevojën për ta bërë atë të qartë, pasi shteti gjithashtu mund të jetë një promotor i gjenocidit.¹⁰¹

Neni 10 deri në nenin 19, merren në thelb me gjuhët zyrtare të Konventës, me ratifikime, me aderime, me ankesa, me rezerva dhe me shfuqizim. Në konkludim është me rëndësi të theksohet se ka hyrë në fuqi më 12 Janar 1952, domethënë 90 ditë pas depozitimit, pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Kështu siç është parashikuar në nenin 14, Konventa ka një vlerë të caktuar kohore, në fakt është përcaktuar për një periudhë dhjetëvjeçare duke filluar nga dita e hyrjes së saj në fuqi; megjithatë konsiderohet automatikisht i rinovuar çdo pesë vjet kundrejt palëve që nuk kanë denoncuar të paktën gjashtë muaj përpara datës së skadimit. Neni 15 parashikon se për shkak të denoncimeve të shumta, numri i palëve kontraktuese reduktohet në më pak se gjashtëmbëdhjetë Shtete, atëherë Konventa duhet të konsiderohet automatikisht e shuar, pra pa ndonjë efekt. Asnjë nen i Konventës nuk e rregullon problemin e rezervave, prandaj në vitin 1951, Asambleja e Përgjithshme kërkoi nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë që të nxjerrë një mendim këshillëdhënës mbi çështjen: më 28 maj 1951, Gjykata njoftoi se i konsideronte të papranueshme të gjithë ato rezerva të papajtueshme me objektin dhe qëllimin e Konventës dhe shtetet që kishin bërë deklarata të ngjashme nuk mund të bëheshin pjesë e

¹⁰¹ Gaeta, P., *The UN Genocide Convention: A Commentary*, Botim: Oxford University Press, 2009, f. 146.

Konventës.¹⁰² Përkundrazi, mund të konsiderohej pjesë e Konventës që shteti kishte rezerva të lidhura me objektin dhe qëllimin e saj. Mendimi i Gjykatës ishte rrjedhimisht rezultat i një kompromisi midis nevojës për të respektuar integritetin e tekstit të miratuar dhe për të lejuar pjesëmarrjen më të gjerë të mundshme. Pas lëshimit të këtij mendimi, komisioni i gjashtë i Asamblesë së Përgjithshme përgatiti një projekt-rezolutë, të miratuar më 12 janar 1952, në të cilën udhëzimet iu dhanë Sekretarit të Përgjithshëm, në mënyrë që ai, si depozitar i tekstit të Konventës, të zbatonte sugjerimet të përfshira në mendimin e shprehur nga Gjykata dhe më pas të vlerësonte papajtueshmërinë e rezervave të ndryshme me objektin dhe qëllimin e vetë Konventës. Më vonë, me rezolutën 2391 (XXIII) të datës 26 nëntor 1968, Asambleja e Përgjithshme miratoi Konventën mbi Paparashkrueshmërinë e Krimeve të Luftës dhe Krimeve kundër Njerëzimit, e cila sipas asaj që është përcaktuar në nenin 1 të saj, përcakton krimin e gjenocidit si të paparashkrueshëm.¹⁰³

2.3.2. Parashikimi i Statutit të Tribunalit të Hagës. Praktika gjyqësore e këtij Tribunali

Statuti i përditësuar i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë është amenduar së fundmi në Shtator 2009. Ky Statut u redaktua nga Këshilli i Sigurisë, duke vepruar sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe duke themeluar në këtë formë dhe Tribunalin Ndërkombëtar për ndjekjen e personave përgjegjës për shkelje të rënda të ligjit ndërkombëtar humanitar të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që nga viti 1991. Vlen të theksohet se sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë, duke vepruar sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, pas nxjerrjes së disa rezolutave për thirrjen e të gjithë palëve që të zbatojnë rregullat e së drejtës humanitare, ai vendosi që shkeljet e përgjithshme të këtyre rregullave, dhe në veçanti praktika e tmerrshme ‘spastrimit etnik’ përbënte një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare në përputhje me nenin 39 të Kartës. Gjenocidi është normuar në nenin 4 të këtij Statuti, sipas të cilit është parashikuar se: *“1. Gjykata Ndërkombëtare do të ketë kompetencën për të ndjekur penalisht personat që kryejnë gjenocid siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni ose për të kryer ndonjë nga aktet e tjera të renditura në paragrafin 3 të këtij neni”*.¹⁰⁴ Pika e parë i kësaj dispozite njeh pikërisht kompetencën e Tribunalit Ndërkombëtar të Hagës për të ndjekur penalisht personat që kryejnë gjenocid. Në pikën e dytë të kësaj dispozite hartuesit e Statutit janë munduar të adoptojnë në mënyrë literale përkufizimin e pranishëm në nenin 2 dhe 3 të Konventës së 9 Dhjetorit 1948. Sipas kësaj pike është specifikuar se:

¹⁰² Mendim këshillënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, “Mbi rezervat e Konventës për parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit”, 28 Maj 1951. Shih: <http://docenti.unimc.it> (aksesuar online: 04/12/2017).

¹⁰³ Konventa mbi Paparashkrueshmërinë e Krimeve të Luftës dhe Krimeve kundër Njerëzimit, adoptuar nëpërmjet Rezolutës 2391 (XXIII) të datës 26 Nëntor 1968 dhe ka hyrë në fuqi më 11 Nëntor 1970. Shih: <http://www.un.org> (aksesuar online: 04/12/2017).

¹⁰⁴ Statuti i përditësuar i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë miratuar më 25 Maj 1993 me Rezolutën 827 të Këshillit të Sigurimit, është amenduar së fundmi në Shtator 2009, f. 5-6. Shih: <http://www.icty.org> (aksesuar online: 05/12/2017).

“Gjenocidi nënkupton një nga veprimet e mëposhtme të kryera me synimin për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar, si të tillë:

- a) vrasjen e anëtarëve të grupit;*
- b) duke shkaktuar dëm të rëndë trupor ose mendor për anëtarët e grupit;*
- c) vendosja e grupit në kushte të tilla që shkaktojnë shkatërrimin e tij fizik të plotë ose të pjesshëm;*
- d) marrjen e masave për parandalimin e lindjeve brenda grupit;*
- e) transferimin me forcë e fëmijëve të grupit në një grup tjetër”.*

Elementët e sjelljes që përbëjnë gjenocid siç vërehet formojnë një dispozitë shteruese dhe tepër të qartë. Ky krim, sipas mendimit tim, përfshihet në kategorinë e përgjithshme të krimeve kundër njerëzimit, por dallon nga **qëllimi specifik**, domethënë qëllimi i veçantë i shkatërrimit tërësisht ose pjesërisht të një grupi kombëtar, etnik, racial ose fetar. Problematika kryesore që lidhet me elementin e “grupit” si viktimë e krimit të gjenocidit dhe veçanërisht katër llojet e grupeve të përcaktuara në Konventë (1948) dhe në Statutin e Tribunalit, gjeti zgjidhje nga jurisprudenca e Gjykatës Ndërkombëtare të Ruadës (*ad hoc*). Në çështjen **Akayesu**, Gjykata jep një përcaktim të sajën në lidhje me termin “grup” dhe konsideron si të tillë vetëm grupet stabël dhe të përhershme, pra të ngritur mbi bazën e një anëtarësie që përcaktohet që në lindje. Gjykata gjithashtu merr në analizë të detajuar të katër grupet duke dhënë një përkufizim për secilin: me **grup kombëtar**, do të kuptohet “një kolektiv njerëzish të cilët ndajnë të njëjtën lidhje ligjore të qytetarisë e përbëra nga një tërësi të drejtash dhe detyrimesh reciproke”; me **grup etnik**, do të kuptohet “një grup, anëtarët e të cilit ndajnë të njëjtën gjuhë dhe kulturë”; ndërsa në lidhje me **grupin racial**, do të kuptohet “grupi i bazuar në një trashëgimi fizike, shpesh e lidhur me një rajon gjeografik i pavarur nga faktorët kulturorë, gjuhësorë, kombëtar apo fetar”, si dhe **grupin fetar**, “një grup, anëtarët e të cilit ndajnë të njëjtën fe, besim ose mënyrë falje”.¹⁰⁵ Që nga ky dhënia e këtij vendimi tepër interesant, gjykatat ndërkombëtare *ad hoc* nuk e shqyrtuan më elementin themelor të “grupit”, por morën të mirëqënë analizën tepër pozitive të reflektuar në këtë rast nga Gjykata Ndërkombëtare e Ruandës.

Por qëllimi specifik nuk përjashton përgjegjësinë për gjenocid të atyre që kanë vepruar mbi bazën e urdhërave më të lartë. Në pikën 3 të kësaj dispozite është theksuar shprehimisht se:

“ Aktet në vijim duhet të ndëshkohen:

- a) gjenocidi;*
- b) komploti për të kryer gjenocid;*
- c) nxitje direkte dhe publike për të kryer gjenocid;*
- d) përpjekja për të kryer gjenocid;*
- e) pjesëmarrje në gjenocid”.*

¹⁰⁵ Vendimi i Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën, 2 shtator 1998, nr. ICTR 96-4-T. Shih: <http://unictr.unmict.org> (aksesuar online: 05/12/2017).

Kryetari i Bashkisë së Tabës, Jean Paul Akayesu u dënua për gjenocid në lidhje me ngjarjet e ndodhura në Ruandë ku u vranë 2000 anëtarë të grupit Tutsi.

Lista e akteve të dënuara nga bashkësia ndërkombëtare dhe represioni i të cilave bie në kompetencë të Tribunalit të Hagës përfshin gjithashtu praktikën e përcaktuara të spastrimit etnik që mund të ndiqen në kategorinë e krimeve kundër njerëzimit dhe ato të krimeve të luftës dhe krimin e gjenocidit: në fakt, siç raportohet nga Bassiouni, “*spastrimi etnik i kryer në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kroaci nuk ishte produkt i shpërthimeve spontane dhe episodike të dhunës nga individët, por rezultat i një plani të mirëmenduar qëllimisht dhe paraprakisht për të eliminuar një herë e përgjithmonë një grup njerëzish të caktuar*”¹⁰⁶. Gjithashtu përsa i përket kompetencës *ratione personae* të Tribunalit të Hagës, duhet të theksohet se nga analiza e nenit 7 të Statutit¹⁰⁷, ekzistojnë tre nivele të të përgjegjësisë për të cilat një person mund të akuzohet për kryerjen e një krimi (përfshirë edhe gjenocidin):

- a) udhëheqësit politikë, dmth. krerët e shtetit, sundimtarët dhe zyrtarët e lartë që kanë shkelur të drejtat e njeriut dhe ligjet e luftës me qëllimin e vetëm për arritjen e qëllimeve të caktuara politike. Ata mund të akuzohen se kanë planifikuar, ndihmuar ose inkurajuar të planifikojnë ose madje të nxisin për të kryer krime që i përkasin vetë gjykatës. Për këtë arsye udhëheqësit politikë janë autorë moralë, nxitës dhe madje edhe organizatorë të krimeve;
- b) eprorët hierarkikë, dmth. eprorët ushtarakë, si dhe autoritetet civile nëse kanë urdhëruar vartësit e tyre që të kryejnë vepra penale ose kanë pasur dijeni për to dhe nuk kanë arritur të parandalojnë ose t'i dënojnë ata;
- c) ekzekutuesit e thjeshtë, ata që kanë kryer krimin. Meqenëse përgjegjësia penale është individuale, atyre nuk u lejohet të paraqesin si dëshmi të pafajësisë së tyre faktin se nuk kanë pasur mundësinë të ikin nga urdhri i eprorit, duke e zbutur atë, megjithatë mund të merren në konsideratë nga gjyqtarët, rast pas rasti, si një arsye për zvogëlimin e dënimit, përveç nëse autoriteti i eprorit njihet aq i fortë sa të përjashtojë çdo mundësi të zgjedhjes dhe veprimit tek ekzekutuesi ose që ekzekutuesi është detyruar të veprojë nga presioni i pandërprerë fizik, psikik apo moral.

¹⁰⁶ Bassiouni, M.C., Manikas, P., *The law of the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia*, Shtëpi botuese: Transnational Publishers, 1996, f. 611.

¹⁰⁷ Neni 7 i Statutit ka parashikuar se:

“1. Personi i cili ka planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer ose ndihmuar dhe ndihmuar në planifikimin, përgatitjen ose ekzekutimin e një krimi të përmendur në nenet 2 deri 5 të këtij Statuti, do të jetë individualisht përgjegjës për krimin;

2. Pozita zyrtare e çdo personi të akuzuar, qoftë si Kryetar i Shtetit ose Qeverisë ose si një zyrtar i përgjegjshëm i qeverisë, nuk do të lirojë personin e tillë nga përgjegjësia penale dhe as të lehtësojë dënimin;

3. Fakti që ndonjë nga veprat e përmendura në nenet 2 deri 5 të këtij Statuti është kryer nga një vartës nuk e liron eprorin e tij të përgjegjësishëm nga përgjegjësia penale nëse ai e dinte ose kishte arsye të dinte se vartësi ishte gati të kryejë akte të tilla ose kishte kryer dhe eprori nuk arriti të marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar veprime të tilla ose për të ndëshkuar autorët e tyre;

4. Fakti që një person i akuzuar ka vepruar sipas një urdhri të një qeverie ose të një eprori, nuk do ta lirojë atë nga përgjegjësia penale, por mund të konsiderohet në zbutjen e dënimit nëse Gjykata Ndërkombëtare përcakton se drejtësia kërkon këtë”.

Në çështjen **Prokurori kundër Goran Jelisić**¹⁰⁸, Dhoma e Gjykimit e Tribunalit Ndërkombëtar të Hagës vendosi pafajësinë e personit të akuzuar për gjenocid, sepse Dhoma mendonte se provat e paraqitura nga prokurori për të mbështetur akuzën nuk ishin të mjaftueshme për të provuar standardin *dolus specialis*. Në fakt, prokuroria pohon se Dhoma Gjyqësore gaboi me ligj duke kufizuar zbatimin e nenit 4 të Statutit, i cili përcakton masën e kërkuar për gjenocid, duke shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar, vetëm për rastet që plotësojnë standardin *dolus specialis (formë speciale kriminale e shkatërrimit të një grupi)*. Dhoma e Apelit, në gjykimin e apelit të kësaj çështjeje u shpreh se e mirëkuptonte pretendimin e ngritur nga prokurori, duke e lidhur me domosdoshmërinë e paevitueshme të pasjes së elementit *mens rea* nga ana e të akuzuarit për kryerjen e krimit të gjenocidit: (i) ai me vetëdije dëshironte që veprat e kryera të çonin në shkatërrimin, tërësisht ose pjesërisht, të grupit, si të tillë; ose (ii) ai e dinte se veprat e tij po shkatërronin, në tërësi ose pjesërisht, grupin, si të tillë; ose (iii) ai, duke vepruar si ndihmës ose përkrahës, kryen veprime duke e ditur se ekziston një gjenocid i vazhdueshëm në të cilin veprojnë aktet e tij dhe se pasoja e mundshme e sjelljes së tij do të ishte shkatërrimi, tërësisht ose pjesërisht, i grupit si i tillë. Gjithashtu Dhoma e Apelit e vlerësoi me vënd që të ndërhynte për të unifikuar konceptin e *mens rea* (ana subjektive e kryerjes së krimit). Sipas saj, neni 4 i Statutit në vetvete përcakton qëllimin e kërkuar: qëllimin për të arritur disa lloje të specifikuar të shkatërrimit. Është pikërisht ky qëllim specifik që e dallon krimin e gjenocidit nga llojet e tjera të krimeve. Ekzistenca e një plani apo politike nuk është një përbërës ligjor i krimit të gjenocidit. Megjithatë, në kontekst të provimit të qëllimit specifik, ekzistenca e një plani ose politike mund të bëhet një faktor i rëndësishëm në shumicën e rasteve. Provat mund të jenë në përputhje me ekzistencën e një plani ose politike, ose madje mund të tregojnë një ekzistencë të tillë dhe ekzistenca e një plani ose politike mund të lehtësojë vërtetimin e krimit. Në të provuarin e konsumimit të krimit të gjenocidit, duhet t'i referohemi dy elementëve bazë: ***elementin material të veprës (actus reus)***, të përbërë nga një ose disa veprime të renditura në paragrafin 2 të nenit 4; dhe ***mens rea*** e veprës, që përbëhet nga synimi i veçantë për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar, si i tillë. Sipas Gjykatës natyra diskriminuese e akteve gjenocidiale është elementi përbërës i ***actus reus***, pasi viktimat e gjenocidit është i/e përzgjedhur, si pasojë e qënies pjesë të grupit që autori kërkon të shkatërrojë. Është anëtarësia e individit në një grup të caktuar elementi specifik dhe vendimtar për ekzekutimin e kësaj vepre penale dhe jo identiteti i individit. Gjykata (Dhoma e Apelit) arriti deri në analizën krahasimore të mirëfilltë ndërmjet gjenocidit dhe krimit të përndjekjes, i cili dhe ky i fundit si një lloj specifik akti kriminal ofron zgjedhjen e viktimave të cilat i përkasin një komuniteti të caktuar, por i mungon qëllimi specifik (*dolus specialis – formë e dashje specifike*) për të shkatërruar pjesërisht apo plotësisht grupin. Përpara se të analizonte vetë synimin final të autorit për të kryer gjenocid, Gjykata vuri në dukje dështimin e akuzës për të provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistencën e një plani për të shkatërruar grupin musliman në Brčko ose gjetkë, në të cilët i akuzuari kreu vrasje. Bazuar në

¹⁰⁸ Çështja Prokurori kundër Jelisić, vendim i Dhomës së Apelit të Tribunalit Ndërkombëtar, IT-95-10-A, Hagë datë 5 Korrik 2001. Shih: <http://www.icty.org> (aksesuar online: 05/12/2017).

provat e sjella Gjykata e pati të pamundur që të vendoste pro akuzës për gjenocid, pasi i akuzuari kishte vrarë në mënyrë arbitrare muslimanë, por nuk u provua dot ekzistenca e qëllimit (*dolus specialis*) për të shkatërruar grupin. Dhoma e Apelit la në fuqi vendimin e dhënë nga Dhoma e Gjykimit, e cila e kishte dënuar z. Jelisić me 40 vite burgim për “krime kundër njerëzimit” dhe “krime lufte” dhe hodhi poshtë kërkesën për lirim. Me fjalë të tjera, gjykata nuk donte të thoshte se në Brčko nuk ishte kryer gjenocid, në fakt, ndërmjet majit dhe korrikut 1992 forcat serbe detyruan qindra myslimanë dhe kroatë nga Bosnja të jetonin në kushte çnjerëzore në ‘Kampin e Lukës’ dhe nën kontrollin e armatosur, por dëshmia e përfshirjes së të pandehurit nuk zbulon në të një qëllim specifik të krimit të gjenocidit, por unë mendoj se sjellja e tij oportuniste dhe jokonzistente, për të cilën Jelisić duket se ka vepruar spontanisht dhe pa ndjekur një logjikë shumë të saktë duhej analizuar nga ana e gjykatës. Nga rrethanat faktike, në fakt, nëse në njërën anë i pandehuri shprehu haptazi urrejtjen e tij ndaj muslimanëve duke i vrarë ata ashtu siç dëshironte, në anën tjetër, disa prej tyre u liruan për t’i shpëtuar kampit të burgimit dhe për t’u kthyer në shtëpi, element i cili tregon se i pandehuri nuk kishte ndërmend të shkatërronte grupin musliman si të tillë.

Nga ana tjetër, çështja **Millosević** paraqet rëndësinë e saj jo vetëm për faktin se Slobodan Millosević ishte i akuzuar drejtpërdrejtë si përgjegjës për krimet e kryera në territorin e Kosovës, por edhe për problematikat e shumta me të cilat e përballi vetë Gjykatën. Ishte mëse e logjikshme që një subjekt si Millosević tentonte në çdo fazë gjykimi që ta kthente seancën në një fushë të mirëfilltë debatesh politike, duke hedhur poshtë çdo akuzë të ngritur në drejtimin e tij. Me të drejtë Prokurore Carla Del Ponte, në fjalët e saj të hapjes së shqyrtimit gjyqësor për çështjen Millosević theksonte se: *“Ky Tribunal, dhe ky gjykim në veçanti japin demonstratën më të fuqishme se askush nuk është mbi ligjin ose përtej mundësive të drejtësisë ndërkombëtare”*.¹⁰⁹ Millosević dhe të akuzuarit e tjerë sipas Prokurorisë akuzoheshin për një sërë krimesh të kryera kryesisht në territorin e Kosovës, Kroacisë dhe Bosnjë – Hecegovinës. Secili nga ata akuzohej specifikisht për: “Krime kundër njerëzimit”, në përputhje me Nenin 5 të Statutit¹¹⁰, që përfshin persekutimin, dëbimin dhe vrasjen. Gjithashtu vrasja nga ana e organit të

¹⁰⁹ Slobodan Milošević Trial – The Prosecution’s Case, Press Release. Shih: <http://www.icty.org/en/content/slobodan-milo%C5%A1evi%C4%87-trial-prosecutions-case> (aksesuar online: 05/12/2017).

¹¹⁰ Neni 5 (Krime kundër njerëzimit) të Statutit të Aktualizuar të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë thekson: *“Tribunali Ndërkombëtar ka kompetencë të procedojë penalisht individë përgjegjës për krimet e mëposhtme kur kryhen gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm, dhe të drejtuar kundër çfarëdo popullsie civile:*

- a) vrasje;
- b) shfarosje;
- c) robërim;
- d) dëbim;
- e) burgim;
- f) torturë;
- g) përdhunim;
- h) përndjekje mbi baza politike, racore dhe fetare;
- i) veprime të tjera çnjerëzore”.

akuzës përfshihej si një element përbërës i “Shkeljes së ligjeve dhe zakoneve të luftës” në përputhje me Nenin 3 të Statutit të Tribunalit, në bazë të asaj që njihet si i tillë nga neni 3 (1)-a të Konventave të Gjenevës së vitit 1949¹¹¹. Ngjarjet mbi të cilat bazohet aktakuza pohohet se kanë ndodhur në Krahinën Autonome të Kosovës në pjesën jugore të Republikës së Serbisë, një republikë përbërëse e Republikës Federale të Jugosllavisë, midis 1 janarit dhe fundit të prillit 1999. Në fillim të kësaj periudhe, pothuajse 90% e popullsisë së asaj province ishte shqiptare dhe pjesa e mbetur ishin serbë. Forcat ushtarake të Republikës Federale të Jugosllavisë, forcat policore të Serbisë, disa njësi policore nga Republika Federale e Jugosllavisë dhe njësitë paraushtarake të ndërlidhura, pretendohen gjatë asaj periudhe që të jenë angazhuar, në bashkëpunim, në një seri të gjerë dhe sistematike të kundërvajtjeve kundër qyteteve dhe fshatrave të Kosovës. Modeli i përgjithshëm i ofensivës ishte që banorët shqiptarë të këtyre qyteteve dhe fshatrave të Kosovës u urdhëruan të largohen nga shtëpitë e tyre, pas kërcënimeve me vdekje. Pasi ata u larguan, prona që kishin lënë pas u vodh dhe shtëpitë e tyre u shkatërruan ose u bënë të pa banueshme nga zjarri. Ata u detyruan të bashkoheshin me shqiptarët e Kosovës të zhvendosur në mënyrë të ngjashme në rrugën drejt kufijve ndërmjet Kosovës dhe vendeve fqinje. Ata u keqtrajtuan fizikisht. Në shumë raste, burrat shqiptarë të Kosovës të zhvendosur ishin të ndarë nga gratë dhe fëmijët dhe u vranë. Në kufi, pasuria që kishin me vete u vidhej nga forcat ushtarake, duke përfshirë letrat e tyre të identifikimit dhe automjetet. Në disa raste, fshatrat u bombarduan fillimisht dhe shqiptarët e Kosovës u vranë gjatë bombardimeve. Aktakuza pohon se këto veprime që u ndërmorën ndaj shqiptarëve të Kosovës kishin si qëllim heqjen e një pjese të konsiderueshme të popullatës autonome shqiptare të Kosovës nga Kosova, në përpjekje për të siguruar kontrollin e vazhdueshëm serb mbi krahinën. Nëse këto fakte të evidentuara pranohen, ata vërtetojnë se forcat nga Republika Federale e Jugosllavisë dhe Serbia kanë përndjekur popullsinë civile shqiptare të Kosovës në baza politike, racore apo fetare në formën e deportimit dhe vrasjes, që përbëjnë krime kundër njerëzimit dhe shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës.¹¹² Pesë të akuzuarit u gjenden përgjegjës referuar aktakuzës bazuar në 2 elementë kumulativë¹¹³:

- 1) Duke iu referuar nenit 7 pika 1 të Statutit, përgjegjësia e tyre individuale duke planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer ose ndryshe ka ndihmuar dhe inkurajuar

¹¹¹ Neni 3 (Shkeljet e ligjeve ose zakoneve të luftës) të Statutit të Aktualizuar të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë thekson: “*Tribunali Ndërkombëtar ka kompetencë të procedojë penalisht individë që shkelin ligjet ose zakonet e luftës. Ndër shkelje të tilla përfshihen:*

- a) *përdorim i armëve helmuese ose i armëve të tjera të paramenduara të shkaktojnë vuajtje të panevojshme;*
- b) *shkatërrim pa shkak i qyteteve ose fshatrave, ose shkretimeve të pamundurshme nga domosdoshmëria ushtarake;*
- c) *sulm ose bombardim me çfarëdo mjetesh i qyteteve, fshatrave, banesave ose ndërtesave të pambrojtura;*
- d) *zaptim, shkatërrim, ose dëmtim i qëllimshëm i institucioneve fetare, bamirëse, arsimore, artistike dhe shkencore, i monumenteve historike dhe i veprave të artit dhe të shkencës;*
- e) *plaçkitje e pronës publike ose private”.*

¹¹² Paragrafi 8 i Aktakuzës: Prosecutor v. Slobodan Milošević, Milan Milutinović, Nikola Šainović, Dragoljub Ojdanić and Vlasto Stojiljković, 24 Maj 1999.

Shih: http://www.icty.org/x/cases/slobodan_milosevic/tdec/en/052499rev.htm (aksesuar online: 05/12/2017).

¹¹³ Paragrafi 9 i Aktakuzës: Prosecutor v. Slobodan Milošević, Milan Milutinović, Nikola Šainović, Dragoljub Ojdanić and Vlasto Stojiljković, 24 Maj 1999.

Shih: http://www.icty.org/x/cases/slobodan_milosevic/tdec/en/052499rev.htm (aksesuar online: 05/12/2017).

planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e një krimi të përmendur në nenet 2 deri në 5 të këtij Statuti është individualisht përgjegjës për krimin; dhe

- 2) Referuar nenit 7 pika 3 të Statutit, në lidhje me katër prej të akuzuarve (i akuzuari Sainović u përjashtua), autoriteti i tyre superior, duke njohur ose pasur arsye për të ditur se vartësit e tyre ishin gati të kryejnë akte të tilla ose e kishin bërë këtë, por që nuk kishin marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar kryerjen e akteve të tilla ose për të ndëshkuar ata vartës që i bënë ato akte.

Por aktakuza e paraqitur u amendua më datë 16 Tetor 2001¹¹⁴ nga ana e organit të akuzës dhe me datë 05 Shtator 2002 Dhoma Gjyqësore ndau procedimet kundër Millosheviç, nga të akuzuarit e tjerë. E gjithë procedura e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje vlen për diskutim në kuadrin e mekanizmit të mbrojtjes ofruar nga Tribunali, një përjashtim i mirëfilltë nga jurisprudenca e ndjekur precedente, së drejtës për t'u vetëmbrojtur zgjedhur nga Millosheviç dhe trajtimi e mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve gjatë seancave. E gjithë arena ndërkombëtare dhe juristët më të shquar të kohës “u zhgënjyen” nga vendimi i marrë nga Tribunali i Hagës, ku në rastin e Bosnje-Hercegovinës çdo veprim i ndërmarrë u trajtua si gjenocid, ndërkohë që në rastin e Kosovës nuk u pa e arsyeshme që të trajtohej në këtë mënyrë. Përsa i përket Bosnje-Hercegovinës, aktakuza pretendonte se Millosheviç mori pjesë në një JCE, e cila u krijua nga data 1 gusht 1991 dhe vazhdoi deri më 31 dhjetor 1995. Qëllimi i JCE-së ishte largimi i dhunshëm dhe i përhershëm i shumicës jo serbe, kryesisht muslimanëve boshnjakë dhe kroatëve boshnjakë, nga zonat e mëdha të Bosnje dhe Herzegovinës. Millosheviç ishte Presidenti i Republikës së Serbisë gjatë periudhës përkatëse dhe si i tillë, u pretendua, se ka ushtruar kontroll të efektshëm ose ndikim substancial mbi pjesëmarrësit në JCE, vetëm ose duke vepruar në bashkëpunim me ta dhe persona të tjerë të njohur dhe të panjohur, ka kontrolluar në mënyrë efektive ose ka ndikuar ndjeshëm në veprimet e Presidencës Federale të RSFJ-së dhe më vonë të RFJ-së, MPB-së, APJ-së dhe më vonë të UJ-së, Ushtrisë Serbe të Bosnjës (VRS), si dhe grupeve paraushtarake serbe. Dhoma Gjyqësore konkludon se ekzistojnë prova të mjaftueshme se gjenocidi është kryer në Brcko, Prijedor, Sanski Most, Srebrenicë, Bijeljina, Ključ dhe Bosanski Novi dhe se ka dëshmi të mjaftueshme se i akuzuari ishte pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, e cila përfshinte udhëheqjen serbe boshnjake, qëllimi i së cilës ishte shkatërrimi i një pjese të muslimanëve boshnjakë si grup. Millosheviç u dënua për gjenocid dhe bashkëpunim në gjenocid (në përputhje me nenin 4 të Statutit të Tribunalit) për rastin e Bosnje-

¹¹⁴ Në amendimin bërë aktakuzës nga ana e Prokurorit, tashmë me datë 16 Tetor 2001 (Për Çështjen Kosova) Millosheviç akuzohej si përgjegjës për: 1. Deportim, si një Krim kundër njerëzimit (i dënueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit të Tribunalit; 2. Akte të tjera çnjerëzore ‘Transferim me forcë’ në kuadrin e Krimeve kundër njerëzimit (i dënueshëm sipas Nenit 5 (i) të Statutit të Tribunalit; 3. Për episodin e ngjarjeve të ndodhura në krahinën e Raçakut (Komuna Shtimje) referuar sulmeve nga forcat FRY dhe serbe, akuzoheshin për Vrasje në kuadrin e Krimeve kundër njerëzimit (i dënueshëm sipas Nenit 5 (a) të Statutit të Tribunalit; 4. Vrasje në kuadrin e Shkeljeve të ligjeve dhe zakoneve të luftës (i dënueshëm sipas Nenit 3 të Statutit të Tribunalit, në referim me Nenin 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës; 5. Persekutime mbi baza politike, raciale dhe fetare si një Krim kundër njerëzimit (i dënueshëm sipas Nenit 5(h) të Statutit të Tribunalit) për episodin e transferimit të dhunshëm, deportimit dhe vrasjes së rreth 800.000 shtetasve kosovarë-shqiptarë. Shih: Parag.62 e vijues të aktakuzës së Prokurorës Carla Del Ponte: http://www.icty.org/x/cases/slobodan_milosevic/ind/en/mil-2ai011029e.htm (aksesuar online: 05/12/2017).

Hercegovinës, pasi Dhoma Gjyqësore u shpreh e bindur përtej çdo dyshimi të arsyeshëm së i akuzuari ishte pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për të kryer gjenocid, dhe referuar pozitës së të akuzuarit ishte e arsyeshme që të parashikonte që, si pasojë e kryerjes së këtyre krimeve, gjenocidi i një pjese të muslimanëve boshnjakë si një grup do të kryheshin nga pjesëmarrës të tjerë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, dhe është kryer.

Prokurori kundër Ratko Mladić, është një tjetër i akuzuar dhe i dënuar për gjenocid nga Tribunali i Hagës.¹¹⁵ Edhe pse nga ana e organit të akuzës në ngritjen e aktakuzës në vitin 1995, fillimisht u pretendua se Mladić duhej të gjykohej sëbashku me të bashkëpandehurin Radovan Karadzic¹¹⁶, por në përfundim Tribunali doli me një vendim gjyqësor individual pasi dhe akuza ndryshoi cilësimin juridik të veprave penale të parashikuara.¹¹⁷ I akuzuari ishte gjykuar për 11 akuza për krime të dyshuara si të kryera në cilësinë e tij si Komandant i Shtabit Kryesor të Ushtrisë së Republikës Boshnjake, i njohur edhe si VRS, ndërmjet 12 maj 1992 dhe 30 nëntor 1995. Aktakuza kishte ngritur dy akuza për gjenocid e bashkëpunim në gjenocid (por akuza e bashkëpunimit në gjenocid, e parashikuar nga neni 4(3)(a), 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit u hodh poshtë nga ana e Dhomës Gjyqësore) dhe pesë akuza për krime kundër njerëzimit, përkatësisht përndjekje, vrasje, shfarsje, dëbim dhe akt çnjerëzor i transferimit të dhunshëm. Ai gjithashtu ishte akuzuar në katër raste për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, përkatësisht vrasjeve, akteve të dhunës, qëllimet kryesore të të cilave ishte përhapja e terrorizmit në mesin e popullatës civile, sulme të paligjshme ndaj civilëve dhe marrja e pengjeve. Shtrirja gjeografike e aktakuzës përfshinte Sarajevën, Srebrenicën dhe 15 komuna në Bosnje-Hercegovinë. Përsa i përket, *mens rea* të gjenocidit, Dhoma Gjyqësore theksoi se, kur mungon dëshmia e drejtpërdrejtë e qëllimit specifik, ky qëllim mund të nxirret nga faktet dhe rrethanat përreth, të cilat mund të përfshijnë kryerjen nga autorët fizik të akteve të tjera të fajshme. Këto fakte dhe rrethana mund të përfshijnë gjithashtu lidhjet midis autorëve fizikë në aspektin e kohës, vendndodhjes dhe përbërjes së grupit të tyre. Në këtë rast, grupet e mbrojtura ishin muslimanë boshnjakë dhe kroatë boshnjakë. Dhoma konkludoi se një numër i madh muslimanësh boshnjakë dhe kroatë boshnjakë në disa prej komunave ishin nënshtruar vrasjeve dhe/ose dëmtimeve të rënda trupore ose mendore. Në mënyrë unanime Dhoma konkludoi se autorët fizikë në Sanski Most, Vlasenicë dhe Foča dhe disa autorë në Kotor Varoš dhe Prijedor kishin për qëllim të shkatërronin muslimanët boshnjakë në ato komuna, si pjesë e grupit të mbrojtur. Dhoma pastaj shqyrtoi nëse pjesa e shënjestruar përbënte një pjesë të konsiderueshme të grupit të mbrojtur dhe arriti në përfundimin se muslimanët boshnjakë që ishin në shënjestër në secilën komunë formuan një pjesë relativisht të vogël të grupit të mbrojtur dhe ishin gjithashtu në mënyra të tjera jo një pjesë thelbësore. Rrjedhimisht, Dhoma nuk ishte e bindur se i vetmi përfundim i arsyeshëm ishte se autorët fizikë zotëronin qëllimin e kërkuar për të shkatërruar një pjesë të konsiderueshme të

¹¹⁵ Vendim i Dhomës Gjyqësore, Prokurori kundër Ratko Mladić, No. IT-09-92-T, 22 Nëntor 2017. Shih: <http://www.icty.org> (aksesuar online: 07/12/2017).

¹¹⁶ Padi Prokurori kundër Radovan Karadzic, Ratko Mladic, No. IT-95-18-I, 14 Nëntor 1995. Shih: <http://www.icty.org/case/mladic/4> (aksesuar online: 07/12/2017).

¹¹⁷ Në vitin 2002 Prokurori kërkoi ndryshimin e padisë, No. IT-95-5/18-I, 10 Tetor 2002. Shih: <http://www.icty.org> (aksesuar online: 07/12/2017).

grupit të mbrojtur të muslimanëve boshnjakë. Vetëm në Srebrenicë, Tribunali reflektoi bindje ndaj provave të paraqitura për të mbrojtur akuzën e gjenocidit. Dhoma konkludoi se aktet e ndaluara, të përcaktuara në përkufizimin ligjor të gjenocidit, si vrasja dhe shkaktimi i lëndimeve të rënda trupore dhe mendore janë kryer nga autorët fizikë kundër muslimanëve boshnjakë të Srebrenicës. Dhoma konkludoi se autorët fizikë kishin për qëllim shkatërrimin e muslimanëve boshnjakë në Srebrenicë, një pjesë e konsiderueshme e grupit të mbrojtur. Prandaj, Dhoma vendosi që krimet e gjenocidit, persekutimit, shfarosjes, vrasjes dhe veprimit çnjerëzor të transferimit të dhunshëm u kryen kundër muslimanëve boshnjakë në dhe rreth territorit të Srebrenicës. Midis majit 1992 dhe 1995, i akuzuari lëshoi urdhra që krijuan dhe organizuan VRS-në dhe organet e saj. I akuzuari ishte gjithashtu i përfshirë ngushtë në operacionet e VRS-së siç dëshmohet nga informime, takime dhe inspektive të rregullta; dhe lëshoi urdhra dhe direktiva operacionale njësisive të VRS-së si dhe grupeve të tjera. Ndërmjet shtatorit 1992 dhe të marsit 1995, i akuzuari paraqiti dhe mbajti një sistem të kontrolluar dhe të centralizuar të përhapjes së propagandës në lidhje me kroatët boshnjakë dhe muslimanët boshnjakë. I akuzuari gjithashtu bëri deklaratatë të qëllimshme mashtruese për anëtarët e mediave dhe të bashkësisë ndërkombëtare në lidhje me krimet e kryera. Veprat e të akuzuarit ishin kaq të dobishme për kryerjen e krimeve, që pa to krimet nuk do të ishin kryer ashtu siç u kryen. Në dritën e kësaj, Dhoma konkludoi se nëpërmjet veprimeve të tij, i akuzuari kontribuoi dukshëm në arritjen e objektivit të përbashkët për heqjen e përhershme të muslimanëve dhe kroatëve nga territori i pretenduar serb në Bosnje-Hercegovinë duke kryer krime të persekutimit, shfarosjes, vrasjes, deportimit dhe aktin çnjerëzor të transferimit të dhunshëm. Përsa i përket episodit të gjenocidit të njohur në Srebrenicë, i akuzuari në veçanti rekomandoi promovimin e Krstić për të zëvendësuar Živanović si Komandant i Trupave të Drinës, ky rekomandim u zbatua më 13 korrik 1995; midis të paktën 11 korrikut dhe 11 tetorit 1995, ai lëshoi disa urdhra për forcat e VRS, duke përfshirë Trupat e Drinës, lidhur me operacionet në dhe përreth Srebrenicës; dhe më 11 dhe 12 korrik 1995, urdhëroi komandantin e Borovčanin tek MUP dhe njësitë e tij. Duke u bazuar në sa më sipër, Dhoma konkludoi se i akuzuari kishte për qëllim të eliminonte muslimanët boshnjakë në Srebrenicë, duke vrarë burrat dhe djemtë dhe duke hequr me forcë gratë, fëmijët e vegjël dhe disa njerëz të moshuar nëpërmjet kryerjes së krimeve të persekutimit, vrasjes, shfarosjes, dhe aktin çnjerëzor të transferimit të dhunshëm. Dhoma konkludoi se i vetmi përfundim i arsyeshëm ishte se i akuzuari kishte për qëllim të shkatërronte muslimanët boshnjakë në Srebrenicë si një pjesë e konsiderueshme e grupit të mbrojtur të muslimanëve në Bosnjë Hercegovinë. Prandaj, Dhoma konkludoi se i akuzuari kishte për qëllim të realizonte qëllimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale në Srebrenicë përmes kryerjes së veprës penale të gjenocidit dhe ishte anëtar i JCE-së në Srebrenicë.¹¹⁸

Përgjegjësia penale në rastin e krimeve të përfshira në juridiksionin e Tribunalit, veçanërisht në rastin e gjenocidit është tepër komplekse. Jurisprudenca e Tribunalit shpesh herë e ka pasur të

¹¹⁸ Vendim i Dhomës Gjyqësore, Prokurori kundër Ratko Mladić, No. IT-09-92-T, 22 Nëntor 2017, f. 1755. Shih: <http://www.icty.org> (aksesuar online: 07/12/2017).

pamundur që të bazojë vendimin e saj në prova relevante dhe objektive, pasi në rastin e vërtetimit të një veprë penale nga ana e akuzës nevojitet një bazë e fortë e lidhjes shkakësore. Në çështjen **Prokurori kundër Zdravko Tolimir**¹¹⁹, u trajtua pikërisht përgjegjësia penale e të akuzuarit për krimet e kryera në enklavat e Srebrenicës dhe Žepës, në Bosnjën Lindore, më 1995. Në atë kohë Z. Tolimir ishte një Komandant Ndhmës dhe Shefi i Sektorit për Inteligjencë dhe Çështje të Sigurisë të Shtabit Kryesor të Armatës së Republikës Srpska (‘VRS’). Dhoma Gjyqësore, e gjeti Tolimirin fajtor sipas nenit 7 (1) të Statutit të Tribunalit për gjenocid, komplot për të kryer gjenocid, shfarosje, vrasje, përndjekje dhe veprime çnjerëzore përmes transferimit të dhunshëm.¹²⁰ Grupi i popullsisë muslimane të Bosnjës Lindore, ishte një pjesë thelbësore e popullsisë boshnjake në atë zonë.¹²¹ Në arritjen e përfundimit mbi kualifikimin e grupit sipas nenit 4 të Statutit, Dhoma Gjyqësore iu referua dhe zbatoi me analogji arsyetimin e dhënë në gjykimin e çështjes Popović dhe të tjerë, si dhe në çështjen Krstić, për arsyen se pse popullata muslimane boshnjake e Srebrenicës, megjithëse një përqindje e vogël e popullsisë së përgjithshme muslimane të BiH, përbënte një pjesë të konsiderueshme të atij grupi. Rrethanat në të cilat muslimanët boshnjakë u përballën me vdekjen kategorizohen nga dëshmitë në 23 episode masakrash të ndërmarra në zonat Potočari, Bratunac, Zvornik, dhe rrethinat në Bišina, afër Trnovo dhe afër Tišća. Grupi i burrave që zgjodhi të mos bashkohej me kolonën e muslimanëve boshnjakë, të cilët u drejtuan në territorin e mbajtur nga ABiH pas rënies së Srebrenicës më 11 korrik 1995 dhe u bashkuan me familjet e tyre për të kërkuar strehim në kompleksin e Kombeve të Bashkuara në Potočar, u bindën se nuk kishte shpresë për t’u mbrojtur. Dhoma gjykon se grupi i burrave të ndarë në Potočar dhe të marrë në Shtëpinë e Bardhë, si dhe grupi i burrave që u dorëzuan ose u kapën nga kolona gjatë 13 korrikut kishte një dallim, pasi këta të fundit do të ishin në dijeni në një fazë apo në një tjetër të mundësive reale se ata përfundimisht do të ishin viktimat në duart e forcave serbe boshnjake të cilët i mbajtën ato. Ajo konstaton se vuajtja e këtyre njerëzve, në ditët dhe orët para se të vriteshin, përbënte një dëm të rëndë trupor ose mendor. Dhoma Gjyqësore vlerësoi se aktet e mëposhtme të genocidit u kryen kundër popullatës muslimane boshnjake të rajonit BiH Lindor në bazë të nenit 4 (2) të Statutit: **(i)** vrasjen e të paktën 5,749 meshkujve muslimanë të Bosnjës nga Srebrenica dhe të tre udhëheqësve të Žepa; **(ii)** shkaktimi i një dëmtimi të rëndë trupor apo mendor tek meshkujt boshnjakë muslimanë të Srebrenicës, të cilët u arrestuan dhe më pas çuan në vende të ekzekutimit; gratë muslimane boshnjake, fëmijët dhe të moshuarit nga Srebrenica të cilët u transferuan me forcë në territorin e mbajtur nga ABiH; dhe popullsia muslimane boshnjake u transferua me forcë nga Žepa; **(iii)** shkaktimi i qëllimshëm i kushteve të jetesës ndaj popullatës muslimane boshnjake të BiH-së lindore, me qëllim për të sjellë shkatërrimin e saj si grup përmes efektit të kombinuar të operacioneve të transferimit të dhunshëm dhe vrasjes. Dhoma Gjyqësore konstatoi se Forcat Serbe të Bosnjës shkaktuan dëm të rëndë trupor ose mendor, siç përcaktohet në Nenin 4 (2) (b) të

¹¹⁹ Vendim i Dhomës së Apelit, Prokurori kundër Zdravko Tolimir, No. IT-05-88/2-A, 8 Prill 2015. Shih: <http://www.icty.org> (aksesuar online: 07/12/2017).

¹²⁰ Vendim i Dhomës Gjyqësore, Prokurori kundër Zdravko Tolimir, No. IT-05-88/2-T, 12 Dhjetor 2012. Shih: <http://www.icty.org> (aksesuar online: 07/12/2017).

¹²¹ Ibid, f. 331.

Statutit, në tre grupe muslimanëve boshnjakë: *së pari*, meshkujt muslimanë boshnjakë nga Srebrenica u ndanë nga familjet e tyre në Potočari dhe ata burra nga kolona që u ndalën në kushte të tmerrshme para ekzekutimit të tyre ose tentativës së ekzekutimit, të cilët, siç tha Dhoma Gjyqësore, *"do të ishin bërë të vetëdijshëm në një fazë ose në një tjetër e mundësisë reale që ata në fund të fundit do të përmbushin vdekjen e tyre në duart e forcave serbe boshnjake të cilët i mbajtën ato"*; *së dyti, gratë*, fëmijët dhe të moshuarit të ndarë nga anëtarët meshkuj të familjeve të tyre të cilët u transferuan forcërisht pësuan thellë një traumë të fortë psikologjike; dhe *së treti*, popullsia muslimane boshnjake u transferua me forcë nga Žepa midis 25 dhe 27 korrik 1995 në rrethana që shkaktuan dëmtimin e rëndë mendor. Dhoma e Apelit rikujton se "kërcënimet e vdekjes" dhe njohuritë për vdekjen e afërt janë pranuar si vlerë e rëndë mendore sipas nenit 4 të Statutit. Për më tepër, nuk ka asgjë në Statut ose në Konventën e Gjenocidit që pengon një dhomë gjyqësore të konsiderojë dëmin e pësuar nga një viktimë para vdekjes si një akt i veçantë i gjenocidit. Duke marrë parasysh gjetjet e Dhomës Gjyqësore lidhur me procesin e ndarjes së dhimbshme të grave, fëmijëve dhe të moshuarve nga anëtarët e tyre meshkuj në Srebrenicë, frika dhe pasiguria për fatin e tyre dhe fatin e të afërmeve të tyre të ndaluar, si dhe kushtet e tmerrshme të udhëtimit të tyre Dhoma e Apelit është e kënaqur që Dhoma Gjyqësore dha arsyetim të mjaftueshëm për përfundimin e saj se vuajtjet e grave, fëmijëve dhe të moshuarve të transferuar me forcë nga Srebrenica shkaktuan dëm të rëndë mendor dhe kështu përbënin një akt gjenocidi sipas nenit 4 (2) (b). Dhoma e Apelit rikujton se neni 4 (2) (c) i Statutit mbulon metodat e shkatërrimit që nuk i vrasin menjëherë anëtarët e grupit, por në fund kërkojnë shkatërrimin e tyre fizik. Tribunali e dinte se veprimet që i përkasin "gjenocidit kulturor" përjashtohen nga fusha e Konventës së Gjenocidit. Prandaj, Dhoma Gjyqësore kreu një gabim ligjor në konsiderimin e shkatërrimit të xhamive në Srebrenicë dhe Žepa sipas Nenit 4 (2) (c) të Statutit. Në dritën e gabimeve ligjore të identifikuar më lart, Dhoma e Apelit do të vazhdojë të shqyrtojë gjetjet faktike të Dhomës Gjyqësore dhe dëshmitë në procesverbal, me qëllim që të përcaktojë nëse operacionet e transferimit të dhunshëm të popullsisë muslimane të Srebrenicës dhe Žepës, duke përjashtuar vrasjet e meshkujve të Srebrenicës dhe shkatërrimit të xhamive në enklava, janë kryer në rrethana të tilla në mënyrë që të imponojnë grupet e mbrojtura kushtet e jetës që plotësojnë pragun e nenit 4 (2) (c) të Statutit. Në këtë drejtim, Dhoma e Apelit kujton qëndrimin e mbajtur prej saj në rastin Krstić se një operacion i transferimit të dhunshëm nuk përbën shkatërrim fizik si të tillë dhe zhvendosja e një grupi të mbrojtur, tërësisht ose pjesërisht, nuk përbën një akt gjenocidi. Dhoma e Apelit, pas shqyrtimit të kujdesshëm të provave relevante, nuk është e bindur se operacionet e transferimit të dhunshëm në Srebrenicë dhe Žepa, të shikuara veçmas nga vrasjet e popullsisë meshkuj të Srebrenicës, janë kryer nën rrethana të llogaritura për të rezultuar në shkatërrimin total ose të pjesshëm fizik të grup të mbrojtur. Megjithatë Dhoma e Apelit është e bindur se ka pasur një plan të qëllimshëm për të dëbuar gratë, fëmijët dhe të moshuarit muslimanë boshnjakë nga Srebrenica dhe gjithë popullsia muslimane nga Žepa, Dhoma e Apelit konstaton se nuk është bindur përtej dyshimit të arsyeshëm se një politikë e tillë e transferimit, e zbatuar përmes JCE-së, kishte për qëllim shkaktimin e shkatërrimit fizik të këtyre popullatave. Dhoma e Apelit ka konfirmuar konstatimin

e Dhomës Gjyqësore se muslimanët boshnjakë të Žepës, së bashku me myslimanët e Srebrenicës dhe BiH Lindore në përgjithësi, janë anëtarë të grupit të mbrojtur në kuptim të nenit 4 të Statutit dhe ishin kështu ndër të parët viktime të ndërmarrjes gjenocidale kundër myslimanëve të BiH-së lindore. Synimi selektiv i figurave udhëheqëse të një komuniteti mund të përbëjë gjenocid dhe mund të jetë tregues i qëllimit gjenocidal. Për gjetjen e gjenocidit mjafton që liderët të zgjidhen për ndikimin, që zhdukja e tyre, do të kishte për mbijetesën e grupit si të tillë. Të tre udhëheqësit e Žepa u arrestuan dhe u ndalën menjëherë pas përfundimit të operacionit të heqjes së forcave në Žepa në fund të korrikut 1995 dhe se Hajrić dhe Imamović u vranë diku në fund të gushtit 1995, ndërsa Palić u vra në fillim të shtatorit 1995. Dhoma e Apelit kujton se karakteri i sulmit ndaj udhëheqjes duhet të shikohet në kontekstin e fatit apo çfarë ndodhi me pjesën tjetër të grupit në të njëjtën kohë ose pas sulmit. Nga referencat dhe provat e evidentuara, Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur priste që tre udhëheqësit e Žepa ishin të vrarë nga forcat serbe boshnjake me synimin specifik për të shkatërruar një pjesë të popullsisë muslimane boshnjake si të tillë.

2.3.3. Parashikimi i gjenocidit sipas Statutit të Romës

Mbështetja për përfshirjen e këtij krimi në juridiksionin juridik (*ratione materiae*) të Gjykatës ka qenë praktikisht universale. Themelimi i një Gjykate Penale Ndërkombëtare me juridiksion mbi krimin e gjenocidit në fakt është parë nga shumë prej tyre si një nga arsytet më të rëndësishme për themelimin e Gjykatës. Nga të gjitha krimet e përfshira në juridiksionin e Gjykatës, ai i gjenocidit ishte i vetmi që pranoi një pëlqim të shpejtë dhe unanim nga shtetet pjesëmarrëse në Konferencë, dhe kjo ndodhi si nismë e Gjykatës për të parandaluar dhe shtypur këtë krim me çdo kusht, qoftë edhe nëse Gjykata vazhdon të ushtrojë funksionin e saj pas 15 vitesh.

Siç është theksuar në çdo seksion të këtij punimi, gjenocidi është një nga krimet më tipike, i bazuar në depersonalizimin e viktimës, pra ku viktime përbën objekt të veprës penale jo për shkak të cilësisë së saj personale, por për shkak të anëtarësimit në një grup të caktuar. Në **nenin 6 të Statutit të Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare**, të miratuar nga Konferenca Diplomatike e të Plotëfuqishmëve në Kombet e Bashkuara për themelimin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, më 17 Korrik 1998 dhe e hyrë në fuqi më 1 Korrik 2002, është parashikuar vepra penale e gjenocidit.¹²² Kjo dispozitë reflekton në një mënyrë të njëjtë literale parashikimin e gjenocidit sipas Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Gjenocidit (1948). Por në dallim nga Konventa, në Statut nuk janë parashikuar aktet e reflektuara në nenin 3 të Konventës (1948), pasi Statuti ka preferuar që këto akte t'i parashikojë në nenin 25 të tij ku është sanksionuar “Përgjegjësia personale individuale”. Në pikën (e) të nenin 25 të Statutit të Romës, është parashikuar si përjashtim nga krimet e tjera nën juridiksionin *ratione materiae* të Gjykatës, se personi do të jetë përgjegjës personalisht në rastin e gjenocidit kur në mënyrë të

¹²² Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, hyrë në fuqi më 1 Korrik 2002. Shih: <https://www.icc-cpi.int> (aksesuar online: 07/12/2017).

drejtpërdrejtë apo publikisht nxit të tjerët për të kryer krimin. **Por në këtë drejtim ka një mospërputhje ndërmjet Konventës dhe Statutit, pasi ky i fundit në nenin 25 ka parashikuar vetëm nxitjen, tentativën dhe bashkëfajësinë duke përjashtuar marrëveshjen si element të përgjegjësisë penale.**¹²³ Në lidhje me këtë nocion ka patur mjaft debate gjatë hartimit të Konventës, pasi një pjesë shtetesh kundërshtuan me argumentimin se rendet e tyre të brendshme juridike nuk e parashikonin marrëveshjen si element për përgjegjësi penale. Gjithashtu tentativa për të kryer gjenocid paraqet një shkallë rrezikshmërie mjaft të lartë, megjithëse nuk vijnë pasojat e dëshiruara. Duke marrë në konsideratë qëllimin e posaçëm, shkatërrimin tërësisht apo pjesërisht të një grupi, i cili vështirë të realizohet nga një person i vetëm, është mjaft e arsyeshme përfshirja e bashkëfajësisë për gjenocid. Të gjithë elementët që përbëjnë anën objektive të gjenocidit ashtu siç është parashikuar në Konventë, duhet që nga pikëpamja subjektive të kryhen me qëllim kriminal për të shkatërruar në tërësi apo në një pjesë një grup kombëtar, etnik, racial apo fetar. Kjo kategori e veprave penale përsa i përket formës së dashjes, konsumohet me dashje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Elementët bazë të përkufizimit të këtij krimi, sipas nenit 6 të Statutit konsistojnë në qëllimin specifik (*mens rea*) me synimin për të shkatërruar një nga katër grupet e mbrojtura për shkak të natyrës së tyre të veçantë dhe pikërisht për të kryer një akt të ndaluar (*actus reus*). Prandaj krimi i gjenocidit kërkon një qëllim specifik për të kryer këto veprime të ndaluara. Ashtu siç është parashikuar në Raportin e Komisionit për të drejtën ndërkombëtare, në vitin 1996, këto akte janë për nga natyra e tyre të qëllimshme, sepse individit nuk mund t'i kryejë ato pa ditur pasojat që ato shkaktojnë.¹²⁴ Ata sigurisht nuk i përkasin atyre llojeve të veprave që mund të ndodhin gabimisht ose me neglizhencë të thjeshtë. Përcaktimi i këtij krimi duke kërkuar një qëllim specifik dhe njohuri për të gjitha pasojat e aktit të ndaluar duket se përjashton mundësinë që gjenocidi të mund të kryhet me një nivel më të ulët të *mens rea*. Megjithatë, përkufizimi vlen edhe për vartësit që ekzekutojnë urdhrat ashtu edhe ata që planifikojnë ose urdhërojnë gjenocidin, edhe nëse vartësi nuk mund të ketë të njëjtin nivel njohurish me ata që e planifikojnë atë. Lidhur me këtë pikë kritike, Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare shpjegoi se njohuria për qëllimin përfundimtar të sjelljes kriminale është e nevojshme dhe jo çdo detaj i politikës gjenocidale.¹²⁵ Prandaj supozohet se një vartës i njeh synimet e eprorëve të tij kur merr urdhra për të kryer veprime të ndaluara ndaj individëve që i përkasin një grupi të caktuar. Ai nuk mund t'i shpëtojë përgjegjësisë nëse ai ekzekuton këtë lloj urdhri duke pretenduar se ai nuk është i vetëdijshëm për të gjitha aspektet e planit gjenocid në tërësi; në fakt, ligji nuk lejon që një individ të mbrohet nga provat, duke qenë i qartë se ai është padyshim i vetëdijshëm për rëndësinë e efekteve destruktive të kësaj sjelljeje kriminale në grupin e veçantë. Prandaj shkalla e nevojshme e njohurisë dhe intencionalitetit duhet të nxirret nga natyra e urdhrat për të kryer veprime të ndaluara të shkatërrimit ndaj individëve që i përkasin një grupi të caktuar. Një element tjetër i rëndësishëm që mund të konkludohet nga përkufizimi i gjenocidit është qëllimi për të shkatërruar "në tërësi ose

¹²³ Shih f. 34 tw kwtij punimi.

¹²⁴ Raport i Komisionit për Asamblenë e Përgjithshme mbi punën e sesionit të tij të 48-të, Vjetari i Komisionit të Ligjit Ndërkombëtar, Vol. II, Pjesa 2, 1996, f. 88. Shih: <http://legal.un.org> (aksesuar online: 07/12/2017).

¹²⁵ Ibid, f. 90.

pjesërisht" një **grup kombëtar, etnik, racial ose fetar**. Para së gjithash kjo shprehje përjashton që krimi i genocidit mund të zgjerohet në aktet e izoluar të dhunës të motivuara për shembull nga urrejtja racore. Në shkurt të vitit 1997 grupi i punës së Komitetit Përgatitor për themelimin e Gjykatës, deklaroi se qëllimi për të shkatërruar "në tërësi ose pjesërisht" i referohej një qëllimi specifik për të shkatërruar shumë më tepër se një grup të vogël individësh që i përkasin një prej grupeve të mbrojtura nga përkufizimi. Pra, synimi për të shkatërruar një numër njerëzish nga i njëjti grup për shkak të përkatësisë në këtë grup, duhet të klasifikohet si gjenocid, edhe nëse këta njerëz përbëjnë vetëm një pjesë të një grupi brenda një vendi, rajoni ose komuniteti të vetëm, e rëndësishme është ekzistenca e një numri të konsiderueshëm.¹²⁶

Në një analizë të gjuhës së përdorur në nenin 6 të Statutit vërehet kompletimi i kësaj dispozite me 5 akte kriminale, nëpërmjet të cilave reflektohet konsumimi i krimit të gjenocidit. Këta marrin formën e gjenocidit fizik dhe biologjik, por jo kulturor, meqë ky lloj i fundit i gjenocidit është lënë jashtë qëllimisht nga hartuesit e Projektit të Konventës së vitit 1948. Kjo do të thotë që në qëllimet e redaktorëve të Projektit nuk përfshihej në mesin e akteve të gjenocidit ajo që sot e kemi njohur me trishtim nga termi "spastrimi etnik". Më vonë, Komiteti i Ekspertëve për ish-Jugosllavinë përsëriti se këto praktika "përbëjnë krime kundër njerëzimit dhe mund të asimilohen me krime të veçanta të luftës", duke specifikuar se akte të tilla mund të përfshihen gjithashtu në kuadër të Konventës së Gjenocidit. Në fakt, sipas gjykatësit Riad të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë, "*praktikat e mëparshme të spastrimit etnik paraqesin, në manifestimin e tyre të fundit, karakteristikat e gjenocidit. Për më tepër, në këtë rast qëllimi për të shkatërruar, në tërësi ose pjesërisht, një grup kombëtar, racial, etnik ose fetar, i cili është specifik për gjenocid, mund të konkludohet qartë nga serioziteti i spastrimit etnik praktikuar në Srebrenicë dhe në zonat përreth, kryesisht në vrasjet masive të muslimanëve që ndodhën pas rënies së Srebrenicës në korrik të vitit 1995 dhe që manifestohej me mizori të pashembullt*"¹²⁷. Së fundmi, është e rëndësishme të theksohet se ky debat ku praktikat e "spastrimit etnik" mund ose nuk mund të përfshihen në përkufizimin e gjenocidit, humbet rëndësinë e tij, sepse në kontekstin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, edhe nëse nuk përfshihen në nenin 6 të Statutit, pa dyshim janë mbuluar me nenin 7 që përcakton 'krimet kundër njerëzimit'.

Përsa i përket **germës "b"** të nenit 6 të Statutit të Romës, e cila parashikon 'shkaktimin e lëndimeve trupore apo mendore anëtarëve të grupit', Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare lidhur me këtë akt të ndaluar ka komentuar se "*dëmtimet fizike ose psikologjike të shkaktuara ndaj anëtarëve të grupit duhet të jenë të një natyre të tillë që të kërcënojnë shkatërrimin e tyre total ose të pjesshëm*".¹²⁸ Sigurisht që ky specifikim nuk është një ndihmë e madhe dhe mbi të gjitha ngatërron *actus reus* dhe *mens rea*. Komisioni Përgatitor për themelimin e Gjykatës në lidhje me dëmet psikike deklaroi se dëmi i shkaktuar përbëhej nga përkeqësimi i aftësive

¹²⁶ Robinson, N., *The Genocide Convention: a commentary*, Publisher: Institute of Jewish Affairs, World Jewish Congress, 1960, f.63.

¹²⁷ Aktakuza Prokurori kundër Radovan Karadzic, Ratko Mladić, No. IT-95-18-A, 25.07.1995, f.4. Shih: <http://www.icty.org> (aksesuar online: 07/12/2017).

¹²⁸ Robinson, N., *The Genocide Convention: a commentary*, Publisher: Institute of Jewish Affairs, World Jewish Congress, 1960, f.63.

mendore në mënyrë më shumë se përkohësisht.¹²⁹ Ndërsa përsa i përket **pikës “c”** të dispozitës që parashikon *“të imponuarit e qëllimshëm të kushteve të atilla brenda grupit, të parashikuara që të shkaktojnë shkatërrimin fizik apo mendor të plotë apo të pjesshëm të grupit”*, sipas Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare ky paragraf i dispozitës ka të bëjë me deportimin.¹³⁰ Referuar **pikës “d”** të dispozitës, e cila ka parashikuar *“imponimin e masave që kanë për qëllim parandalimin e lindjeve brenda grupit”*. Redaktorët e nenit II të Konventës së vitit 1948 synonin të përfshijnë midis këtyre masave sterilizimin, abortin e detyruar, ndarjen e gjinive, pengesat për martesë. Komisioni i Ekspertëve që hetoi në ish-Jugosllavi për abuzimin seksual, nuk arriti të verifikojë nëse efektivisht përdhunimet përdorëshin sistematikisht për të ndryshuar karakteristikat etnike të popullatës, pasi nëpërmjet përdhunimeve synohej me çdo kusht që të gratë e një grupi të caktuar të mbeteshin shtatëzënë në mënyrë të padëshiruar.¹³¹ Përsa i përket *“transferimit të dhunshëm të fëmijëve prej një grupi tek një grup tjetër”*, sipas Komisionit transferimi i dhunshëm i fëmijëve do të kishte pasoja veçanërisht serioze për vitalitetin e ardhshëm të vetë grupit. Megjithëse kjo dispozitë nuk mund të shtrihet tek të rriturit, ky lloj i sjelljes në rrethana të caktuara mund të përbëjë një krim kundër njerëzimit ose një krim lufte.

Përsa i përket përgjegjësisë personale, bazuar në nenin 33 të Statutit, urdhrat e dhëna nga eprori hierarkik, qoftë politike, ushtarake apo civile, për të kryer gjenocid, janë *“dukshëm jolegjitime”* dhe nuk e përjashtojnë në asnjë mënyrë përgjegjësinë penale të personit që i ka kryer ato. Duke iu kthyer krimit në fjalë, është e nevojshme të thuhet se studimi i tij ishte temë e diskutimit të Komisionit Përgatitor për GJPN-në gjatë seancës së tij të parë të 16-26 shkurtit 1999 dhe çoi në përpunimin e dy dokumenteve në lidhje me të: i pari, tregon elementet përbërëse të vetë krimit të gjenocidit dhe i dyti, përmban sqarimin se edhe dhunimi dhe dhuna seksuale konsiderohen aktet e gjenocidit, nëse kryhen sipas atyre kriterëve që konsiderohen konstitutive të gjenocidit.¹³²

Përsa i përket dokumentit të parë, elementët që mund të përbëjnë gjenocidin janë:

- *Në rastin e gjenocidit të kryer **nëpërmjet vrasjes**:*
 - a) *qëllimi i të akuzuarit për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar si të tillë;*
 - b) *fakti që i akuzuari vrau një ose më shumë njerëz në atë grup për të ndjekur këtë qëllim;*
 - c) *fakti që i akuzuari ka ditur ose ka pasur rastin të dijë se sjellja e tij mund të kishte shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, atë grup ose se sjellja e tij ishte pjesë e një sërë veprimesh të drejtuara kundër atij grupi të veçantë.*
- *Në rastin e gjenocidit të kryer **duke shkaktuar lëndime serioze**:*

¹²⁹ Ibid.

¹³⁰ Raport i Komisionit për Asamblenë e Përgjithshme mbi punën e sesionit të tij të 48-të, Vjetari i Komisionit të Ligjit Ndërkombëtar, Vol. II, Pjesa 2, 1996, f. 89. Shih: <http://legal.un.org> (aksesuar online: 07/12/2017).

¹³¹ Aktakuza Prokurori kundër Radovan Karadzic, Ratko Mladic, No. IT-95-18-A, 25.07.1995. Shih: <http://www.icty.org> (aksesuar online: 07/12/2017).

¹³² Dörmann, K., *“The first and second sessions of the PrepCom for the ICC”*, Vjetari i Komisionit të Ligjit Ndërkombëtar, Vol. 2, 1999, f. 286.

- a) qëllimi i të akuzuarit për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar si të tillë;
 - b) fakti që i akuzuari ka shkaktuar lëndime të rënda fizike ose mendore për një ose më shumë persona që i përkasin grupit të synuar, për ta shkatërruar atë;
 - c) fakti që i akuzuari dinte ose kishte rast të dinte se lëndimet e tilla mund të kishin shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, këtë grup, ose se ishin pjesë e një serie aktesh të drejtuara kundër atij grupi të veçantë.
- Në rastin e gjenocidit të kryer **duke shkaktuar kushte të caktuara të jetesës:**
- a) qëllimi i të akuzuarit për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar si të tillë;
 - b) fakti se i akuzuari ka shkaktuar disa kushte të jetës në grupin e synuar për ta shkatërruar atë;
 - c) fakti që kushtet e jetesës të imponuara u hartuan për të shkatërruar fizikisht, tërësisht ose pjesërisht, atë grup;
 - d) fakti që i akuzuari e dinte ose kishte mundësinë të dijë se kushte të tilla të jetës mund të kishin shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, këtë grup ose që ishin pjesë e një sërë veprimesh të drejtuara kundër atij grupi të veçantë.
- Në rastin e gjenocidit të kryer **nga parandalimi i lindjeve:**
- a) qëllimi i të akuzuarit për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar si të tillë;
 - b) fakti që i akuzuari ka vendosur sjellje të caktuara për një ose më shumë persona që i përkasin grupit të synuar, për ta shkatërruar atë;
 - c) fakti që sjelljet e imponuara kanë për qëllim parandalimin e lindjeve brenda vetë grupit;
 - d) fakti që i akuzuari e dinte apo kishte mundësinë të dijë se një sjellje e tillë mund të kishte shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, këtë grup, ose se ata ishin pjesë e një sërë aktesh të drejtuara kundër atij grupi.
- Në rastin e gjenocidit të kryer **me anë të transferimit të fëmijëve:**
- a) qëllimi i të akuzuarit për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar si të tillë;
 - b) fakti se i akuzuari ka transferuar me forcë një ose më shumë persona nga grupi i synuar në një tjetër për ta shkatërruar atë;
 - c) fakti që personi ose personat ishin nën moshën 18 vjeç dhe i pandehuri e dinte ose kishte pasur rastin të njihte;
 - d) fakti që i akuzuari dinte ose kishte rast të dijë se një transferim i tillë i detyruar mund të kishte shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, atë grup, ose se kjo ishte pjesë e një sërë aktesh të drejtuara kundër atij grupi të veçantë¹³³.

¹³³ Ibid, f. 285.

Nga analiza e sa më sipër, rezulton kështu që ndryshimet më të rëndësishme të theksuara nga Komisioni janë dy:

- 1) në lidhje me gjenocidin e një grupi të caktuar të kryer duke i vendosur anëtarët e tij në kushte të caktuara të jetesës ose duke imponuar sjellje të caktuara për të parandaluar lindjet e tyre, dokumenti kërkon që këto akte, në mënyrë që të përbëjnë elemente reale të krimit të kërkuar, duhet të kenë në vetvete qëllimi për të shkatërruar, në tërësi ose pjesërisht, grupin e synuar;
- 2) për sa i përket gjenocidit të kryer nga transferimi i dhunshëm i fëmijëve nga një grup në tjetrin, risi e bërë nga dokumenti konsiston në përcaktimin se të gjithë individët nën moshën 18 vjeç duhet të konsiderohen fëmijë.

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës Ndërkombëtare Penale nuk është regjistruar asnjë rast në lidhje me gjenocidin, përsa i përket territorit të ish Jugosllavisë, pasi për një territor të tillë kompetencën territoriale për të ndëshkuar krimin e gjenocidit e ka Tribunali Ndërkombëtar i Hagës.

KAPITULLI III
GJENOCIDI SIPAS KËNDVËSHTRIMIT TË SË DREJTËS SË
BRENDSHME

Konkluzione

- Në përfundim të punës sime kërkimore për problematikën, mund të marr parasysh shumëllojshmërinë e materialeve të konsultuara, dhe të them se, përkundër këtyre shtatëdhjetë viteve, Konventa për parandalimin dhe represionit e krimit të gjenocidit është shndërruar në një burim zakonor të së drejtës ndërkombëtare dhe prandaj është njohur si universalisht i pacenueshëm dhe imperativ edhe për ato shtete që kurrë nuk e kanë ratifikuar atë, por ka ende shumë probleme që ngre, veçanërisht në sferën e përkufizimit të krimit.
- Deri më sot, në fakt, ende nuk është e qartë se çfarë nënkuptohet me gjenocid: edhe pse artikujt 2 dhe 3 të Konventës tregojnë një listë të saktë të akteve që konsiderohen të dënueshme si të tilla, por nuk ishte e mundur të shpjegohet se çfarë konsiderohen në të vërtetë këto akte: për shembull, nuk ka pasur ndonjë qartësi në lidhje me përkufizimin e “grupit të mbrojtur” nga Konventa.
- Siç është trajtuar edhe në këtë punim shkencor, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë dhe Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën në këtë drejtim kanë vendosur: *së pari*, që individët e mbrojtur nga Konventa janë ata që bien nën ambiciet e autorit vrasës si “kombëtar, etnik, racial ose fetar”, që konsiderohen ndryshe nga vetja e tij; *së dyti*, që “të mbrojtur” janë, në përgjithësi, ata që i përkasin një “grupi të qëndrueshëm”, por ajo që nënkuptohet me “stabilitetin e grupit” nuk është specifikuar.
- Kodifikimi i krimit të gjenocidit është i vetmi që nuk ka pësuar ndryshime apo përditësime që kur u zbatua ligjërisht në vitin 1948. Madje edhe në Statutin e Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, por edhe në Statutin e Romës, dispozitat që rregullojnë përkufizimin e gjenocidit kanë implementuar në një mënyrë literale gjuhën e Konventës. Dhe ndërsa Konventa është instrumenti i vetëm i referencës për shtypjen e krimit, nga ana tjetër, është i vetmi mjet në dispozicion për parandalimin e tij. Sidoqoftë, me siguri mund të themi se deri më tani është bërë shumë pak kundrejt represionit të këtij krimi: nuk është rastësi që fjalja e parë e lëshuar në këtë çështje daton që nga shtatori i vitit 1998 (në çështjen Akayesu, të trajtuar nga Tribunali Ndërkombëtar i Ruandës).
- Arena ndërkombëtare në ndëshkimin e këtyre krimeve është përballur me politika tepër negative dhe diplomatika, pasi nëse kishim shtete (fuqi të mëdha) që nxisin dhe reflektonin në arenën ndërkombëtare një “fasadë” për ndëshkimin e krimeve ndërkombëtare, përfshirë gjenocidin, nga ana tjetër bënin një luftë të ftohtë për të vendosur sa më shumë pengesa, në mënyrë që të vonojë themelimi i një Gjykate Penale Ndërkombëtare, e cila sipas tyre do të çenonte në mënyrë të qartë sovranitetin kombëtar në fushën penale. Por sot që vullneti i Shteteve duket të drejtohet drejt një globalizimi më të madh, drejt një fuqie më të gjerë të zbatimit të së drejtës ndërkombëtare dhe drejt vendosmërisë më të fortë në luftën mbinatyrore ndaj krimit, si dhe drejt realizimit të nevojës për bashkëpunim mes popujve, këtu, megjithatë, frika e humbjes së pushtetit kombëtar, sidomos nga fuqitë e mëdha, nuk zvogëlohet, duke ngadalësuar kështu zhvillimin e projekteve të rëndësishme.

- Përgjegjësia e shtetit për gjenocid nuk është nga natyra e tij penale, megjithëse ky koncept nuk ia eliminon gjenocidit, natyrës së tij si një krim sipas ligjit ndërkombëtar dhe përgjegjësia penale individuale shkon njëkohësisht me përgjegjësinë e shtetit. Regjimi i rënduar i përgjegjësisë shtetërore për shkeljet serioze të normave të së drejtës ndërkombëtare, e cila zbatohet për gjenocidin, është në vetvete me vlerë të vogël praktike. Nuk është e nevojshme që synimet gjenocidale t'i atribuohen një shteti në ndonjë mënyrë të veçantë, pasi çështja e fajit është një çështje e rregullave primare. Synimi gjenocidial duhet të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm, por vetëm në lidhje me autorët e vërtetë të gjenocidit. Elementi i vetëm dispozitiv i përgjegjësisë së një shteti për gjenocid është kontrolli i tij mbi ata që e kryejnë atë. Jo vetëm që kjo është gjëja metodologjikisht e drejtë për të bërë, por është edhe më e praktikueshme: provimi i qëllimit gjenocidial të udhëheqjes së lartë të shtetit me çdo shkallë të arsyeshme sigurie do të ishte shpesh një detyrë e pamundur, për shkak të mungesës së shpeshtë të provave të drejtpërdrejta, dhe rasti Milošević mendoj se duhet përmenduar si një rast i tillë.
- Grupi njerëzor është **elementi fizik** i krimit të gjenocidit, pra është destinacioni i tij specifik. Konventa e kualifikon grupin njerëzor nëpërmjet mbiemrave “kombëtare, etnike, racore apo fetare”, kështu që vetëm këto grupe janë të mbrojtura. Me fjalë të tjera, një grup kombëtar mund të ketë një vlerë aq të madhe saqë konsiderohet si një grup individësh të dalluar nga pjesa tjetër e popullsisë nga ngjashmëritë e tyre gjuhësore, etnike, raciale, fetare dhe kulturore dhe jo nga nacionaliteti ose shtetësia e tyre në kuptim të rreptë.
- Elementi moral i krimit të gjenocidit (***mens rea***) konsiston në intencionalitetin e shkatërrimit të grupit, domethënë, mund të flitet për gjenocid vetëm në rastet kur vepra penale, që është elementi material i krimit, është kryer “me qëllim të shkatërrimit, tërësisht ose pjesërisht, të një grupi [...] si i tillë”. Prandaj qëllimi është elementi që e karakterizon gjenocidin më shumë se çdo element tjetër. Rrjedhimisht, duhet të flitet për gjenocid sa herë që kryhet një vepër penale me qëllim që individi të zhduket thjesht sepse i përket një grupi të caktuar.
- Elementi material i veprës penale të gjenocidit (***actus reus***), përbëhet nga figura të veprës penale që neni 2 i Konventës i kategorizon në pesë kategori në mënyrë që të bëjë të qartë natyrën e mbyllur dhe kufizuese të listës së propozuar (pra dispozitë shteruese), si: *vrasjen e anëtarëve të grupit; duke shkaktuar dëm të rëndë trupor ose mendor për anëtarët e grupit; vendosja e grupit në kushte të tilla që shkaktojnë shkatërrimin e tij fizik të plotë ose të pjesshëm; marrjen e masave për parandalimin e lindjeve brenda grupit dhe transferimin me forcë e fëmijëve të grupit në një grup tjetër.*
- Elementët e sjelljes që përbëjnë gjenocid siç vërehet formojnë një dispozitë shteruese dhe tepër të qartë. Ky krim, sipas mendimit tim, përfshihet në kategorinë e përgjithshme të krimeve kundër njerëzimit, por dallon nga ***qëllimi specifik***, domethënë qëllimi i veçantë i shkatërrimit tërësisht ose pjesërisht të një grupi kombëtar, etnik, racial ose fetar.

- Gjenocidi është parashikuar në nenin 4 të Statutit të Tribunalit të Hagës dhe në nenin 6 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale (i njohur si Statuti i Romës. Përmbajtja e këtyre dispozitave reflekton një implementim literal të gjuhës së përdorur në Konventën kundër Gjenocidit (1948). Por në dallim nga Konventa, në Statutin e Romës nuk janë parashikuar aktet e reflektuara në nenin 3 të Konventës (1948), pasi Statuti ka preferuar që këto akte t'i parashikojë në nenin 25 të tij ku është sanksionuar “Përgjegjësia personale individuale”. Gjithashtu ndërmjet Statutit të Romës dhe Konventës ka dhe një tjetër mospërputhje, pasi në nenin 25 të Statutit parashikohet vetëm nxitja, tentativa dhe bashkëfajësia duke përjashtuar marrëveshjen si element të përgjegjësisë penale.
- Tribunali i Hagës, i cili është kompetent për hetimin dhe gjykimin e krimeve të karakterit ndërkombëtar, që kanë ndodhur në territorin e ish-Jugosllavisë, prej vitit 1991, në jurisprudencën e tij ka elaboruar një analizë të thelluar dhe unifikuese në raportin e elementëve juridikë të krimit të gjenocidit. Tribunali në tërësinë e tij, pra si Dhoma Gjyqësore edhe Dhoma e Apelit, në vendimarrjen e tyre përballë akuzave mbi gjenocidin janë treguar tepër të vëmendshëm në vlerësimin e bazueshmërisë së provave përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, si dhe në evidentimin e lidhjes shkakësore ndërmjet veprimit/mosveprimit të ndërmarrë si dhe qëllimit specifik (*dolus specific*) për të shkatërruar pjesërisht ose në tërësi grupin, ose një pjesë thelbësore dhe tepër të rëndësishme të grupit.

Bibliografia:

Burime parësore:

- Konventa (IV) Mbi respektimin e ligjeve dhe zakoneve të luftës mbi tokë dhe aneksi i saj: Rregulloret lidhur me ligjet dhe pasojat e luftës mbi tokë, Hagë 18 Tetor 1907
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 96 (I) më 11 Dhjetor 1946, *United Nations Yearbook*, 1946-'47
- Rezoluta 96 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara “Krimi i gjenocidit”, 11 Dhjetor 1946
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 190 (II) më 21 Nëntor 1947, “Draft-Konventa e Gjenocidit”, *United Nations Yearbook*, 1946-'47
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 260 (III) më 9 Dhjetor 1948, “Adoptimi i Konventës mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit, dhe teksti i Konventës”, *United Nations Yearbook*, 1948
- Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit, adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 9 Dhjetor 1948
- Konventa mbi Paparashkrueshmërinë e Krimeve të Luftës dhe Krimeve kundër Njerëzimit, adoptuar nëpërmjet Rezolutës 2391 (XXIII) të datës 26 Nëntor 1968 dhe ka hyrë në fuqi më 11 Nëntor 1970
- Rezoluta 743 lëshuar nga Këshilli i Sigurimit, 1992
- Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare, miratuar nga Konferenca Diplomatike e të Plotëfuqishmëve në Kombet e Bashkuara për themelimin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale më 17 Korrik 1998, hyrë në fuqi 1 Korrik 2002
- Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë, i përditësuar më Shtator 2009
- Rregullat e Procedurës dhe Marrjes së Provave, Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen e Personave Përgjegjës për çënime të rënda të ligjit ndërkombëtar humanitar, të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, që nga 1991, IT/32/Rev.50, përditësuar më 8 Korrik 2015
- Karta e Kombeve të Bashkuara, përditësuar në 2017

Burime dytësore:

- Arbitrio, R., *Il conflitto etnico: dinamiche sociali e strategie di intervento : il caso della ex Jugoslavia*, Shtëpi botuese: F.Angeli, 1998
- Bassiouni, M.C., *International Criminal Law: A Draft International Criminal Code*, Botim: Brill Archive, New York, 1980
- Bassiouni, M.C., Manikas, P., *The law of the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia*, Shtëpi botuese: Transnational Publishers, 1996
- Barboza, J., *International Criminal Law*, Vol.278, Collected Courses of the Hague Academy of International Law, 1999
- Bianchini, S., *La questione jugoslava: Collana XX secolo*, Shtëpi botuese: Giunti Editore, Firenze, 1999

- Caracciolo, I., *Dal Diritto Penale Internazionale all Diritto Internazionale Penale*, Shtëpi botuese: Editoriale Scientifica, Milano, 2000
- Ching, J., *Genocide and the Bosnian War: Genocide in Modern Times*, Botim: The Rosen Publishing Group, 2009
- Dörmann, K., “*The first and second sessions of the PrepCom for the ICC*”, Vjetari i Komisionit të Ligjit Ndërkombëtar, Vol. 2, 1999
- Dunne, T., Krosalak, D., *Genocide: Knowing What it is That We Want to Remember, or Forget, Or Forgive*, Vol.4, Pjesa 1, *The International Journal of Human Rights*, 2000
- Gow, J., *Triumph of the Lack of Will. International Diplomacy and the Yugoslav War*, Botim: Hurst & Company, Londër, 1997
- Guida, F., *Dayton dieci anni dopo: guerra e pace nella ex Jugoslavia : atti del Convegno, Roma, 21-23 novembre 2005*, Vol. 113, Studime Historike Carocci, Botime: Carocci, 2007
- Gaeta, P., *The UN Genocide Convention: A Commentary*, Botim: Oxford University Press, 2009
- Kyriakakis, J., Corporations before International Criminal Courts: Implications for the International Criminal Justice Project, *Leiden Journal of International Law*, Vol.30, Issue 1, Mars 2017
- Lemkin, R., “Veprat që përbëjnë rrezik të përgjithshëm (transnacional) konsiderohen si vepra penale kundër ligjit të kombeve”, paraqitur në Konferencën e V-të Vjetore për Unifikimin e Ligjit Penal në Madrid, Tetor 1933
- Lemkin, R., *Axis Rule in Occupied Europe: Laws of Occupation – Analysis of Government – Proposals for Redress*, Carnegie Endowment for International Peace, Washington DC, 1944
- Lemkin, R., Genocide as a crime under International Law, *American Journal of International Law*, Vol.41, 1947
- Lombezzi, M., *Bosnia: La torre dei teschi. Lessico di un genocidio*, Shtëpi botuese: Dalai, Milano, 1997
- Mantovani, F., *Diritto penale*, Ribotim 3, Shtëpi Botuese: CEDAM, Padova, 1992
- Militello, V., *Conflitti inter-etnici e tutela delle vittime: fra Corte penale internazionale e giurisdizione internazionale*, Vol. 13, Publikime të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Palermos, Botim: Giuffrè Editore, 2008
- Mestrovic, S., *Genocide after Emotion: The Post-Emotional Balkan War*, Shtëpi botuese: Routledge, 2013
- Naimark, N., *La politica dell’odio. La pulizia etnica nell’Europa contemporanea*, Botime: Laterza, 2002
- Opinioni i shprehur nga Tony Lloyd për llogari të Bashkimit Evropian, Sekretar i Shtetit për Ministrinë e Jashtme Britanike, *Terra Viva*, Nr.2, 16 Qershor 1998
- Pirjevec, J., *Le guerre jugoslave*, Shtëpi botuese: Einaudi, Torino, 2001

- Vassalli, G., *Verso una giustizia internazionale penale ?*, cit. nw Sicurella R., *Per una teoria della colpevolezza nel sistema dello statuto della Corte Penale Internazionale*, Vol. 277, Botim: Universiteti Catani, Fakulteti i Drejtësisë, Giuffrè Editore, 2008
- Taylor, T., *Anatomia dei processi di Norimberga*, Botim i dytë, Shtëpi Botuese: Rizzoli, Milano, 2005
- Xhafo, J., *E drejta penale ndërkombëtare*, Shtëpia botuese: GEER, Tiranë, 2009
- Robinson, N., *The Genocide Convention: a commentary*, Publisher: Institute of Jewish Affairs, World Jewish Congress, 1960
- Raporti final i Komisionit të Ekspertëve të emëruar nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, S/1994/674, datë 27 Maj 1994
- Raport i Komisionit për Asamblenë e Përgjithshme mbi punën e sesionit të tij të 48-të, Vjetari i Komisionit të Ligjit Ndërkombëtar, Vol. II, Pjesa 2, 1996

Akte dhe praktikë gjyqësore:

- Mendim këshillënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, “Mbi rezervat e Konventës për parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit”, 28 Maj 1951
- Procedura e aplikimit në institucion, e shënuar në Regjistrin e Gjykatës nr. 91, më 20 Mars 1993
- Aktakuza Prokurori kundër Radovan Karadžić, Ratko Mladić, No. IT-95-18-A, 25.07.1995
- ICTY, Prosecutor v. Dusko Tadić, IT-94-1-AR72, Dhoma e Apelit, Vendim datë 2 Tetor 1995
- Padi Prokurori kundër Radovan Karadzic, Ratko Mladic, No. IT-95-18-I, 14 Nëntor 1995
- Çështja Bosnje-Hercegovina kundër Jugosllavisë, vendim i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, datë 11.07.1996
- Opinion Këshillues, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, “Mbi ligjshmërinë e krijimit ose përdorimit të armëve nukleare”, 8 Korrik 1996
- Çështja “Akayesu”, Vendimi i Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën, nr. ICTR 96-4-T, 2 shtator 1998
- Çështja Prokurori kundër Jelisić, vendim i Dhomës së Apelit të Tribunalit Ndërkombëtar, IT-95-10-A, Hagë datë 5 Korrik 2001
- Vendimi i Dhomës së Gjykimit, Prokurori kundër Radislav Krstić, Nr.çështje: IT-98-33-T, Hagë, 2 Gusht 2001
- Vendimi i Dhomës së Apelit, Prokurori kundër Radislav Krstić, Nr.çështje: IT-98-33-A, Hagë, 19 Prill 2004
- Vendimi dhënë në çështjen Bosnja dhe Hercegovina kundër Serbisë dhe Malit të Zi, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, 26 Shkurt 2007
- Vendim i Dhomës Gjyqësore, Prokurori kundër Zdravko Tolimir, No. IT-05-88/2-T, 12 Dhjetor 2012

- Vendim i Dhomës së Apelit, Prokurori kundër Zdravko Tolimir, No. IT-05-88/2-A, 8 Prill 2015
- Vendim i Dhomës Gjyqësore, Prokurori kundër Ratko Mladić, No. IT-09-92-T, 22 Nëntor 2017

Referenca online:

- <http://www.un.org>
- <http://www.icty.org>
- <http://www.pp.gov.al>
- www.preventgenocide.org/lemkin/madrid1933-english.htm
- <https://documents-dds-ny.un.org>
- <https://ihl-databases.icrc.org>
- <http://www.icj-cij.org>
- <https://www.icc-cpi.int>
- <http://legal.un.org>
- <https://www.nato.int>
- <http://docenti.unime.it>
- <http://unictr.unmict.org>